



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Rruga "Antipatrea", e-mail: [bashkiaberat@yahoo.com](mailto:bashkiaberat@yahoo.com), web [www.bashkiaberat.gov.al](http://www.bashkiaberat.gov.al)

**DOKUMENTI**  
**I STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**MIRATOHET**  
**KRYETARI I K.K.T**  
**Z. EDIRAMA**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**  
**ZNJ. EGLANTINA ÇERMENI**

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**  
**ZNJ. NIKOLETA MANKA**

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Z. PETRI SINAJ**

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Berat Nr.24 Datë 26/02/2016

Miratuar me Vendim të Këshillit të Kombëtar të Territorit Nr.3 Datë 29/12/2016

Hartuar nga:	Bashkia BERAT
Mbështetur nga:	Projekt i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit



Handwritten notes in the center of the page, including the number '3' and some illegible scribbles.

## Tabela e përmbajtjes

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TË BASHKISË BERAT .....	6
AUTORËSIA DHE KONTRIBUTET.....	7
SHËNIM I RËNDËSISHËM.....	8
PREAMBUL .....	9
PARATHËNIE.....	10
HYRJE.....	12
I. SFIDAT E BASHKISË BERAT.....	15
1.1 TENDENCAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË PAS VITEVE 90'-TË.....	15
POLICENTRIZMI.....	17
1.2 TERRITORI DHE MJEDISI .....	20
1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike .....	20
1.2.2 Metabolizmi i territorit.....	21
1.2.3 Mjedisi, ekosistemet dhe ndotja .....	37
1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK .....	53
1.4 MIRËQENIA SOCIAL-EKONOMIKE .....	59
1.4.1 Demografia .....	59
1.4.2 Analiza social-ekonomike.....	64
1.4.3 Shëndetësia.....	70
1.5 PËRDORIMI I TOKËS DHE INFRASTRUKTURAT .....	74
1.5.1 Përdorimi i tokës .....	74
1.5.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza.....	75
1.5.3 Infrastruktura rrugore dhe transporti për Bashkinë Berat .....	77
1.5.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta .....	79
1.6 RËNDËSIA KOMBËTARE NË TERRITOR .....	80
1.6.1 Monumente kulture.....	80
1.6.3 Zona të mbrojtura natyrore.....	81
1.6.4 Menaxhim i integruar i burimeve ujore .....	81
1.6.5 Tokat bujqësore.....	82
1.6.6 Pyjet, drufrutorët dhe kullotat.....	83
1.6.7 Zonat industriale.....	83
1.6.7 Të tjera.....	84
1.7 FINANCAT VENDORE .....	84
1.8 QEVERISJA DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE.....	88
1.8.1 Decentralizimi i Qeverisjes dhe Strukturat Përkatëse.....	88
1.8.2 Vështirësitë e Qeverisjes Vendore.....	89
1.8.3 Perceptimet Qytetare në lidhje me qeverisjen e tyre vendore, format e organizimit komunitar dhe bashkësia e OJF-ve, instrumente të transparencës, etj. ....	90
1.9 PROCESE DHE DOKUMENTE PLANIFIKIMI.....	91
1.9.1 Plani Rregullues i Beratit i Vitit 1983.....	91
1.9.2 Studim për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Beratit .....	91
1.9.3 Plani i Konsoliduar Urban i Bashkisë Berat.....	91
1.9.4 Plane Strategjike .....	93
1.9.5 Studime dhe projekte të pjesshme urbane .....	96
1.9.6 Përfundime .....	96
1.10 MBI DREJTIMIN E ZHVILLIMIT .....	97
1.10.1 Koncepti rajonal i zhvillimit.....	97
1.10.2 Përfundime dhe analiza SWOT .....	109

II. VIZIONI I TË ARDHMES PËR BERATIN .....	116
III. OBJEKTIVA STRATEGJIKE DHE PROGRAME .....	118
3.1 OBJEKTIVAT DHE PROGRAMET STRATEGJIKË .....	118
3.3 KONSIDERATA FINANCIARE .....	122
IV. PLANI I VEPRIMIT .....	124
4.1 PLANI I VEPRIMIT .....	124
4.2 SISTEMET E TERRITORIT .....	135
V. PROJEKTET PRIORITYRE TË ZHVILLIMIT .....	137
SHTOJCA.....	173



## TABELA E FIGURAVE

Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat .....	12
Figura 1. Pozicionimi i Bashkisë Berat .....	13
Figura 2. Fazat e zhvillimit të vendbanimeve në vite .....	15
Figura 3. Shtimi i sipërfaqes së ndërtuar 1990 - 2013 .....	16
Figura 4. Zonat Funktionale Urbane në Shqipëri .....	17
Figura 5. Mbivendosja e izokroneve 45' - Zonat e integritit të mundshëm .....	19
Figura 6. Harta e fluksit të energjisë në rajon .....	22
Figura 7. Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) .....	23
Tabela 2. HEC-et, Bashkia Berat.....	24
Tabela 3. Rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 .....	25
Tabela 4. Bilanci i Energjisë Elektrike, 2011 .....	25
Figura 8. Fluksi i energjisë në Bashkinë Berat .....	26
Tabela 5. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale.....	26
Figura 9. Fluksi i ujit në Bashkinë Berat .....	28
Tabela 6. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Berat .....	29
Figura 10. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Berat.....	30
Tabela 7. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për Qarkun e Beratit.....	31
Figura 11. Prodhimet Bujqësore (në ton), Bashkia Berat 2014 .....	32
Figura 12. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në ton), në Bashkitë: Berat, Lushnjë, Fier, Elbasan dhe Kuçovë .....	32
Figura 13. Prodhimet bujqësore për periudhën 2012-2013-2014 (në ton), Qarku Berat .....	33
Figura 14. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në ton), në Qarkun: Berat, Fier dhe Elbasan .....	33
Figura 15. Prodhimet blegtorale (në ton), Bashkia Berat 2014 .....	34
Figura 16. Prodhimet blegtorale në vitin 2014 (në ton), në Bashkitë: Berat, Lushnjë, Fier, Elbasan dhe Kuçovë.....	34
Figura 17. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Berat .....	36
Figura 18. Burimet ujore dhe akuiferët e Beratit .....	38
Figura 19. Harta e marrjes së kampioneve për monitorim në Osum .....	39
Figura 20. pH i ujërave të Osumit.....	40
Figura 21. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Osum.....	40
Figura 22. Lënda e ngurtë pezull dhe e tretur në Osum .....	41
Figura 23. Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Osum .....	42
Figura 24. Metalet e rënda në Basenin e Lumit Osum.....	42
Figura 25. Metalet e Rënda në Basenin e Lumit Osum .....	43
Figura 26. Klasifikimi dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Beratit.....	44
Figura 27. Harta hidro-geologjike, Qarku Berat.....	45
Figura 28. Vatrat e nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Berat .....	48
Tabela 8. Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik .....	50
Figura 29. Struktura e VSHB_Qarku Berat 2012 .....	53
Figura 30. Korridoret dhe zonat industriale të territorit të Beratit .....	54
Figura 31. Harta e ndërveprimit ekonomik në Bashkinë Berat.....	54
Figura 32. Harta e vendndodhjes së biznesit të madh në Bashkinë Berat.....	56
Figura 33. Harta e sektorëve të ekonomisë në Bashkinë Berat.....	57
Tabela 9. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015.....	59
Tabela 10. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015 .....	59
Tabela 11. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave .....	60
Figura 34. Struktura moshore e Beratit, 2015.....	60
Tabela 12. Koefficientet e varësisë .....	61
Tabela 13. Popullsia e Bashkisë Berat, 2011-2031.....	62

Tabela 14. Niveli arsimor i përfunduar.....	64
Tabela 15. Vitet mesatare të shkollimit .....	64
Tabela 16. Hapësirat arsimore të njësisive dhe standardet e projektimit.....	65
Figura 35. Numri i banorëve në moshë pune në Bashkinë Berat.....	66
Figura 36. Punësimi sipas nivelit arsimor.....	66
Figura 37. Punësimi sipas degëve të ekonomisë.....	67
Figura 38. Punëkërkues të papunë të regjistruar(meshkuj dhe femra), 2014 .....	67
Tabela 17. Punëkërkues të papunë të regjistruar në Qarkun Berat në vitin 2014 .....	68
Tabela 18. Punëkërkues të papunë afatgjatë në Qarkun Berat.....	68
Figura 39. Shkalla e papunësisë.....	68
Tabela 19. Numri i poliklinikave, Qarku Berat .....	70
Tabela 20. Numri i qendrave shëndetësore, Qarku Berat .....	70
Tabela 21. Numri i ambulancave, Qarku Berat .....	70
Tabela 22. Numri i konsultoreve të fëmijëve, Qarku Berat.....	70
Tabela 23. Numri i konsultoreve të gruas, Qarku Berat .....	70
Tabela 24. Numri i spitaleve, Qarku Berat .....	71
Tabela 25. Numri i shtretërve, Qarku Berat.....	71
Figura 41. Burimi i të ardhurave të Njesisë Ekonomike Familjare.....	72
Figure 42. Përdorimi i tokës, Bashkia Berat .....	74
Tabela 27. Shërbimi i furnizimit me ujë .....	75
Figura 43. Shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat.....	75
Tabela 28. Kapacitetet e burimeve ujore .....	76
Tabela 29. Kërkesa totale për ujë në vitin 2015 për tre kategoritë e konsumatorëve .....	76
Figura 44. Rrjeti i tubacioneve dhe kanaleve në qytetin e Beratit .....	76
Tabela 30. Ndarja e infrastrukturës së Bashkisë Berat sipas kodit rrugor dhe sipas funksionit.....	77
Figura 46. Kontributi i njësisive në ecurinë e të ardhurave totale të Bashkisë Berat (grafiku majtas, në pikë përqindjeje); Kontributi sipas burimit në të ardhurat totale (grafiku djathtas, në pikë përqindjeje). .....	85
Figura 47. Kontributi sipas burimeve në shpenzime totale (në pikë përqindjeje, grafiku majtas); Kontributi sipas programeve në shpenzimet totale (në pikë përqindjeje, grafiku majtas).....	87
Figura 48. Shpenzimet totale sipas përdorimit dhe funksioneve. ....	87
Figura 49. Skica të planit rregullues të Beratit të vitit 1983 .....	91
Figura 50. Plani Rregullues i Qytetit të Beratit: Përdorimi i Tokës.....	92
Figura 51. Kufijtë e Qendrës Historike.....	94
Figura 52. Zonat buferike rreth qendrës historike .....	95
Figura 53. Kriteret e përcaktimit të rajonit të studimit .....	98
Figura 54. Sistemi urban dhe infrastruktura .....	98
Figura 55. Sistemi natyror .....	98
Figura 56. Analiza historike .....	99
Figura 57. Koncepti rajonal .....	100
Figura 58. Potenciali turistik dhe zonat në presionin e ndotjes mjedisore .....	102
Figura 59. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Rrjeti Rrugor.....	105
Figura 60. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Korridoret e lëvizjes dhe hierarkia e qendrave .....	106
Figura 61. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Nënrajonet e lëvizjes.....	106
Figura 62. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Ndërthurja e sistemeve dhe qendërsive.....	108
Figura 63. Harta e Vizionit, Bashkia Berat.....	117
Figura 64. Polet e zhvillimit, Berat.....	118
Figura 65. Propozimet në sistemet e territorit.....	136

**Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Berat**

## **Autorësia dhe Kontributet**

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë Berat, Z. Petrit Sinaj.

Grupi i punës: Zenel Bajrami, Eneida Çela, Rudina Toto, Dritan Shutina, Anila Gjika, Merita Toska, Elton Stafa, Sotir Dharmo, Besnik Aliaj, Iris Hyka, Renisa Muka, Ada Lushi, Arta Alla, Teida Shehi, Silvi Jano, Imeldi Sokoli, Gerti Delli, Ani Shtylla, Ingrid Xhafa, Malvina Disha, Kejt Dhrami, Endri Demneri, Fiona Imami, Fabjola Meçaj, Godiva Rrëmbeçi, Aida Ciro, Ardenis Hoxha, Valentina Zotkaj, Elton Nino, Sllavi Dhrami.

### **Shënim i rëndësishëm**

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Çështjet e analizuar në këtë dokument janë diskutuar dhe për to është rënë dakord me grupet e interesit të Bashkisë Berat, në proceset e konsultimit publik, në përputhje me detyrimet ligjore, sipas Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

**PREAMBUL**

## **Parathënie**

Që prej qershorit 2015, qeverisja vendore në Shqipëri është përfshirë nga reforma administrative-territoriale. Si rezultat, janë krijuar 61 bashki të konsoliduara, të cilat përballen me sfidat e pushtetit vendor, të shumëfishuara si pasojë e rritjes së sipërfaqes dhe kompleksitetit territorial, shtimit të detyrave të reja nga reforma e decentralizimit, dhe nevojës gjithmonë në rritje për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike.

Në këto kushte, Bashkia e Beratit, për t'iu përgjigjur sa detyrimeve ligjore, aq edhe sfidave reale, ka punuar intensivisht për të përgatitur Strategjinë e Zhvillimit të saj. Duke pasur parasysh që, jo vetëm konceptualisht, por edhe ligjërisht është pranuar nga palët se planifikimi i territorit përmban një kohësisht edhe dimensionin strategjik dhe atë rregullator, kjo strategji përbën hapin e parë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Berat.

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të territorit hartohet nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në kuadër të Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP). Përmbajtja e dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të territorit mbështetet në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht, si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Megjithatë, për shkak të natyrës mjaft komplekse dhe shumë dimensionale që ka ky dokument, duke mbuluar nevoja të territorit urban dhe rural, gjatë hartimit të tij janë referuar edhe akte të tjera ligjore e nënligjore si dhe dokumente udhëzuese. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar";
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar";
- Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";
- Vendimet e KKT-së në 3 vitet e fundit, në lidhje me përcaktimin e çështjeve, zonave dhe objekteve të rëndësishme kombëtare;
- Manuali teknik "Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri";

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të këtij dokumenti është mbështetur mbi përcaktimet ligjore për sa i përket strukturës së instrumenteve (dokumenteve të planifikimit) dhe procesit që duhet të ndiqet. Kështu, për nga ana përmbajtësore, ky dokument përmban kapitullin e analizave, duke veçuar këtu analizën e metabolizmit, por edhe analiza territoriale dhe social-ekonomike, që hapin shtegun për analizat e thelluara në vijim të hartimit të Planit. Më pas, paraqiten përfundimet përfshirë edhe analizën e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, si dhe hapa drejt një vizioni rajonal, për kontekstin më të gjerë, në të cilin ndodhet Bashkia e Beratit.

Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vizionin vendor të zhvillimit territorial, mjedisor e social-ekonomik, së bashku me objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit. Më pas, është hartuar plani i veprimit me afate kohore dhe konsiderata financiare si dhe një listë e projekteve prioritare e strategjike të zhvillimit lokal territorial, për të cilat bashkia ka gatishmëri të aplikojë për fonde dhe të përgatitë projekte teknike.

Ky dokument ndërtohet jo vetëm mbi bazën e analizave shkencore e territoriale, por edhe të nevojave dhe dëshirave të shprehura nga banorë dhe grupet e ndryshme të interesit në Bashkinë Berat. Gjatë periudhës së hartimit të tij, janë realizuar të paktën 3 dëgjesa publike, nga një për çdo fazë të hartimit të dokumentit (nisma, analiza, vizioni), si dhe janë kryer takime të ngushta me ekspertë vendorë, përfaqësues të biznesit e aktorë të tjerë që operojnë në këtë territor. Po ashtu, janë realizuar shumë vizita në terren e institucione publike me qëllim grumbullimin sa më të efektshëm të informacionit dhe krijimin e bazës së të dhënave në sistemin gjeografik të informacionit.

Në vijim, Bashkia e Beratit do të punojë ngushtësisht me projektin PLGP për të kaluar në hapat ligjore e teknike të hartimit të planit të përgjithshëm (përdorimi i tokës, infrastrukturat, mjedisi) dhe të rregullores së tij. Finalizimi i planit të përgjithshëm të territorit do të jetë një nga arritjet më të para të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t'iu përgjigjur nevojave edhe afatgjata të qytetarëve, si dhe për të përballur sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.



## Hyrje

Bashkia e Beratit shtrihet në krahinën malore të Shqipërisë jugore dhe pjesërisht në ultësirën perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të Lumit Osum, i cili kalon përmes qytetit të Beratit.

Shtirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peizazheve gjeografike.

Me ndarjen e re administrative, Bashkia Berat, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.


Sipërfaqja e Bashkisë Berat është 380 km<sup>2</sup>, nga 22.4 km<sup>2</sup> që ishte para Reformës Administrative Territoriale 2014. Ndryshimi i kufirit territorial është sfidë për bashkinë në zhvillimin e mëtejshëm.

**Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat**

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> ) <sup>1</sup>	Fshatrat/Qytetet në përbërje të
Berat	Qyteti Berat	Berat	19 km <sup>2</sup>	Qyteti Berat
		Otlak	52.7 km <sup>2</sup>	Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak.
		Velabisht	93.2 km <sup>2</sup>	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
		Sinjë	138.5 km <sup>2</sup>	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezet 1, Osmenezet 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
		Roshnik	78.7 km <sup>2</sup>	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimas, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 1. Pozicionimi i Bashkisë Berat



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Bashkia Berat kufizohet në veri me Bashkinë Kuçovë, në lindje me Bashkinë e Gramshit, në juglindje me Bashkinë Poliçan e Skrapar, në perëndim me Bashkinë Mallakastër e Fier.

Bashkia Berat, është qendra me e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e Qarkut Berat.

Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka një sipërfaqe prej 22.4 km<sup>2</sup> prej së cilës sipërfaqe urbane janë 6.3 km<sup>2</sup>. Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe Aeroportit “Nënë Tereza”
- 92 km nga Porti i Durrësit
- 85 km nga Porti i Vlorës
- 212 km nga Saranda dhe
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Berati njihet për arkitekturën, vlerat historike, kulturore, artistike dhe fetare. Është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë). Historia 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. I shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorit (2,416 m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Vlerat e spikatura turistike të cilat lidhen me qytetin muze 2,400 vjeçar të Beratit, parkun kombëtar të Tomorit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur janë kthyer në mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik për Beratin. Ekonomia e qytetit të Beratit mbështet në shërbime.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë ruajtur karakterin rural. Sektori kryesor i ekonomisë në këto njësi është bujqësia. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona. Edhe blegtoaria dhe përpunimi i produkteve të mishit dhe qumështit janë të zhvilluara në këto njësi.


Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionimit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare.

## I. SFIDAT E BASHKISË BERAT

### 1.1 Tendencat kryesore të zhvillimit të pas viteve 90'-të

Bashkia e Beratit ka qenë ndër qytet më të zhvilluar në periudhën e regjimit komunist, dallohej si për prodhimin bujqësor e blegtoral, ashtu edhe për atë industrial. Në këtë qytet ka qenë tepër e zhvilluar industria duke përfshirë kombinatin e tekstileve, kombinatin ushqimor dhe uzinën e baterive. Me rënien e regjimit komunist, privatizimi i tokës solli ndryshime thelbësore në përdorimin e tokës rurale dhe urbane. Duke tjetërsuar përdorimin e tokës bujqësore në tokë urbane nëpërmjet një procesi të pakontrolluar. Gjatë 25 viteve të lëvizjes së lirë, Bashkia e Beratit përjetoj rritje të zonave urbane nëpërmjet ndërtimeve informale. Sistemi i kooperativave bujqësore dhe shumë zona industriale u mbyllën ose u shkatërruan. Papunësia e lartë, niveli i ulët i prodhimit bujqësor, si dhe mungesa e shërbimeve, nxitën migrimin masiv të popullsisë, i cili vazhdon me ritme të larta edhe në këto pesë vitet e fundit. Raporti midis të ardhurve dhe të larguarve në vitin 2014 ishte 30% të ardhur dhe 70% të larguar.

Figura 2. Fazat e zhvillimit të vendbanimeve në vite




Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Rritja e popullsisë rriti presionin e zhvillimit urban. Përqendrimi i popullsisë në qytete solli nevojën e shtimit të ndërtimeve, të cilat brenda një periudhe kohore të shkurtër, ndryshuan tërësisht pamjen e qytetit. Presioni i lartë i zhvillimit dhe zhvillimi i pakontrolluar, rikthimi i pronës private dhe lëvizja e lirë ishin faktorët kryesor që kontribuan në pamjen e qytetit sot. Në Bashkinë Berat u ndërtuan banesa individuale nga banorët që u zhvendosën duke krijuar zonat informale. Zhvillimi i vendbanimeve ka tre momente kohore të rëndësishme:

- Para viteve 1990
- Deri në vitin 2007
- Deri në vitin 2013

Figura 3. Shtimi i sipërfaqes së ndërtuar 1990 - 2013



Burimi: Co-PLAN, 2015

Ashtu si u theksua më lart presioni i zhvillimi gjatë periudhës së tranzicionit dhe papërgatitja e institucioneve qendrore dhe lokale për t'iu përgjigjur këtij zhvillimi nëpërmjet planifikimit solli zhvillim të pakontrolluar duke shkaktuar probleme mjedisore si dhe pamundësi për investime private dhe publike. Në vijim do të evidentohen një pjesë e problemeve, potencialet dhe mundësitë e Bashkisë Berat nëpërmjet analizave. Mbështetur në këto analiza janë përcaktuar projektet për zhvillimin e territorit të cilat mund të kapitalizohen nga bashkia apo palët private të interesuara në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në bashki.




## Policentrizmi

Shtrirja territoriale, dendësia e banimit, komunikimi për punë e shërbime dhe vazhdimësia e zonës së banuar në dy dekadat e fundit, e kanë klasifikuar Beratin (para ndarjes territoriale) si qendër **aglomerati** dhe së bashku me Kuçovën (gjithashtu qendër) dhe 3 njësi rrethuese (Perondi, Otlak dhe Ura Vajgurore) si aglomeratin e Berat-Kuçovës (aglomerat bipolar). Nga këto njësi, bashkia e Beratit përfshin vetëm 2 (Beratin dhe Otlakun), popullsia e të cilave përbën 76% të **popullsisë** së bashkisë pas reformës.

Ky lloj zhvillimi territorial, nëse shoqërohet edhe me disa parametra të tjerë morfologjikë e funksionalë (Prodhimi i Brendshëm Bruto - PBB, numri i udhëtarëve me transport publik, numri i studentëve, etj.) përcakton llojin e modelit policentrik ose jo të territorit përkatës. Studimi i policentrizmit bazohet në rëndësinë e tij si objektivi i Bashkimit Evropian **BEJ** fillimisht i prezantuar nga Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor (European Spatial Development **Perspective ESDP**) dhe më pas i zbërthyer në politikën e BE për zhvillim rajonal, në politikën e transportit, etj. Sipas këtyre dokumenteve, “sistemet policentrike janë më efikase, më të qëndrueshme dhe territorialisht më të balancuara se sa ato monocentrike, apo të shpërhapura” **(ESDP, 1999)**. Këto sisteme sigurojnë ekonomi të shkallës, kohezion dhe mbrojtje të mjedisit. Për të studiuar policentrizmin në Shqipëri, Co-PLAN u bazua në hartën e 17 aglomerateve shqiptare të INSTAT, duke shtuar edhe informacionin (e prodhuar nga Censusi 2011) mbi lëvizjet ditore për në punë **baseni i punësimit** e duke krijuar Zonat Funksionale Urbane (ZFU).

Figura 4. Zonat Funksionale Urbane në Shqipëri




Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Shtatë tregues të policentrizmit morfologjik u analizuan për çdo ZFU, dhe shtatë tregues të policentrizmit funksional u [krahësohen]. Treguesit e policentrizmit morfologjik u kombinuan në 3 indekse dhe këto të fundit u kombinuan në indeksin e policentrizmit. Në këtë këndvështrim, Shqipëria është tejte monocentrike sa i përket indeksit të madhësisë (97 nga 100) dhe të lidhshmërisë (72 nga 100), për shkak të përqendrimit të [popullsisë dhe PBB-së] në ZFU-në e Tiranës dhe aksesueshmërisë së lartë të ZFU-ve Tiranë e Laç krahasuar me të tjerat. Por Shqipëria është policentrike (28 nga 100) sa i përket indeksit të vendndodhjes për shkak të shpërndarjes thuajse uniforme në të gjithë territorin të 18 qendrave. Pozicionimi i qendrave, edhe pse funksionalisht flasim për nivel të lartë monocentrizmi, është potencial në favor të mbështetjes së një zhvillimi policentrik në nivel vendi dhe duhet shfrytëzuar si i tillë.

ZFU-ja e Berat-Kuçovës nuk mbivendoset me ZFU-të fqinje dhe ka një popullsi prej 116,653, ku bashkia e Beratit përbën 54%. Vetë ZFU-ja edhe pse mbulon më pak se gjysmën e territorit të qarkut të Beratit, përfshin 78% të popullsisë së tij. Ky është tregues për një nivel të lartë monocentrizmi fizik, ku popullsia përqendrohet në qendrat e aglomeratit. Në fakt edhe nëse shohim hartën e shpërndarjes në territor të zonave të ndërtuara vihet re përqendrimi përgjatë ngushticës së Osumit në Berat dhe sigurisht në polin tjetër të aglomeratit, në Kuçovë. Midis këtyre poleve kemi një shpërndarje pikësore të qendrave të banuara nëpër territor, që vjen duke u venitur sa më shumë lëvizim drejt zonave malore dhe me akses të dobët.

Një tjetër analizë e realizuar është ajo e policentrizmit potencial, e cila tregon mundësinë e një rajoni për të qenë qendër interesi për investime e zhvillim, duke ndryshuar kështu hartën e zhvillimit policentrik e rajonal. Për këtë qëllim, për çdo qendër aglomerati/ZFU-je u vizatua izokroni 45-minutësh (duke bashkuar të gjitha pikat në hartë në të cilat mund të arrihet nga qendra për 45 minuta udhëtim me transport rrugor). Izokroni 45-minutësh përcakton hapësirën e lëvizjes ditore vajtje-ardhje të pranueshme për në punë. Çdo bashki, është parimisht e interesuar të investojë brenda një hapësire të tillë për të shtuar infrastrukturën dhe shërbimet e për të rritur cilësinë e tyre, në funksion të ekonomisë së shkallës dhe zhvillimit ekonomik. Izokroni 45-minutësh i Beratit mbulon pjesën më të madhe të territorit të bashkisë, duke lënë jashtë periferitë më malore e madje shtrihet deri në Poliçan në jug. Sigurisht ky izokron mbulon bashkinë e Kuçovës dhe shtrihet deri në kufi me Lushnjën. Në pjesën veriore (Kuçovë), izokroni i Beratit mbivendoset me të Fierit dhe veçanërisht të Lushnjës, duke evidentuar Kuçovën e Urën Vajgurore si dy bashki me mbulim të mirë si nga Lushnja e Fieri dhe nga Berati, sa i përket interesit të ardhshëm për investime si zonë e mundshme punësimi.

**Figura 5. Mbivendosja e izokroneve 45' - Zonat e integrimit të mundshëm**



*Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015*

Analiza e policentrizmit (aktual dhe potencial) e paraqet bashkinë e Beratit si një zonë relativisht periferike ndaj flukseve të lëvizjes, përqendrimit të popullsisë, interesit për punësim, numrit të studentëve dhe vlerës së shtuar bruto. Nga ana tjetër, Berati renditet mirë për numrin e hoteleve, edhe pse këto të fundit nuk mbështeten nga një aktivitet ekonomik e turistik në rritje. Ky lloj periferialiteti lidhet edhe me pozicionimin e Beratit në skaj të një aksi kombëtar dhe në rrëzë të një zone të thellë malore dhe me vlera mjedisore. Ky pozicion ka edhe avantazhet e veta, pasi Berati është afër qendrës së me potencialin më të lartë për investime publike (Ura Vajgurore-Roskovec-Lushnje-Belsh-Cërrik-Peqin), por njëkohësisht është portë hyrëse për në një nga zonat më të vlefshme të turizmit malor e natyror në Shqipëri. Në vijim do të flitet se mund të shfrytëzohet ky avantazh konkurrues në funksion të zhvillimit ekonomik në Bashkinë e Beratit.



## 1.2 Territori dhe mjedisi

### 1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike

Berati shtrihet në krahinën malore jugore, në Albanidet Jugore, me shkëmbinj karbonatikë të mesozoit e më pak formime terrigjene e kuaternare, si dhe bën pjesë në tri zona tektonike (Jonike-rreth 90%, e **Krujës dhe e Sazanit**)<sup>11</sup>. Territori ku kalon lugina e lumit Osum në Bashkinë Berat, përbëhet nga shkëmbinj karbonatikë të kretakut dhe paleocen-eocenit, si dhe nga flishi i paleogjenit e neogjenit. Në këtë zonë ka një larmi litologjike, me evolucion morfologjik e lëvizjet tektonike që kanë hapur luginën dhe kanë shkaktuar kontraste të theksuara midis pjesëve të saj. Në qytetin e Beratit, lumi Osum ka çarë tërthorë strukturën antiklinale të Beratit, ku ka formuar grykën antecedente të thellë e të ngushtë të Goricës me gjatësi rreth 600-700 m e gjerësi në shtrat 50-60 m, që shkon 2-3 km në Uznovë dhe një gjerësi që shkon deri në 700-900 m. Kjo luginë përgjithësisht është në fazën **pjekurisë**<sup>12</sup>.

Qyteti i Beratit është një ndër qytetet më të vjetrat të Shqipërisë, me një trashëgimi të veçantë kulturore/historike, i shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorit (2,416 m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Zona ka një ndërtim gjeologjik të thjeshtë, më i rregullt i krahasuar me zonat e tjera. Tipari më karakteristik morfografik i relievit të saj është ndërthurja shumë e rregullt e vargjeve malore me luginat që pasqyrojnë ndërthurjen e strukturave kryesore të krahinës, të antiklinaleve me sinklinalet. Nga pikëpamja klimatike qyteti i Beratit karakterizohet nga një klimë mesdhetare, fushore, me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Pozita e favorshme gjeografike e tij bën që qyteti të ketë mesatarisht 300 ditë me diell në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.9°C, ku muaji më i ftohtë është Janari (me temperatura mesatare përkatësisht për dhjetëvjeçarët '71 - '80 dhe '80 - '90 prej 7.2 °C dhe 6.5 °C) e muaji më i nxehtë është Korriku (temperaturë mesatare 24 °C). Stina e vjeshtës është më e ngrohtë se ajo e pranverës, për shkak të ndikimit të detit, ku erërat depërtojnë lehtë përmes fushës së Myzeqesë në drejtim të qytetit. Amplituda vjetore e temperaturës është 17.5°C.

Regjimi i erërave është i lëkundshëm në zonën e Beratit, si pasojë e ndryshimit të vazhdueshëm të trysnisë atmosferike të qendrave barike. Erërat juglindore janë më të forta gjatë muajve të ftohtë, me maksimumin e vlerës në nëntor dhe minimum në gusht. Mbizotërimi i kësaj ere dhe ngritja e saj e shpejtë në % shpjegohet me forcimin e ciklonit të Islandës, ndërsa rënia pas nëntorit shpjegohet me ndikimin e anticiklonit të Siberisë. Po ashtu bie ndikimi i qendrës lokale të Tomorit, që shkakton erën karakteristike të Tomorit me drejtim juglindje. Në mars-gusht kemi forcimin e anticiklonit të Azoreve, që sjell uljen e përsëritjes në % të juglindjes, duke ndryshuar drejtimin e erërave në të kundërt. Shpejtësia minimale e erës është në shtator (0.8 m/s-0.9 m/s, si pasojë e ndikimit të azoreve dhe shpejtësisë së vogël të zhvendosjes së masave ajrore të mbarsura me lagështi të Islandës. Kemi gjithashtu dhe ndikimin zbutës minimal të lumit Osum). Vlera maksimale është në Shkurt (10 m/s). Kjo lidhet me uljen e sasisë së reshjeve dhe ndikimin e anticiklonit të Siberisë që sjell një shpejtësi në zhvendosjen e masave **ajrore**<sup>13</sup>. Reshjet gjithashtu ndikohen nga fenomenet e mësipërme. Reshjet janë të çrregullta. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është 928 mm, me sasinë më të madhe të tyre në Tetor-Nëntor. Muaji më i thatë është korriku me mesatare 291 mm për periudhën '71-'80 dhe 26 mm për periudhën '80-

## 1.2.2 Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM nr. 671 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuara janë: Fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Analizimi i flukse bëhet nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Ato krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit) vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorin të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- **Energjia në Rajon**

Rajon që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnjë, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, **Pogradec 13** ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: *Bankers* (Patos-Marinëz), *TransAtlantic* (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), *Sherwood* (Kuçovë), *Trans oil group* (Visokë); *Phoenix* (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Edhe energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore e energjisë.


Lumenj si Shkumbin, Osumi, Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike, vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë por edhe për bizneset, industrinë apo institucionet, siç mund të shihet edhe më poshtë.

Burimet alternative të energjisë, si dielli, era, energjia gjeotermale, shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që ka për t’u përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret në ultësirën perëndimore, ku Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veri-perëndimore) mund të përdoret për prodhimin e energjisë.

Energjia diellore është potencial thujse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë, rrezatimi arrin vlera nga 1450 kwh/m<sup>2</sup> deri në 1650 **kwh/m<sup>2</sup> 16**. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore.

Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime gjeotermale, temperatura e të cilëve arrin >80 °C.

Figura 6. Harta e fluksit të energjisë në rajon



### • Uji në Rajon


Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj të më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë, në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuiferë ndërkokrrizorë me përcjellshmëri të lartë shumë të larë uji, të cilët dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifer me porozitet karst-çarje me përcjellshmëri shumë të ndryshueshme shumë të lartë të lartë uji gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) në pjesën jugperëndimore të bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore kanë një nivel më të ulët filtrimi, ndaj dhe mundësia për të përthithur ndotjen



në zonat e zhvilluara është më e lartë. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferët karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

**Figura 7. Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore)**



*Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2013*

- **Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Berat**

Analiza e Metabolizmit të territorit në Bashkinë e Beratit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Berati ka në sipërfaqe prej **580 km<sup>2</sup>** dhe popullsi **60 342 banorë**. Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

- **Fluksi i energjisë**

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e bashkisë Berat. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat janë të mbishfrytëzuara.

*Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e Bashkisë Berat*

Bashkia Berat shtrihet në një zonë me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto pasuri ujore shfrytëzohen për prodhimin e energjisë hidrike. Në territorin e Bashkisë Berat operojnë dy hidrocentrale, Bigas 1 (3,161 MWh) dhe Bigas 2 **1,500 MWh<sup>-1</sup>**.

**Tabela 2. HEC-et, Bashkia Berat**

Bashki	NJA	Pellgu	Lumi/ Përroi	Kuota e Godinës Centralit	Kuotat e veprës së marrjes	Hec-i	Shoqëria Koncesionare	Fuqia	Energjia	Viti i lidhjes së kontratës
Berat	Velabisht	Osum	P. Bigas	387.5	517.5	Bigas 1	"Hp Bigas & Veleshnjë Energy" shpk	600	3,161,000	2013
Berat	Velabisht	Osum	P. Bigas	519	588	Bigas 2	"Hp Bigas &Veleshnjë Energy" shpk	300	1,500,000	2013

*Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015*

Shqipëria kë një rrezatim diellor të konsiderueshëm për t'u përdorur si burim energjie. Bashkia Berat ndodhet ndërmjet izolinjave 1450-1500 kwh/m<sup>2</sup> në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Beratit luhetet nga 1615 në muaj (dhjetor) deri në 6520 në muaj **korrë**. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individual me panele **photovoltake**.

*Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje*

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Berat dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011 sipas INSTAT numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri i Njësive Ekonomike Familjare është **722, 600 familje** (Tabela 2). Konsumi mesatar i energjisë

elektrike për familje në një vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (2,587,535)/nr. e familjeve (722, 600) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MWh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km<sup>2</sup>, shumëzohet nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

**Tabela 3. Rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011**

<b>Popullsia banuese gjithsej</b>	<b>2 821 977</b>
<b>Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare</b>	<b>722 600</b>

Burimi: INSTAT, 2011


**Tabela 4. Bilanci i Energjisë Elektrike, 2011**

<b>Emërtimi</b>	<b>Energjia (MWh)</b>
<b>Energji në dispozicion (Burimet)</b>	<b>7,532,055</b>
<i>Prodhimi neto vendas</i>	4,057,089
<i>Termocentrale</i>	0
<i>Hidrocentrale</i>	4,057,089
<i>Importi bruto (energji në marrje)</i>	3,474,966
<i>Eksporti bruto (energji në dhënie)</i>	300,544
<b>Konsumi i energjisë elektrike</b>	<b>7,210,731</b>
<i>Humbjet në rrjet</i>	2,179,157
<b>Familjet</b>	<b>2,587,907</b>
<i>Të tjera</i>	2,443,667

Burimi: INSTAT, 2011



Figura 8. Fluksi i energjisë në Bashkinë Berat



Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Bazuar tek të dhënat nga INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në qarkun Berat, nga njësi ekonomike familjare **NJEF** vazhdon të jetë energjia e përfutur nga drutë e zjarrit. 62% të NJEF-ve në qarkun Berat përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (23%) dhe më pas nga energjia elektrike (8%).

Tabela 5. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	38 493	19 023	19 470
Dru	23 655	6 824	16 831
Energji elektrike nga rrjeti	3 183	2 918	265
Gaz	9 016	7 146	1 870
Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, naftë, etj.)	110	69	41
Pa ngrohje	2 529	2 066	463

- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e bashkisë Berat dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, imbotilim (mbushje e shisheve me ujë), shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdorim nga banorët, bizneset, industrinë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e bashkisë Berat) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor .

Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 8.4 km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e bashkisë Berat . Në ujërat sipërfaqësore të Beratit bëjnë pjesë lumenjtë Osum, Velabisht, Vërtop, Zagoria, përrenjtë dhe degëzimet e tyre si dhe të gjitha kanalet ujëtëse.

Sa i përket përdorimit të ujërave nëntokësore, ato furnizojnë akuiferët me porozitet çarje-karst dhe përcjellshmëri të ndryshueshme shumë të lartë-të lartë uji përgjatë Lumit Osum, duke kaluar edhe në zonën urbane dhe pranë zonave industriale, të cilat janë të klasifikuara si vatra të nxehta (hotspote) siç është ish-fabrika e baterive. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 1486,58 l/sek. (Harta Hidrografike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH). Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike, etj.

Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në bashkinë Berat, rezultojnë që territori i bashkisë ka mbulim me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve vetëm në qytetin e Beratit dhe NjA Otlak. Njësitë administrative Sinjë, Velabisht, Roshnik janë të pambuluar me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Berat , furnizohet me ujë nga burimet e Bogovës, prurja ndryshon nga periudha e dimrit 2,000-2,400 l/sek, në verë me 350 l/sek. Gjithashtu furnizimi i sistemit të ujësjellësit bëhet nga katër puse në Uznovë, kapaciteti prodhues i të cilëve është 100 l/sek. Sasia mesatare e ujit që shfrytëzohet nga sistemi i ujësjellësit është në total 700 l/sek.

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat UK Berat dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë, numrin e banorëve për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e bashkisë Berat. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë banorë është 100 l/banorë/ditë.



**Figura 9. Fluksi i ujit në Bashkinë Berat**



**• Fluksi i ushqimit**

Fluksi i ushqimit, analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Berat do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe është më e rëndësishme të analizohen në nivel kombëtar.

Ndërsa në këtë rast mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturën ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasia e produkteve që shkon në treg dhe sasia e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave të Bashkisë Berat, në territorin e Beratit prodhohet një sasi e konsiderueshme produktesh bujqësore dhe blegtorale.

**Tabela 6. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Berat**

Përbërës Nivel I		Përbërës Nivel II	Treguesit Prodhim	Njësia hapësinore	Burimi i të dhënave
<b>Prodhim Bimor</b>	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	11,332	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Perime (ton)	11,539	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Patate (ton)	1,810	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Fasule (ton)	352	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Bimë industriale (ton)		Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Foragjere (ton)	113,575	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
	Prodhime në serra	Perime (ton)	4,800	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	10860	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Ullinj (ton)	5100	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Agrume (ton)		Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
	Rrush gjithësej (ton)	7,050	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat	
<b>Prodhim Blegtoral</b>	Prodhim Blegtoral	Qumësht	15,693	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	2,935	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Lesh (ton)	76.9	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Vezë (kokrra)	49,466,000	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat
		Mjaltë (ton)	27	Bashkia Berat (61 njësi)	Bashkia Berat

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Figura 10. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Berat**



Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Berat është 170 km<sup>2</sup>. Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqësore të rëndësishëm, ku sipërfaqja totale e mbjellë me ullinj është 31.9 km<sup>2</sup>

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat të INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Si mund të kuptojmë nga fluksi në disa raste daljet (treg dhe eksport janë më të larta se hyrjet (prodhimet). Kjo ndodh sepse një pjesë e produkteve që konsumohen nuk prodhohen në qarkun e Beratit, arsye tjetër është se burimi i të dhënave është i ndryshëm, prodhimet janë përcaktuar nga INSTAT ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.


Tabela 7. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për Qarkun e Beratit

			HYRJE	POTENCIALET PRODHUESE	
Përbërës I	Përbërës II		Prodhim	Treg	Eksport
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	49,354		
		Perime (ton)	90,408	36,036	22,900
		Patate (ton)	6,363		
		Fasule (ton)	1,307		
		Bimë industrial (ton)	81		
		Foragjere (ton)	82,709		
	Prodhime në serra	Perime (ton)	18,386	146,140	98,060
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	22,295	33,130	800
		Ullinj (ton)	23,082	66,146	-
		Agrume (ton)	1,884	737	-
		Rrush gjithsej (ton)	26,460	6,150	-
Prodhim i Blekt oral	Prodhim Blegtoral	Qumësht (ton)	65,244	67,358	-
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	10,500	20,493	-
		Lesh (ton)	289		
		Vezë (kokrra)	73,658,000	40,000,000	-
		Mjaltë (ton)	177	863	-

Burimi: INSTAT (Prodhimi) dhe MBZHRAU (Treg dhe Eksport) 2014, Përpunoi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015




Figura 11. Prodhimet Bujqësore (në kton), Bashkia Berat 2014




Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 12. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Bashkitë: Berat, Lushnjë, Fier, Elbasan dhe Kuçovë




Burimi: Bashkia Berat, Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Lushnjë, Bashkia Kuçovë, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Figura 13. Prodhimet bujqësore për periudhën 2012-2013-2014 (në kton), Qarku Berat




Burimi: INSTAT 2014, Përpunoi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 14. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në ton), në Qarkun: Berat, Fier dhe Elbasan




Burimi: INSTAT 2014, Përpunoi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 15. Prodhimet blegtorale (në kton), Bashkia Berat 2014



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 16. Prodhimet blegtorale në vitin 2014 (në kton), në Bashkitë: Berat, Lushnjë, Fier, Elbasan dhe Kuçovë



Burimi: Bashkia Berat, Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Lushnjë, Bashkia Kuçovë, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

- **Fluksi i mbetjeve**

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Niveli i mbulimit me shërbim në zonën ku ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve është 100%. Vend-depozitimi i mbetjeve në Berat ndodhet në Orizaj afërsisht 5 km larg qendrës së qytetit, pranë shtratit të Lumit Osum dhe 1 km larg vendbanimeve. Vendndodhja e këtij sheshi është në një zonë ku shtresat nëntokësore ujëmbajtëse përgjatë Lumit Osum, ndaj mundësia që ndotja të depërtojë në shtresat nëntokësore është më e lartë. Sasia e mbetjeve që janë depozituar në vitin 2014 është 13,883 ton mbetje/vit. Ashtu si thuajse të gjitha vend-depozitimet në Shqipëri edhe vend-depozitimi i Beratit është jashtë kushteve të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 26.01.2011 “Për administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”.

Problem vazhdon të mbetet diferencimi i mbetjeve që në burim, kjo sjell problem në riciklimin apo përpunimin e mbetjeve. Tregues i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për tu ricikluar nga kompanitë ricikluese të vendosura në Shqipëri. Sasia e mbetjeve të importuara në vitin 2013 në Shqipëri është 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të riciklueshme .


Në territorin e Bashkisë së Beratit operon një kompani ricikluese, B-Recycling, është e vendosur në Otlak (fshatin Orizaj) dhe grumbullon e më pas copëton material plastike dhe polietilene.

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Berat (territori pas reformës), jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km<sup>2</sup>. Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.6 kg . Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç është qyteti i Beratit. Sasia e gjeneruar në qytetin e Beratit, në zonën urbane, arrin vlera 1101-2417 ton/vit për km<sup>2</sup> .

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e bashkisë Berat është 74.46%, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 47.1%, 14% plastika dhe 13% letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj që ky proces të realizohet.



**Figura 17. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Berat**



**• Përfundime**

Analiza e metabolizmit tregon se si funksionon territori i bashkisë në lidhje me disa nga flukset kryesore të burimeve të tij, nga prodhimi deri në konsumim dhe prodhim të mbetjeve. Në territorin e Beratit energjia diellore mund të përdoret në periudha të caktuar, ku rrezatimi diellor është më i lartë. Energjia diellore mund të përdoret kryesisht në mënyrë individuale nëpërmjet paneleve fotovoltaike, për ngrohjen e objektit, ngrohjen e ujit, për pajisje të tjera elektroshtëpiake, të cilat përdorin energji elektrike, etj. Në këtë mënyrë enegjia që shpenzohet aktualisht për ngrohje, që përftohet kryesisht nga drutë e zjarrit duke rritur në këtë mënyrë mbrojtjen ndaj mjedisit. Shpejtësia mesatare e erës luhatet nga 2.6-3.1 m/s, çka tregon për potencialin e prodhimit të energjisë duke përdorur erën si burim. Nëse të gjitha potencialet që ka bashkia Berat për prodhimin e energjisë përdoren, siç janë energjitë e rinovueshme, sasia e energjisë do të mbuloje të gjitha nevojat që ka ky territor për furnizim me energji. Gjithashtu përdorimi i burimeve alternative mbron mjedisin dhe përdor burimet në mënyrë efikase.

Shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtrihet në të gjithë territorin nën administrimin e Bashkisë Berat. Ky shërbim ofrohet më tepër në zonën urbane të bashkisë dhe sistemi i shpërndarjes është konvencional (rrjet tubacionesh), por mund të përdoren edhe pusët për në zona të caktuara, në këtë mënyrë sigurohet edhe një mbulim më i mirë i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm. Sasia e ujit që prodhohet për pirje aktualisht është 5,294 m<sup>3</sup>/orë ndërkohë që kërkesa aktuale për ujë është 577 m<sup>3</sup>/orë, pra prodhohet gati 9 herë më shumë se kërkesa aktuale. Duke pasur

parasysh këtë potencial që ka Bashkia Berat për fluksin e ujit, duhet që shërbimi i furnizimit me ujë të ofrohet në të gjithë territorin.

Nga fluksi i ushqimit mund të kuptojmë që Berat është i specializuar në prodhimin e foragjerëve, perimeve, drithërave, rrush, sigurisht ullinj dhe pemë frutore. Territori i Beratit ka sipërfaqe të konsiderueshme natyrore të cilat janë potencial për mbjelljen e drufrutorëve, duke rritur kështu prodhimin e këtyre kulturave bujqësore. Duke iu referuar edhe Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme për Beratin janë: ullinjtë, vreshtat dhe pemët frutore (më tepër qershë dhe pjeshkë). Kulturat blegtorale me prodhimin më të lartë janë qumështi, mjalti dhe vezët.


Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim, në këtë mënyrë do të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Për këtë pushteti vendor duhet të përdorë stimuj që nxisin procesin e diferencimit të mbetjeve që në burim. Vend-depozitimi që ndodhet Orizaj duhet transferuar diku tjetër pasi kjo zonë është e papërshtatshme, pranë lumit Osum në tokë aluvionale. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë Berat dhe jo vetëm në zonën urbane.

### 1.2.3 Mjedisi, ekosistemet dhe ndotja

- **Burimet ujore sipërfaqësore**

Bashkia Berat ka një rrjet të pasur hidrik. Lumi i Osumit përbën boshtin kryesor të këtij rrjeti i ndjekur nga Përroi i Molishtit. Osumi (rrjedha e mesme e tij) përshkon territorin e Bashkisë së Beratit përgjatë 21 km nga pjesa jug-lindore në Malinar deri në Moravë në veri ku lumi del nga bashkia drejt Urës Vajgurore. Osumi buron në zona të larta dhe sjell me vete të gjithë erozionin e grumbulluar gjatë rrjedhës së tij të sipërme. Nga degët e Osumit mund të përmenden lumi Zagoria me të cilin bashkohet në Uznovë, përroi Gushtavë dhe përroi Lapardha (në anën e djathtë të lumit). Në anën e majtë, Lumi Osum merr me vete Lumin Molisht, afër Velabishtit, i cili buron jashtë territorit të bashkisë. Përroi i Molishtit hyn në Bashki në Veleshnjë në jug, përshkon territorin e bashkisë drejt Gjerevenit dhe bashkohet me Osumin afër Urës së Re, Berat. Përveç Osumit, Bashkia ka dhe një numër të madh rezervuarësh të shpërndarë nëpër fshatra. Ndër ta dallohen rezervuari ndërmjet Sinjës dhe Mbolanit, rezervuari i Mbjeshevës në perëndim të Shpiragut, i Mreshtanit, rezervuari ndërmjet Kamçishtit e Gjerovenit, rezervuari ndërmjet Vodëzës së Sipërme e Qereshnikut, ai i Roshnikut, dhe rezervuari në Perëndim të Qafë Dardhës.

**Figura 18. Burimet ujore dhe akuiferët e Beratit**



Burimi: SHGJSH; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015


Si rrjedhojë e mangësive në menaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, në rrjedhën e mesme dhe të ulët të Osunit, zona ripariene ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë të gjithë brezat e bimësisë së nevojshme-bimët e ulëta deri tek ato të larta-ose nuk ekziston). Në disa raste, zona ripariene është kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmytjet) dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.

Dëmtime, të shkaktuara nga proceset gjeologjike e gërryese të vetë lumit si dhe ato nga ndërhyrja e njeriut në territor nëpërmjet bujqësisë e urbanizimit, të zonës ripariene janë vënë re përgjatë gjithë rrjedhës së lumit. Seksioni lumorë në jug-lindje të territorit të Bashkisë Berat, i cili shtrihet në njësitë Malinat-Bilçë ka ndërhyrje në zonën ripariene të lumit me karakter natyror/bujqësor. Ndërkohë, përgjatë shtrirjes së mëtejshme të lumit në zonat jug, jug-perëndimore dhe perëndimore të territorit të Beratit, duke filluar nga njësia Drobonik e deri në daljen e tij në bashkinë e Kuçovës, nëpërmjet njësisë Moravë, ndërhyrjet në zonat ripariene ndikohen/dëmtohen nga aktivitetet urbane, industriale si dhe bujqësore.

Duke pasur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë qendrore, dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, **Co-PLAN** kreu monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Semanit (Osum, Devoll, Seman e

Gjanicë). Pikat e monitorimit dhe disa parametra kimike janë të përbashkët me monitorimet e ujërave të lumenjve kryesorë të Basenit të Semanit të kryera nga AKM me përjashtim të pikës Mujallë. Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh direktiva të ndryshme të Bashkimit Evropian.

Figura 19. Harta e marrjes së kampioneve për monitorim në Osum




Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Nga monitorimi i kryer në Osum, u vu re se ujërat e lumit Osum janë alkalinë ( $\text{pH} > 7$ ) në të gjitha pikat e monitorimit, brenda dhe jashtë territorit të bashkisë. Një përfundim i tillë është arritur edhe nga monitorimi i ujërave nga AKM në vitin 2014.



Figura 20. pH i ujërave të Osumit




Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Në lumin Osum, thellësia e depërtimit të dritës është në nivele të pranueshme tek pjesët e sipërme të rrjedhës, por depërtimi i dritës paraqet probleme më të theksuara në zonat me erozion të lartë (afër bashkimit me Devollin). Përçueshmëria elektrike është brenda parametrave mjedisorë, me vlera që luhaten nga 309 deri në 392 (microS/cm). Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçueshmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore.

Vlerat e  $NBO_5$  janë brenda normës në të gjitha pikat e monitorimit, vlera këto të njëjta me vlerat e AKM-së. Duke pasur parasysh derdhjen e ujërave të zeza në lumë (siç ndodh përgjatë rrjedhës jashtë dhe brenda bashkisë), vlera e  $NBO_5$ -së tregojnë qartë nevojën për të analizuar  $NBO_{5-2n}$  në lidhje me faktorë të tjerë (me vend-ndodhjen e burimeve kryesore të ndotjes në lumë, industrisë përkundrejt ujërave të zeza të zonave të banuara, përmbajtjes së metaleve të rënda përkundrejt ushqyesve, etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë ngadalëson ose zvogëlon ndjeshëm  $NBO_5$ , sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave. Sipas AKM-së, në vitet e fundit është vënë re një tendencë në rritje e vlerave të këtij parametri.

Figura 21. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Osum




Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015



Lënda e ngurtë pezull (TSS) është  $< 2$  mg/l në të gjitha pikat e monitorimit dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore. Ndërkohë, lënda e ngurtë e tretur (TDS) ka vlera më të larta krahasuar me TSS. Kjo lidhet me burimet e TDS që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të TDS vihen re në zonën nga Ura e Goricës tek Ura Vajguore.


Figura 22. Lënda e ngurtë pezull dhe e tretur në Osum



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Përmbajtja e nitrateve N-NO<sub>3</sub> në Osum është brenda normave të cilat vijnë duke u rritur gradualisht nga burimi në grykëderdhje. Një trend të ngjashëm ndjekin edhe nitritet (N-NO<sub>2</sub>). Përmbajtjet më të larta janë afër Kuçovës, përpara bashkimit të Osumit me Devollin. Amoniakut (N-NH<sub>4</sub>) paraqitet më i lartë në Uznovë, tek Ura e Goricës në Berat dhe në Kuçovë. Ndërkohë, në rast se përcaktimi i gjendjes së ujërave të lumit bëhet në bazë të vlerave të lejuara të përdorura nga AKM, vlerat e nitrateve dhe amoniakut (N-NO<sub>3</sub> dhe N-NH<sub>4</sub> përkatësisht) janë të njëjta me rezultatet e monitorimit të AKM-së dhe janë brenda normave të lejuara në të gjitha pikat e monitorimit. Një ecuri e ngjashme vihet re edhe në lidhje me vlerat e nitriteve (N-NO<sub>2</sub>) të cilat janë brenda normave me përjashtim të segmentit të lumit në Urë Vajguore ku gjendja e ujit është e varfër. Azoti, është një ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por i mbipërdorur në bujqësi dhe për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike shkakton ndotjen e lumit. Qyteti i Beratit shkarkon rreth 6.6 milion m<sup>3</sup> mbetje të lëngëta në vit. Ndërkohë sulfatet në Osum janë në nivele të ulëta krahasuar me standardin dhe më të larta hasen në rrjedhën e poshtme të Osumit.


Figura 23. Amoniaku, nitratat dhe nitritet në Basenin e Lumit Osum



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Nivele të larta të ndotjes në Osum hasen sa i përket bakterieve koliforme dhe metaleve të rënda. Koliformet janë mbi vlerën 300 Cfu/100ml në të gjitha pikat e monitorimit, dhe kjo është vlera më e lartë e zbulueshme nga laboratorit (ndërkohë që standardi është 330 Cfu/100ml). Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës së monitorimit të mëtejshëm të ujërave të Osumit për të përcaktuar nëse ujërat e Osumit janë të përshtatshme për ujitje dhe not. Metalet e rënda janë matur vetëm për disa pika të marrjes së kampioneve (Ura Vajguore dhe afër bashkimit me Devollin), të cilat janë jashtë territorit të bashkisë, por reflektojnë ekzistencën e burimeve ndotëse të pjesëve të mësipërme të lumit. Ujërat janë të ndotura me plumb (Pb), cadmium (Cd), nikel (Ni), hekur (Fe) dhe krom (Cr). Kadmiumi është në vlera më të larta se sa plumbi.


Figura 24. Metalet e rënda në Basenin e Lumit Osum



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkohë, vlerat e magnezit (Mn) dhe zinkut (Zn) janë brenda parametrave mjedisorë.

Figura 25. Metalet e Rënda në Basenin e Lumit Osum



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015


## Përfundimet

Rezultatet e monitorimit të ujit, por edhe studimet e mëparshme tregojnë se ujërat e Osumit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi dhe argëtim. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në Berat. Një tjetër faktor që vlen të studiohet për Osumin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga pengesat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et). HEC-et që ndërpresin Osumin (në prodhim ose të ato të projektuara) ndodhen jashtë kufijve të bashkisë (p.sh. në Vërtop-i planifikuar, apo në Bogovë-i ndërtuar, etj.). Brenda bashkisë ndodhet HEC-i i planifikuar në Drobonik (Bigas-Veleshnjë). HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si pengesë fizike), në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas pengesës, etj. Si rrjedhojë, projektet për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të zeza dhe mbetjeve industriale) dhe për rehabilitimin e tij duhet të kenë përparësi për bashkinë së bashku me projektet për menaxhimin e integruar të Osumit në bashkëpunim me bashkitë e tjera që preken nga ky lum.

- **Burimet ujore nëntokësore<sup>44</sup>**

Qarku i Beratit (i përbërë nga bashkitë e Urës Vajgurore, Poliçanit, Beratit, Kuçovës e Skraparit) ka një rrjet të pasur pellgësh ujore nëntokësore. Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës. Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për kapacitet të lartë ujëmbajtës dhe përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë të qyteteve Kuçovë, Berat dhe të komunave përreth, si dhe të industrisë dhe bujqësisë. Klasifikimi i akuiferëve (Figura 17) në të gjithë Qarkun e Beratit është bërë sipas mënyrës së qarkullimit të ujit nëntokësorë. Vlerësimi i akuiferëve është bërë duke u mbështetur në hartografimin e akuiferëve dhe në vlerësimin e parametrave hidrodinamikë e hidrokinikë të ujërave nëntokësorë. Grafiku i mëposhtëm paraqet shtrirjen e akuiferëve në përqindje sipërfaqeje:

Figura 26. Klasifikimi dhe shtrirja e akuiferëve në Qarkun e Beratit




Burimi: SHGJSH, 2014



Vetë Bashkia e Beratit përfshin pothuajse gjysmën e akuiferit me porozitet ndërkokrrizor, të shkrifët që është Akuiferi i Beratit me ujëmbajtje shumë të lartë-të lartë, i cili shtrihet përgjatë luginës së Osumit (Uznovë-Berat-Fier-Shegan). Akuiferi i Beratit ushqehet kryesisht nga lumi Osum. Në territorin perëndimor të bashkisë ndodhen pjesë të konsiderueshme të akuiferit me porozitet çarje-karst, me përcjellshmëri të ndryshueshme nga shumë e lartë në të ulët të ujit (p.sh. Akuiferi i Shpiragut dhe Tomorrit). Fenomeni i karstit në këto akuiferë është i zhvilluar ndërsa ujëmbajtja e tyre është e konsiderueshme. Cilësia e ujërave është shumë e mirë dhe nga ky akuifer furnizohen me ujë qyteti i Beratit, Poliçanit, Ura Vajgurore, si dhe Gramshi dhe Çorovoda.

Figura 27. Harta hidro-geologjike, Qarku Berat



Akuiferët shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë dhe aktivitetit industrial e bujqësor. Ujërat e akuiferëve shfrytëzohen edhe për energji siç është rasti i ujërave të burimeve të Bogovës dhe Guakut. Akuiferët shfrytëzohen edhe ilegalisht, por ky shfrytëzim është i pamatur. Akuiferët **ndërkokrrizorë** dhe me **çarje-karst** dallohen për një kapacitet të lartë ujëmbajtës dhe të gjendura drejtpërdrejt mbi vendbanimet urbane, janë shumë të ndjeshëm ndaj ndotjes mjedisore nga pushtimet për ujë, derdhja e ujërave të zeza, mbetjet e industrisë dhe ato urbane, si dhe aktiviteti bujqësor. Akuiferi nuk përkon me kufijtë administrativë dhe ndotjet mund të shkaktohen nga zona të ndryshme. Gjithsesi, bashkia e Beratit duhet të krijojë një inventar të hollësishëm të territoreve dhe pikave burimore (brenda territorit të saj) me rrezik ndotjeje për akuiferet dhe mbi këtë bazë të ndërmarrë projekte parandaluese dhe rehabilituese. Njëkohësisht,



lipset që bashkia të bashkëpunojë me bashkitë e tjera për mbrojtjen e akuiferëve nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.

- **Ajri**

Cilësia e ajrit në Berat ndryshon në varësi të territorit dhe përdorimit të tokës. Vlerat e larta të ndotjes vihen re në qytet, ndërsa cilësia e ajrit në zonën malore është shumë e mirë. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2014, seksioni i Cilësisë së Ajrit, tregon se vlerat e pikës së monitorimit në qendrën e qytetit i tejkalojnë normat vjetore të KE ( $25\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) dhe ato shqiptare ( $15\mu\text{g}/\text{m}^3$ ). Kështu, vlera mesatare vjetore  $\text{PM}_{2.5}$  ishte  $37\mu\text{g}/\text{m}^3$  ndërsa vlera maksimale ditore e  $\text{PM}_{2.5}$  e regjistruar në nëntor 2014, ishte rreth  $82.02\mu\text{g}/\text{m}^3$ . Këto vlera të larta shkaktohet kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe cilësia e lëndës djegëse. Ndërkohë një tjetër burim i ndotjes së ajrit në Berat janë edhe guroret, ku shfrytëzohet guri gëlqeror, kryesisht në Sinjë.

Ajri ndotet dhe nga djegia e pakontrolluar e mbetjeve urbane të grumbulluara në vend-depozitim të Orizaj, 5 km nga qendra e qytetit. Djegia emeton veçanërisht dioksina dhe furane, shumë të dëmshme jo vetëm për mjedisin, por edhe për shëndetin e njerëzve. Ndërkohë ekzistojnë edhe vend-depozitime informale të shtrira në territorin e ish-komunave.

Nisur nga sa u tha më lart, shohim që qyteti i Beratit dhe zonat përreth tij ndotën kryesisht nga shkarkimet e lëndëve djegëse të mjeteve motorike që lëvizin. Në zonat, ku evidentohen norma të larta të ndotësve, duhet pasur parasysh parashikimi i zonave tampon me gjelbërim për të ulur sa më shumë ndotjen e shkaktuar. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe venddepozitimeve të mbetjeve, të cilat shpesh herë janë vatra zjarri dhe burime të ndotësve toksikë në ajër, si [redacted] Bashkia duhet përmirësojë kushtet e këtyre vend-depozitimeve, duke mos lejuar vetë ndezjen e tyre, deri në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për trajtimin final të tyre.

- **Biodiversiteti, peizazhi dhe zonat e mbrojtura**

### Pyjet

Në lindje të territorit të bashkisë së Beratit ndodhet një pjesë e parkut kombëtar të Tomorit. Ai ka një shtrirje në dy qarqe të vendit (Berat dhe Elbasan) me një sipërfaqe 24,723 ha. Parku ka biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Flora e parkut është shumë e pasur, ku përmendim ahun, robullin dhe pishën e zezë, kullotat subalpine dhe alpine, si dhe një faunë të larmishme kryesisht për gjitarët e mëdhenj (ariu-Ursus arctos, ujku-Canis lupus, shpendë grabitqarë të ditës dhe të natës, etj.).

Zonat e mbrojtura në bashkinë e Beratit [redacted]

- Parku Kombëtar “Mali Tomorit”, kategoria e dytë sipas IUCN;
- Biomonumentet, kategoria e tretë sipas IUCN;
- Gjeomonumentet, kategoria e tretë sipas IUCN.

Rreth 8,398.4 ha të zonës së Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit ndodhet në Berat. Mali i Tomorit arrin lartësinë maksimale në majën e quajtur Cuka Partizan e cila ndodhet 2,416 m mbi nivelin e detit. Kurrizi i malit dallohet për një përbërje karstike gëlqerore. Përveç pyjeve të shumta, në brendësi të parkut, në Qafën e Kulmakut gjendet Teqeja e Abaz Aliut. Kjo teqe është vend pelegrinazhi për besimtarët bektashinj, kryesisht në Gusht, pavarësisht infrastrukturës së

varfër rrugore për të arritur në destinacion. Në park ndodhet edhe subjekti i ambalazhimit të ujit të pijshëm i quajtur “Bora”.

Sipas ARM-së, parku dallohet për larmi të faunës dhe florës falë lartësive të ndryshme dhe mikroklimeve të krijuara. Bimësia përfshin nga shkurret, dushkajat, pyjet e ahut, lisit, rrobullit (në lartësi 1600 m mbi nivelin e detit), pyje të përziara, pyje të pishës dhe kullotave të cilat shtrihen në kreshtën e malit. Fshatrat dallohen për pyje me bimësi të ndryshme. Në disa vende ndodhet edhe panja e malit (acer pseuplatanus) dhe pisha e zeze (pinus negra). Pyjet dallohen edhe për një nënpyll të pasur të përbërë kryesisht nga frashri, vadhëza, lajthia, molla e egër, kulumbria, dëllinja e kuqe e rrallë e zezë etj. Parku ka një botë të pasur shtazore, që përbëhet nga gjitarë të mëdhenj si ariu, ujku, dhelpira dhe kunadhja, dhia e egër, baldosa, lepuri i egër, ketri, nuselale, etj. Nga shpendët dallohen thëllëza e malit, gjeli i egër trupvogël, shqiponja, skifteri, disa lloj qukapikësh, pëllumbi i egër, shapka, mëllenja, guhak, grifsha, cërrila e malit dhe lloje të ndryshme zogjsh. Në park ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj e nepërka.

Një nga zonat me faunë të pasur është dhe ajo e Velabishtit. Por gjatë 15 viteve të fundit fauna ka pësuar dëme për shkak të prishjes së habitateve nga gjuetia pa kriter. Në territorin e pyjeve dhe kullotave në këtë komunë gjenden një larmi e kafshëve dhe shpendëve të egër të llojeve të ndryshme, si lepuri, dhelpira, thëllëza dhe qukapiku, laraska, grifsha dhe mëllenja.

Në bashki numërohen 6 monumente të natyrës:

- Lisi i Çezmës së Prokopisë-Paftal
- Rrapi Lybeshës
- Rrapi Veleshnjës
- Ulliri Drobonikut në Palikesh
- Rrapi Burimit-Paftal

Një pasuri tjetër natyrore janë dy grumbujt pyjorë-Pylli i Kulajve, Velçan dhe Gështenjat e Mimiasit. Ndër gjeomonumentet përmendim shpellat e Shahinovës dhe Kapinovës, antiklinalin e Beratit, malin e Tomorit dhe antiklinalin e **Shpiragut, etj.**<sup>11</sup>

Informacioni për zonat e mbrojtura dhe bio/gjeo monumentet është relativisht i varfër dhe nevojitet që këto fenomene e pasuri të bëhen të njohura për banorët. Kjo do të shmangë dëmtime të mundshme. Po ashtu, në kuadër të zhvillimit të turizmit, territori mund të pajiset me shenja orientuese/informuese për të gjitha këto kategori. Numri i punonjësve për menaxhimin e zonave të mbrojtura është tejet i vogël në lidhje me numrin e vizitorëve që i frekuentojnë ato (sidomos parkun e Tomorit), gjë që përbën problem për ruajtjen e zonave të mbrojtura.


Nga pikëpamja peizazhistike, Berati ka një matricë të pasur natyrore dhe me efekte dramatike si rezultat i ndryshueshmërisë së relievit. Megjithatë, ky sistem natyror rrezikohet nga aktiviteti njerëzor-kryesisht fragmentimi si rezultat i sistemit rrugor, dhe veçanërisht shkatërrimi nga guroret dhe pikat e nxjerrjes së materialeve inerte. Në Berat, AKM raporton për prishje peizazhi dhe ndotje nga guroret në Bogdan (NJA Roshnik), Karkanjoz (NJA Roshnik), Sinjë (NJA Sinjë).

*Duke patur parasysh rëndësinë e ruajtjes së fondit pyjor-kullosor dhe të pasurive natyrore në zhvillimin e turizmit dhe sektorëve të tjerë në bashki, si dhe në mbrojtjen e mjedisit, është e rëndësishme që Bashkia të synojë menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe, njëkohësisht, të bashkëpunojë me Pushtetin vendor për zhvillim rural të qëndrueshëm.*

- **Vatrat e nxehta mjedisore (hotspotet)**

Në territorin e Bashkisë Berat, është identifikuar si zonë e nxehtë mjedisore Uzina e Baterive e ndërtuar pranë zonës urbane (Uznovë) dhe përgjatë Osumit, ku si lëndë e parë është përdorur acidi sulfurik, plumbi (Pb), Cadmiumi (Cd), Nikeli (Ni) etj. Uzina ka operuar para viteve '90-të për prodhimin e baterive për automjetet. Pas '90-s, në zonë u krye çmontimi i tyre dhe mbetjet e baterive ndodhen ende në territorin e uzinës. Jo vetëm toka e uji, por edhe ajri është ndotur në zonë, si pasojë e aktivitetit të uzinës. Sot prej saj kanë mbetur vetëm rrënoja, por sipas AKM, niveli i ndotjes nga metalet toksike është në nivele të larta, duke vënë në rrezik jetën e banorëve, që kanë ndërtuar shtëpitë e tyre shumë pranë uzinës, pas viteve '90-të. Tokat përreth kultivohen me grurë, elb, jonxhë, tërfil, ndonëse të ndotura, ka rezultuar shkatërruese si për tokën bujqësore ashtu dhe për pyjet dhe kullotat.

Figura 28. Vatrat e nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë Berat



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Një tjetër zonë e nxehtë mjedisore është fabrika e tekstileve (Berat), e cila ende ruan 126 ton kimikate dhe 80 kg amoniak. Fabrika ka një territor prej disa hektarësh e disa objekte, në një pjesë të cilëve janë vendosur rreth 40 kompani, të cilat janë potencialisht të rrezikuara nga ndikimi pasiv i kimikateve të fabrikës së vjetër. Fabrika ka mbyllur aktivitetin në vitin 1997.

Të dy vatrat e nxehta konsiderohen si parësorë për rehabilitim. Sipas AKM-së, deri më tani, janë kryer studimet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe planet e veprimit për rehabilitimin



afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë si edhe kostot e vlerësuara për rehabilitimin dhe monitorimin e tyre.

Duke pasur parasysh rreziqet që vatrat e nxehta mjedisore paraqesin për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nevojitet që të merren masa për pastrimin dhe rehabilitimin e tyre. Nisur nga sa u tha më lart, shohim që qyteti i Beratit dhe zonat përreth tij, ndoten krvesisht nga shkarkimet e lëndëve djegëse të mjeteve motorike që lëvizin. Në zonat, ku evidentohen norma të larta të ndotësve, duhet patur parasysh parashikimi i zonave tampon me gjelbërim për të ulur sa më shumë ndotjen e shkaktuar. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe vend-depozitimeve të mbetjeve, të cilat shpesh herë janë vatrat zjarri dhe burime të ndotësve toksikë në ajër. Bashkia duhet të përmirësojë kushtet e këtyre vend-depozitimeve, duke mos lejuar vet ndezjen e tyre, deri në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për trajtimin final të tyre.

### • Ndryshimet Klimatike

Ndonëse Shqipëria është një nga vendet që nuk ka një kontribut të konsiderueshëm në emetimin e gazeve të efektit serrë, ajo si shumë vende të tjera të botës vuan efektet e ngrohjes globale. Nga kërkimet e shumta dhe analizimi i treguesve të klimës si temperatura, reshjet, ekstremitetet klimaterike dhe thatësitat, sektorët më të prekur në vendin tonë janë:

- Bujqësia-Parashikimet për klimë nxjerrin në pah rritjen e mëtejshme të temperaturave në vendin tonë dhe uljen e nivelit të reshjeve, të cilat do të bëhen gjithmonë më të paqëndrueshme, duke u shoqëruar me dukuri të përmytjeve masive apo thatësirave. Këto fenomene do të çojnë në uljen e prodhimit të bujqësore, ku si fillim do të dëmtohen ndjeshëm kulturat e ullinjve dhe vreshtave si dhe kultura të tjera bazë të bujqësisë. Kjo prishje e rregullsisë të sistemit të prodhimit të produkteve bujqësore do të ketë një ndikim negativ në jetesën e popullsisë. Për këtë arsye duhet të adaptohen masa për bujqësinë, që ajo të përballojë ndryshimet klimatike.
- Energjia-Vendi jonë ka burime energjetike hidrike (hidrocentralet), të cilat përbëjnë vështirësi në përmbushjen kërkesës me energji elektrike si dhe në sigurimin e burimit të vazhdueshëm (ujor) për të përmbushur në vazhdimësi kërkesat e tregut. Nisur nga fakti se ne mbështetemi tek energjia ujore për furnizimin me energji, fenomenet drastike të ndryshimeve klimatike (thatësitat apo mungesa e reshjeve) do ta vendosnin në krizë sektorin e prodhimit të energjisë elektrike. Për këtë arsye vendi ynë duhet të shikojë alternativa të tjera për të diversifikuar burimet e furnizimit me energji elektrike si, rritjen e tregtimit rajonal të energjisë, si dhe zbatimin e formave alternative të prodhimit të energjisë brenda vendit (energji alternative nga BRE).
- Biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore-Shqipëria, si shumë vende të Ballkanit perëndimor, nën vazhden e ndryshimeve klimatike po pëson dhe do të pësojë ndikimin e: i) rritjes së temperaturave vjetore; ii) rritjes së nivelit të detit deri në 20-24 cm deri në vitin 2050 dhe për pasojë rritjes së erozionit detar dhe rritjen e nivelit të ujërave të lumenjve. Nëse këto dukuri do të ndodhin realisht në 40 vitet e ardhshme, praktikisht tokat që janë zona bregdetare apo afër tyre do të përmyten edhe tokat bujqësore në brendësi të territorit, ku kalojnë lumenjtë do të përmyten. Të gjitha këto dukuri do të shkaktojnë një trysni shumë të madhe në burimet ujore, duke modifikuar zinxhirin e jetës në këto mjedise, çka do të sjellë ndryshimin e habitateve dhe pakësimin e burimeve natyrore. Bashkia Berat nuk është një territor bregdetar, por në të kalojnë ujërat e lumenjve Devoll dhe Osum, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit të tyre do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë tyre apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më

problematike, të cilat janë të prekura edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

#### • Tokat dhe Bujqësia

Sipas klasifikimit të *Censusi* 2011, bashkia e Beratit ka Beratit si qendër me rëndësi kombëtare, Otlakun si njësi suburbane, Velabishtin si njësi bujqësore fushore mikse dhe Sinjë e Roshnik si njësi bujqësore malore.

Tabela 8. Ndarja e bashkive sipas sektorit **ekonomik**

Njësia	Banorë	% Banorë	Tipologjia
Berat	36,496	61	Qendër me <u>rëndësi kombëtare</u> (Qendër qarku me > 35,000 banorë)
Velabisht	8,453	14	Njësi vendore <u>bujqësore mikse fushore</u> (Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
Otlak	9,218	15	Suburbane <u>me status të ulët</u> (Raporti i arsimit të lartë < 35%)
Sinjë	3,351	6	Njësi <u>vendore bujqësore malore</u> (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët > 45%)
Roshnik	2,513	4	Njësi <u>vendore bujqësore malore</u> (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët > 45%)

Burimi: INSTAT, 2012

Sipas tabelës së mësipërme, të paktën 24% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë nëse llogaritet kryhen sipas deklarimeve të punësimit e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë. Aktiviteti bujqësor është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Beratit, por nga pikëpamja mjedisore haset me dy sfida të mëdha: faktin që bujqësia po shndërrohet nga familjare në intensive dhe mungesën e përgatitjes teknologjike dhe të njohurisë mbi tokën për t'u përshtatur me këtë shndërrim. Bujqësia intensive kërkon njohje të thella të mikroelementëve dhe ushqyesve të tokës që të ndihmojë në përdorimin efikas të inputeve bujqësore dhe ruajtjen e mjedisit. Në Shqipëri kjo njohje mungon. Deri më sot, tokat janë klasifikuar në bazë të ngjyrës dhe lartësisë, pavarësisht përpjekjeve për një klasifikim sipas sistemit amerikan (*Taksonomia e tokës - Soil* **CLASSIFICATION**). Deri më tani, kjo mungesë informacioni nuk është ndjerë, sepse është plotësuar me njohuritë e bujqve të trashëguara ndër shekuj. Mirëpo shndërrimi i sistemit nuk mund të bazohet në njohuritë e individëve, aq më tepër sot kur kemi të bëjmë jo më me bujq por me fermerë dhe biznesmenë të interesuar në bujqësi.

Berati bën pjesë në pjesën jug-qendrore të **ëndit** me toka të kafenjta, të kafenjta magneziale, të hinjta kafe dhe toka livadhore të hinjta kafe. E gjithë fusha e Beratit (përfshirë Kuçovën e Skraparin) ka sistem ujitjeje (rreth 23,000 ha), ndërsa rreth 7,000 ha tokë kanë sistem **kullimit**. Beratit e Kuçova së bashku kanë mbi 33 rezervuarë, dy hidrovorë, dy kolektorë funksionalë rreth 15 km që derdhen në Seman e Osum, dhe kanale ujitëse si ai Berat-Ura e Kuçit. Ndërkohë, zona si ajo e Roshnikut janë tërësisht të pambuluara me sistem të kullimit dhe ujitjes.



Një fenomen problematik në Berat është erozioni, i përhapur për shkaqe natyrore dhe njerëzore. Në Berat erozioni ka prekur zona me relief të ndryshëm. Për shembull vihen re vatra në pjesën jugore të Shpiragut, në pjesën e poshtme të Tomorit (brenda kufirit administrativ të Beratit), por edhe në pllajat përgjatë përroit të Molishtit, në lindje të rrjedhës së tij. Sipas AKM 2014, erozioni ka prekur një pjesë të mirë të lumenjve midis të cilëve edhe Osumin. Shkaqet e erozionit lidhen me: 1) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezultojnë në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit; 2) mënyra e kultivimit të tokës, në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës; 3) djegie të mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tokën; 4) tarracim të papërshtatshëm, me zhveshje të tokës; si dhe 5) prerje të pyjeve.

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, një nga fenomenet që po vihet re është ai i degradimit të tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014<sup>39</sup>.

Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, sic përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së<sup>40</sup>

#### • Përfundime

Berati dallohet për një relief të larmishëm me toka pjellore fushore përgjatë luginës së Osumit dhe me terrene kodrinore ku rriten ullishtat e njohura të Beratit dhe lloje të tjera. Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i përrënjevë e lumenjve që përshkojnë territorin e bashkisë dhe më tej i bashkohen Osumit. Në këtë rrjet, Osumi është boshti kryesor i cili përshkon territorin e bashkisë nga pjesa jugore në atë veriore. Ndërsa nga njëra anë Berati ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Osumit të cilët janë të rëndësishëm për zhvillimin e bashkisë, nxori në pah problematikat e këtij lumi, të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Osumit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e lumenjve të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujë e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Osumit, nga burim uji për bujqësinë, ky lum mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lum, si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lum, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Osumi e Semani, për menaxhimin e integruar të këtyre lumenjve.

Në disa ish komuna të Bashkisë së Beratit ka filluar kërkimi dhe shpimi për naftë (përreth malit të Shpiragut). Kjo do të thotë se në të ardhmen, territori do të ketë përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike, sjell edhe ndotjen e tokës, ajrit dhe ujërave nëntokësore. Si rrjedhojë, lipset që bashkia të përcaktojë qartë kufirin e ndarjes ndërmjet tokave bujqësore dhe atyre naftë-nxjerrëse në mënyrë që të shmanget degradimi i tokave dhe rrezikimi i shëndetit të njeriut nëpërmjet konsumit të produkteve të rritura në toka të ndotura nga nafta.

Përveç mbrojtjes së burimeve ujore, bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së degradimit të tokës nga praktikatat bujqësore të paqëndrueshme. Në dhjetëvjeçarën e fundit, bujqësia është shndërruar nga familjare në intensive. Kjo lloj bujqësie e cila praktikohet kryesisht në zonat fushore, ka sjellë përfitime ekonomike për banorët vendas por ka krijuar edhe degradim të tokës bujqësore i cili i shtohet degradimit të tokave nga industria dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Për këtë arsye, lipset që bashkia të krijojë kushte që shmangin problemet që vijnë me bujqësinë intensive dhe me kultivimin e zonave kodrinore-malore duke futur shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore pa cenuar qëndrueshmërinë e saj. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo-bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së .

Duke qenë se në bashki ka disa zona të parashikuara për shfrytëzim naftë, është e rëndësishme që të kryhen studime që përcaktojnë gjendjen e nëntokës për të shmangur rreziqet që mund të kanosen nga shembje të ndryshme të saj sidomos në një kohë kur teknologjia e shfrytëzimit të naftës së përdorur është shumë e përparuar dhe e re, dhe kur ndikimi i të cilës në mjedis ende debatohet.

Në territorin e bashkisë ndodhen edhe disa vatra të nxehta mjedisore. Duke pasur parasysh rreziqet që vatrat e nxehta mjedisore paraqesin për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nevojitet që të merren masa për pastrimin dhe rehabilitimin e tyre sa më të shpejtë.

Ajri i qytetit të Beratit dhe zonave përreth tij, ndotet kryesisht nga shkarkimet e lëndëve djegëse të mjeteve motorike që lëvizin. Në zonat, ku evidentohen norma të larta të ndotësve, duhet patur parasysh parashikimi i zona tampone me gjelbërim për të ulur sa më shumë ndotjen e shkaktuar. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe vend-depozitimeve të mbetjeve, të cilat shpesh herë janë vatrat zjarri dhe burime të ndotësve toksikë në ajër, si CH<sub>4</sub> . Bashkia duhet përmirësojë kushtet e këtyre vend-depozitimeve, duke mos lejuar vet ndezjen e tyre, deri në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për trajtimin final të tyre.

Bashkia Berat nuk është një territor bregdetar, por në të kalojnë ujërat e lumenjve Devoll dhe Osum, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit të tyre do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë tyre apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekura edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

### 1.3 Zhvillimi ekonomik

Analiza e zhvillimit ekonomik shqyrton tendencat kryesore të zhvillimit të Bashkisë Berat nga pikëpamja ekonomike, duke u mbështetur në të dhëna, si PBB, Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), ndërmarrjet ekonomike që operojnë në territorin e bashkisë, punësimi sipas sektorëve, etj.

- **Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)**

**Produkti i Brendshëm Bruto për qarkun e Beratit** në vitin 2012 me çmime korrente ishte 54 192 milion lekë, dhe pesha ndaj totalit të PBB-së në rang vendi ishte 4.1 %. Krahasuar me qarkun e Tiranës që zë peshën më të madhe të PBB-së në rang vendi (38.2 %), dhe qarkun e Kukësit që zë peshën më të ulët të PBB-së në rang vendi me 2.1 %. PBB për frymë në qarkun e Beratit ishte 371 mijë lekë, nën mesataren e vendit (460 mijë lek).

Nga viti 2009 në vitin 2012, PBB për qarkun e Beratit ka shënuar rënie nga 3.1 % në 2.1 %. Nga viti 2010 në vitin 2014 numri i punëkërkesve të papunë në qarkun Berat, të regjistruar në zyrat e punësimit ka rënë me 1 %. Dhe numri i ndërmarrjeve aktive në të njëjtën periudhë kohore ka shënuar rënie prej 64 ndërmarrjesh. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, për periudhën 2012-2014 përbëjnë 9 % të punëkërkesve të papunë të regjistruar gjithsej.

Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor, për qarkun e Beratit nga viti 2013-2014 është rritur me 7%. Numri i të punësuarve në administratën publike për qarkun Berat, nga viti 2010-2014 ka pësuar një rënie prej 2%. Numri i të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor për qarkun Berat, nga viti 2010-2014 është rritur me 2 129 persona (31%). Numri i të punësuarve në sektorin privat bujqësor për qarkun Berat, nga viti 2010-2014 ka pësuar një rënie prej 10 532 persona (25%).

Sipas treguesit të Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) ekonomia në vitin 2012 për qarkun e Beratit vlerësohet në një shifër prej 46 964 milion lek. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët e ekonomisë si bujqësia dhe peshkimi 42.72% , shërbimet e tjera me 15.06%, transporti me 14.18% e në vijim industria e ndërtimi me respektivisht 10.97% dhe 10.46%.

Figura 29. Struktura e VSHB\_Qarku Berat 2012



Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Bashkitë Ura Vajgurore, Kuçova, Poliçani dhe Skrapari i mbështesin ekonominë e tyre në bujqësi. Ku punësimi në këtë sektor për vitin 2011 kap vlerat përkatësisht 67.3%, 54.9%, 60.2%, 60.2% (mesatarja kombëtare 26.1 %). Ndryshe nga treguesit në këto bashki, Bashkia Berat e

mbështet ekonominë në shërbime, punësimi në këtë sektor për të njëjtin vit shënoi vlerën 41.6 % e më pas bujqësia 39.4%.


### Lëvizjet e brendshme të popullsisë

Ekonomia ndikohet nga normat e rritjes apo të zvogëlimit të popullsisë, nga lëvizjet e brendshme të popullsisë, largimi i forcës së punës etj.

Qarku i Beratit ka një normë bruto të migracionit neto shumë të ulët, -9.6 për mijë. Qarku ka një balancë të thellë negative të migracionit të brendshëm dhe përjeton flukse shumë më të larta dalje të popullsisë sesa flukse hyrëse. Raporti midis të ardhurve dhe të larguarve për qarkun Berat, në vitin 2014 ishte 30% të ardhur dhe 70% të larguar.

Bashkia Berat është qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionimit gjeografik dhe aksesit me rrugët kombëtare. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia dhe shërbimet. Qarku Berati pozicionohet në vendin e parë për kultivimin e ullirit në shkallë kombëtare (21 ton/km<sup>2</sup>). Gjatë një periudhe 25 vjeçare, ekonomia e bashkisë ka pasur rritje të sektorit të shërbimeve. Kjo si rrjedhojë e mbylljes së industrive dhe zhvillimit të turizmit. Shpallja qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore, si dhe shtrirja ndërmjet Parkut Kombëtar të Tomorit dhe Malit të Shpiragut kanë nxitur turizmin kulturor, natyror dhe fetar.

Figura 30. Korridoret dhe zonat industriale të territorit të Beratit



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Qendrat urbane janë ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit ndërsa qendrat rurale janë furnizuese me produkte bujqësore dhe me fuqinë punëtore.

Figura 31. Harta e ndërveprimit ekonomik në Bashkinë Berat




Njësia Velabisht është njësia e cila ka sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore 5468 ha (qyteti i Beratit 1508 ha) dhe shënon numrin më të lartë të prodhimit të ullinjve, pemëve frutore dhe vreshtave përkatësisht 2160 ton, 2820 ton dhe 4120 ton në vit. Njësia Sinjë ka sipërfaqen më të madhe të pyjeve dhe kullotave përkatësisht 6330 ha dhe 2864 ha.

Në Otlak funksionojnë dy fabrika të prodhimit të vajit të ullirit, ndërsa në Velabisht ushtrojnë aktivitetin e tyre dy fabrika për prodhimin e pijeve alkoolike, një fabrikë për konservimin e frutave dhe perimeve, katër fabrika të prodhimit të vajit të ullirit, dy fabrika për konservimin e ullirit.

Në njësinë Roshnik funksionojnë dy fabrika të përpunimit dhe prodhimit të nënprodukteve të qumështit, një fabrikë për prodhimin e pijeve alkoolike dhe një fabrikë për prodhimin e vajit të ullirit. Në njësinë Sinjë funksionon një fabrikë e përpunimit dhe prodhimit të nënprodukteve të qumështit dhe tre fabrika të për prodhimin e vajit të ullirit.

Sipërfaqja mesatare e fermave është: Otlak 1.2 ha, Velabisht 1.4 ha, Sinjë 1.9 ha, Roshnik 1.3 ha dhe Berat 0.9 ha.

**Figura 33. Harta e sektorëve të ekonomisë në Bashkinë Berat**



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Problemet kryesore të cilat pengojnë zhvillimin e bujqësisë janë:



- 1- Mosfunksionimi i sistemit kullues dhe ujitës
- 2- Konfliktet me titujt e pronësisë së tokës
- 3- Kostot e larta të punimit të tokës

### **Përfundime**

Në vitin 2012 për qarkun e Beratit, sektori i bujqësisë dhe peshkimit shënoi VSHB më të lartë. Bashkitë Ura Vajgurore, Kuçova, Poliçani dhe Skrapari i mbështesin ekonominë e tyre në bujqësi. Nga viti 2009 në vitin 2012, PBB për qarkun e Beratit ka shënuar rënie nga 3.1% në -2.1%. PBB për frymë në qarkun e Beratit në vitin 2014 ishte 371 mijë lek, nën mesataren e vendit (460 mijë lek).

Bashkia Berat është qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia dhe shërbimet.

Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %. Njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi për vitin 2011 shënon vlerën 90%. Njësitë Velabisht e Otlak janë dy njësitë të cilat kanë numrin më të lartë të bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre. Njësia Roshnik është më pak e zhvilluar. Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitetin ekonomik është i vogël, krahasuar me njësitë jo urbane.

Ndërveprimi ekonomik midis njësive administrative tenton të jetë i qendëruar nga Berati në drejtim të njësive të tjera administrative dhe anasjellas.

Për sa i përket pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore, në Bashkinë Berat ndodhen 2 pika nga të cilat 1 është në njësinë administrative Otlak dhe 1 në njësinë administrative Velabisht.

Njësitë administrative Sinja dhe Roshniku, që shtrihen në perëndim dhe lindje të Bashkisë Berat dhe janë kultivuese të prodhimeve bujqësore, duhet të kenë pika të grumbullimit të këtyre produkteve.

Në qytetin e Beratit operon një treg, investimi në këtë treg është i viteve të fundit, i cili ka përmirësuar cilësinë dhe kushtet e tregimit të produkteve të ndryshme. Vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.

Bujqësia është një sektor me peshë në ekonominë e Bashkisë Berat. Zonat që kanë me shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Osum si pasojë e terreni me fushorë që kanë në raport me njësite të tjera që kanë një potencial më të moderuar për zhvillim bujqësor (terren kodrinor-malor).

Turizmi luan rol të rëndësishëm në ekonominë e Beratit. Por ende nuk është konsoliduar si sektor. Turizmi malor dhe natyror mund të luajnë rol kyç në ekonomi në disa zona të bashkisë.

Për sa i përket klasifikimit të ekonomive të njësive administrative të Bashkisë Berat mund të themi se të gjitha njësitë administrative janë ekonomi agrare duke përjashtuar qytetin e Beratit që është ekonomi aglomeruese.

## 1.4 Mirëqenia social-ekonomike

### 1.4.1 Demografia

Numri i popullsisë banuese sipas të dhënave të gjendjes civile në vitin 2015, Bashkia Berat:

**Tabela 9. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015**

Popullsia bashkia, njësitë administrative	Viti 2015
<b>Bashkia Berat</b>	<b>99 231</b>
Berat	63 036
Roshnik	3 896
Otlak	14 914
Velabisht	11 974
Sinjë	5 411

*Burimi: Bashkia Berat, 2015*

**Tabela 10. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015**

Popullsia, qarku, bashkia, njësitë administrative	Viti 2011	Viti 2015
<b>Bashkia Berat</b>	<b>63 299</b>	<b>60 342</b>
Berat	38 483	36 685
Roshnik	2 650	2 526
Otlak	9 720	9 266
Velabisht	8 913	8 497
Sinjë	3 533	3 368
<b>QARKU BERAT</b>	<b>149 672</b>	<b>142 679</b>

*Burimi: INSTAT, 2015*

Popullsia banuese e Bashkisë Berat shënon shifra të ndryshme për të njëjtin vit, sipas dy burimeve nga të cilat janë gjeneruar të dhënat.

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Berat, banojnë rreth 42 për qind e popullsisë së Qarkut Berat, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndare në bashkitë e tjera, Kuçovë, Ura Vajguore, Skrapar e Poliçan , respektivisht me rreth 22 %, 19 %, 9 % dhe 8 %. Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin e Beratit me rreth 61%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndare në njësitë e saj respektivisht 4%, 15%, 14%, dhe 6%. **Popullsia e Bashkisë Berat, e krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 3000 banorë, ose me 5% më pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përfshijtur këtu qarkun Tiranë dhe Durrësit) pas viteve '90.**

Shkaqet e rënies së popullsisë në Bashkinë Berat, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm.

**Popullsia e bashkisë Berat, nga këndvështrimi i raportit gjinor**, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Në studimin e vitit 2015, treguesi demografik ka një rritje nga Censusi i vitit 2011 duke shënuar një raport gjinor prej 103 meshkuj për 100 femra. Ecuria në rritje e raportit gjinor në nivel bashkie, është edhe rezultat i zmadhimit administrativ të bashkisë dhe përfshirjes në të popullatës së njësive, duke rritur në këtë mënyrë numrin/peshën e popullsisë rurale në tërësinë e popullsisë së bashkisë.

Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së Bashkisë Berat me atë të qarkut Berat, identifikojmë vlera të njëjta të raportit gjinor, kjo dhe për shkak të peshës/rolit të rëndësishëm që ka popullsia e Bashkisë Berat, në përcaktimin e profilit demografik të popullsisë së qarkut.

**Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.** Analiza e strukturës moshore e popullsisë si dhe mosha mesatare e re e saj, (38 vjeç për vitin 2015 ose 1 vit më e madhe se mesatarja në nivel kombëtar) tregojnë se aktualisht popullsia e bashkisë Berat vazhdon të jetë ende një popullsi e re sikundër edhe popullsia shqiptare në tërësi.


**Tabela 11. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave**

Popullsia,	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsëj	0-14	15-64	65+	Gjithsëj	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Berat</b>	<b>63,299</b>	<b>12,081</b>	<b>43,678</b>	<b>7,540</b>	<b>60,342</b>	<b>11,516</b>	<b>41,637</b>	<b>7,188</b>
Berat	38,483	6,899	26,710	4,874	36,685	6,577	25,462	4,646
Roshnik	2,650	564	1,782	304	2,526	538	1,699	289
Otlak	9,720	2,030	6,560	1,130	9,266	1,935	6,253	1,078
Velabisht	8,913	1,816	6,219	878	8,497	1,731	5,929	837
Sinjë	3,533	772	2,407	354	3,368	736	2,295	338
<b>Qarku Berat</b>	<b>149,672</b>	<b>29,304</b>	<b>102,254</b>	<b>18,114</b>	<b>142,679</b>	<b>27,935</b>	<b>97,476</b>	<b>17,268</b>

Burimi: INSTAT; Përgatiti; Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Për vitin 2015 struktura moshore e popullsisë së bashkisë Berat, tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 19% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë së bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive.

**Figura 34. Struktura moshore e Beratit, 2015**



Burimi: INSTAT; Përgatiti Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Analiza e strukturës moshore të popullsisë edhe në nivel njësie që përfshihen brenda bashkisë Berat, tregon se popullsia e kësaj grupmohë është e pranishme me të njëjtat nivele (68-70%).

Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmohave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.

**Treguesit e varësisë** klasifikohen në: treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmohave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$  ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi i varësisë së të rinjve (raporti i grupmohës  $(0-14)/(15-65)$  dhe treguesi i varësisë së të moshuarve [raporti i grupmohës  $(+65)/(15-65)$ ].

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, “mbulohen” ose përballohen nga 100 individë në moshë pune.

Konkretisht, për bashkinë Berat treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim:

**Tabela 12. Koeficientet e varësisë**

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, ish komunat 2011	Koeficientet e varësisë 2011/2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
<b>BASHKIA BERAT</b>	<b>45</b>	<b>28</b>	<b>17</b>
Berat	44	26	18
Roshnik	49	32	17
Otlak	48	31	17
Velabisht	43	29	14
Sinjë	47	32	15
<b>QARKU BERAT</b>	<b>46</b>	<b>29</b>	<b>18</b>

*Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015*

Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varësisë totale për Bashkinë e Beratit shënon vlerën 45 (pra 45 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë (15-64 vjeç), ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij me të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Nëse bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.



Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për ekzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave të reja, (nga 60% në 28%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një faze të re demografike të popullsisë, atë të “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse ndryshimet demografike shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën dy dekada. Projektionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

**Shënim metodik:**

INSTAT-i, i mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në “trendin” që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracion, i ka ndërtuar skenarët e projeksioneve të popullsisë. Sipas këtyre përlllogaritje janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes ulët, (lindje të ulëta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme ( lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu vlen të theksohet së parashikimet e popullsisë për rastin e qarqeve janë llogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5-vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel bashkie ose komunë.

*Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre përkatëse ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur “projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe komunash për periudhën 2016-2031.*

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të llogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme.

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet së popullsia e Bashkisë Berat , sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore për periudhën 2015-2031, llogaritet të jetë rreth -1.4%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 21%.

**Tabela 13. Popullsia e Bashkisë Berat, 2011-2031**

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	2011	2015	2016	2021	2026	2031
<b>Bashkia Berat</b>	<b>63,299</b>	<b>60,342</b>	<b>58,627</b>	<b>54,707</b>	<b>51,181</b>	<b>47,946</b>
Berat	38,483	36,685	35,642	33,259	31,115	29,149
Roshnik	2,650	2,526	2,454	2,290	2,143	2,007
Otllak	9,720	9,266	9,002	8,400	7,859	7,362
Velabisht	8,913	8,497	8,255	7,703	7,207	6,751



Sinjë	3,533	3,368	3,273	3,054	2,857	2,676
<b>QARKU BERAT</b>	<b>149,672</b>	<b>142,679</b>	<b>138,624</b>	<b>129,355</b>	<b>121,017</b>	<b>113,369</b>

Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente për gjate periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësite vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë numrin e popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, i cili për periudhën 2015-2031 argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, si dhe në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve.

### **Përfundime të analizës demografike të popullsisë për Bashkinë Berat:**

Popullsia e Bashkisë Berat në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie prej rreth 60 mijë banorë, nga të cilët 30.5 mijë meshkuj dhe 29.8 mijë femra. Rreth 60% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që diferenca prej 40% si popullsi rurale. Gjithashtu rreth 69% e kësaj popullsie i përket grup-moshës (15-64) vjeç, 19% e grupmoshës (0-14) vjeç, të dhëna këto që tregojnë së bashkia ka potenciale të larta të popullsisë ekonomkisht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj e re, tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re. Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në rënien e numrit gjithsej të popullsisë.

Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e popullsisë rezidente të bashkisë është edhe migrimi i brendshëm i saj, pra lëvizjet e popullsisë nga një qark në tjetrin.

Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/ bashkisë Berat do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1.4 % dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migrimi i brendshëm.

Popullsia rezidente e Bashkisë Berat do të ketë edhe në një periudhe të afërme një tregues të varësisë totale të ulët në vlerat (45-55) duke demonstruar kështu për mundësinë e ruajtjes së të ashtuquajturit “divident demografik” deri në vitin 2021.

Për të përfituar nga ky devident demografik, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor, për të mundësuar arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullsisë, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

## 1.4.2 Analiza social-ekonomike

- **Arsimi**

Tabela 14. Niveli arsimor i përfunduar

Niveli arsimor i përfunduar	Shqipëria	Qarku Berat	Berat	Velabisht	Otlak	Sinjë	Roshnik
Fillor dhe 8 ose 9 vjeçar	52.10%	58.60%	42.02%	74.68%	67.67%	74.11%	69.62%
I mesëm	31.40%	29.85%	41.09%	17.96%	23.50%	16.19%	19.67%
Universitar dhe pasuniversitar	11.80%	6.80%	12.55%	2.75%	3.47%	2.41%	3.79%
Shkalla e analfabetizmit	2.80%	3.21%	2.50%	3.40%	3.50%	4.10%	5.20%

Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Berati** shënon shifrën më të ulët të raportit të numrit të personave që kanë kryer arsimin fillor dhe tetë ose nëntë vjeçar, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart 42.02% (52.10% mesatarja kombëtare). Dhe shifrën më të lartë të këtij raporti për arsimin e mesëm, universitar dhe pasuniversitar 12.55%. Krahasuar me mesataren kombëtare 11.80% , mesataren në nivel qarku 6.80% dhe njësitë përbërëse të bashkisë Berat.

Tabela 15. Vitet mesatare të shkollimit

	Shqipëria	Qarku Berat	Berat	Velabisht	Otlak	Sinjë	Roshnik
Vitet mesatare të shkollimit	10.2	9.6	10.62	8.78	8.97	8.5	8.9

Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Shkalla e analfabetizmit** në nivel qarku 3.21%, është më e lartë se mesatarja kombëtare 2.8 %. Ndryshe nga treguesit në nivel qarku, shkalla e analfabetizmit në qytetin Berat është 2.5%, më e ulët se mesatarja kombëtare. Shkallën më të lartë të analfabetizmit, krahasuar njësia Velabisht, Otlak, Sinjë dhe Roshnik e shënon njësia Roshnik 5.2% (2.8% mesatarja kombëtare).

**Vitet mesatare të shkollimit** më të ulta i shënon njësia Sinjë 8.5 vite (10.2 vite mesatarja kombëtare). Njësia Berat shënon shifrën më të lartë krahasuar me qarkun Berat dhe njësitë e tjera administrative të Bashkisë Berat.

- **Shërbimi arsimor në Bashkinë Berat**

### Arsimi parashkollor

Në të gjithë territorin e Bashkisë Berat ndodhen **46 kopshte**, nga të cilat 26 janë ndërtesa të reja dhe 20 kërkojnë riparime.

Në qytetin e Beratit shërbejnë **14 kopshte**, janë të vendosura në pjesën jug- perëndimore të qytetit. Në pjesën tjetër të qytetit, mungon ky shërbim.

Sinja përbëhet nga 14 fshatra, nga të cilat vetëm 7 ofrojnë shërbimin e kopshteve. Velabisht përbëhet nga 13 fshatra, 11 prej tyre kanë nga një kopsht.

Njësia Otlak e siguron këtë shërbim në 8 fshatra nga 11.

Njësia Roshnik është njësia e cila ka numrin më të vogël të kopshteve që shërbejnë, 3 dhe numrin më të madh të fshatrave që nuk e sigurojnë këtë shërbim.

Nga 46 kopshte vetëm 9 plotësojnë standartet e projektimit 18 m<sup>2</sup>-25 m<sup>2</sup>/fëmijë, nga të cilat 3 ndodhen në Berat, 1 në Sinjë, 2 në Roshnik dhe 3 në Velabisht. Njësia Otlak nuk ka asnjë kopsht që plotëson standartet e projektimit.

#### Arsim 9 vjeçar

Në Bashkinë Berat shërbejnë 43 shkolla 9 vjeçare, 27 prej tyre janë ndërtesa të reja dhe 16 kërkojnë riparime.

Njësia Otlak dhe Velabisht sigurojnë mbulimin e 80 % të territorit me këtë shërbim. Njësia Sinjë lë jashtë rrezes së mbulimit 6 fshatra. Në Roshnik, 4 fshatra nuk sigurojnë shërbimin me shkolla 9 vjeçare.

Nga 43 shkolla që shërbejnë në Bashkinë Berat, vetëm 1 plotëson standartet e projektimit 20m<sup>2</sup>-25m<sup>2</sup>. Kjo shkollë ndodhet në njësinë Velabisht ( 20.9m<sup>2</sup>/fëmijë).

#### Arsim i mesëm

Në Bashkinë e Beratit shërbejnë 11 shkolla të mesme, 7 ndodhen në qytetin e Beratit prej të cilave 3 janë shkolla të mesme profesionale. Njësitë e tjera kanë nga një shkollë të mesme. 9 prej ndërtesave janë të reja dhe 2 janë të amortizuara.

**Berati** mbulon me këtë shërbim rreth 80% të territorit. Njësia Velabisht dhe Sinjë mbulojnë vetëm 40 % të territorit. Otlaku dhe Roshniku mbulojnë me këtë shërbim 50% të territorit.

Tabela 16. Hapësirat arsimore të njësive dhe standartet e projektimit


Niveli i arsimit	Standartet e projektimit	Berat	Velabisht	Otlak	Sinjë	Roshnik
<b>Kopsht</b>	18m <sup>2</sup> /fëmijë	7.3m <sup>2</sup> /fëmijë	12.34m <sup>2</sup> /fëmijë	3.8m <sup>2</sup> /fëmijë	12.3m <sup>2</sup> /fëmijë	13.1m <sup>2</sup> /fëmijë
<b>9 vjeçar</b>	20m <sup>2</sup> -25m <sup>2</sup> /fëmijë	1.5m <sup>2</sup> /fëmijë	4.30m <sup>2</sup> /fëmijë	2.24m <sup>2</sup> /fëmijë	4.36m <sup>2</sup> /fëmijë	3.9m <sup>2</sup> /fëmijë
<b>I mesëm</b>	20m-23m <sup>2</sup> /fëmijë	3.05m <sup>2</sup> /fëmijë	4.32m <sup>2</sup> /fëmijë	3.50m <sup>2</sup> /fëmijë	4.17m <sup>2</sup> /fëmijë	4.81m <sup>2</sup> /fëmijë

Burimi: Ministria e Arsimit; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

- Punësimi

*Punësimi sipas sektorëve*


**Figura 35. Numri i banorëve në moshë pune në Bashkinë Berat**



Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Numri i banorëve në moshë pune, që i përket grupmoshës 15-64 vjeç përbën rreth 69 % të popullsisë së Beratit. Këto të dhëna janë optimiste pasi evidentojnë se Bashkia Berat ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive, por përqendrimi i më shumë se gjysmës së kësaj popullsie vetëm në zonën urbane të bashkisë dëshmon se performanca ekonomike e bashkisë është kushtëzuar mjaftueshëm nga zhvillimet që ndodhin në qytetin e Beratit.

**Figura 36. Punësimi sipas nivelit arsimor**




Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015



Numrin më të lartë të të punësuarve me arsim fillor dhe 8 / 9 vjeçar, ndaj numrit të të punësuarve gjithsej të njësisë e shënon Sinjë 75.28 % (qyteti i Beratit 23.78 % ,mesatarja kombëtare 38.1%).

Krahasuar me mesataren kombëtare, qarkun Berat dhe njësitë e tjera të bashkisë Berat, qyteti i Beratit shënon shifrën më të lartë të të punësuarve sipas arsimit të mesëm, profesional dhe universitar, përkatësisht 48.96 % dhe 26.4%.

**Figura 37. Punësimi sipas degëve të ekonomisë**




Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Numrin më të lartë të të punësuarve në bujqësi ndaj numrit të punësuarve gjithsej e shënon njësi Roshnik me 89.5% (Berati 4.1 %, mesatarja kombëtare 26.1%). Berati shënon numrin më të lartë të të punësuarve në industri dhe shërbime, përkatësisht 29% (mesatarja kombëtare 20.4%) dhe 66.89% (mesatarja kombëtare 53.5%). Njësitë Velabisht, Otlak, Roshnik, Sinjë shënojnë shifra tepër të ulta të të punësuarve në këto sektorë ekonomik.

Njësi Roshnik shënon numrin më të lartë të femrave të punësuar të grupmoshës 15-64 vjeç ndaj numrit gjithsej të femrave të grupmoshës 15-64 vjeç 63.44 % (Berati 31% dhe mesatarja kombëtare 25.5 %). Berati shënon shifrën më të ulët të numrit të meshkujve të punësuar të grupmoshës 15-64 vjeç ndaj numrit gjithsej të meshkujve të grupmoshës 15-64 vjeç, 39.9 % (mesatarja kombëtare 44.8%, Roshniku 74.3%).

**Papunësia**

**Figura 38. Punëkërkuet të papunë të regjistruar(meshkuj dhe femra), 2014**



Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Tabela 17. Punëkërkuess të papunë të regjistruar në Qarkun Berat në vitin 2014**

Qarku	Gjithsej	Femra	Të rinj	Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	Universitar
Shqipëria	141 998	72 467	22 282	76 929	39 299	17 627	8 143
Berat	6 140	3 049	605	3 290	1 433	1 231	186

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015

**Tabela 18. Punëkërkuess të papunë afatgjatë në Qarkun Berat**


Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	89 269	88 768	86 975	87 276	82 133
Berat	4 213	4 369	4 788	4 696	4 174

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015

Nga viti 2010 në vitin 2014 numri i punëkërkuessve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit ka rënë me 1.3 %. Në përgjithësi, për të gjitha qarqet, përqindja që zënë femrat në numrin gjithsej të punëkërkuessve të papunë të regjistruar është 51 %. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, për periudhën 2012-2014 përbëjnë 16 % të punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjithsej.

### Shkalla e papunësisë

**Figura 39. Shkalla e papunësisë**



Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015


Berati shënon shifrën më të lartë të personave të papunë 15 vjeç e lart, ndaj forcave të punës 15 vjeç e lart 32.9% (mesatarja kombëtare 29.3%, qarku Berat 20.7 %, Roshnik 3.2%).

Gjithashtu Berati shënon shifrën më të lartë të numrit të personave të papunë të moshës 15-24 vjeç, ndaj popullsisë ekonomiksht aktive të moshës 15-24 vjeç, 60.2 % (mesatarja kombëtare 52.9 %, qarku Berat 40.6%).

## Statusi i punësimit

Raportin më të lartë të punësuarve me pagë, ndaj të punësuarve gjithsej, e shënon Berati 70.5%. krahasuar me mesataren kombëtare 54.5% dhe mesataren në nivel qarku 34.9%. ndërkohë shifrën më të ulët të punësuarve me pagë e shënon Sinja 8 %, rrjedhimisht shënon dhe shifrën më të lartë të vetë-punësuarve 92 %.

**Figura 40. Statusi i punësimit**



Burimi: INSTAT, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

### 1.4.3 Shëndetësia

#### Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimi spitalor

Tabela 19. Numri i poliklinikave, Qarku Berat

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	46	46	46	46	46
Qarku Berat	3	3	3	3	3

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 20. Numri i qendrave shëndetësore, Qarku Berat

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	624	475	456	421	409
Qarku Berat	37	27	23	23	23

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

#### **Nga viti 2009 në vitin 2013 në qarkun Berat janë mbyllur 14 qendra shëndetësore.**

Tabela 21. Numri i ambulancave, Qarku Berat

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	1812	1927	1970	1946	1998
Qarku Berat	131	144	147	147	147

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 22. Numri i konsultoreve të fëmijëve, Qarku Berat

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	2061	2090	2142	2113	2100
Qarku Berat	135	141	154	154	155

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Tabela 23. Numri i konsultoreve të gruas, Qarku Berat

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	2016	2030	2077	2072	2099
Qarku Berat	139	140	150	150	152

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015



**Tabela 24. Numri i spitaleve, Qarku Berat**

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	44	44	44	44	44
Qarku Berat	4	4	4	4	4

*Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015*

**Tabela 25. Numri i shtretërve, Qarku Berat**

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	8805	8707	8711	8723	8283
Qarku Berat	424	416	378	378	360


*Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015*

Përsa i përket shëndetësisë, në **Bashkinë Berat** shërbejnë një spital rajonal, dy qendra shëndetësore dhe 12 ambulanca.

Njësia Sinjë e ofron këtë shërbim vetëm në 6 fshatra, të cilat janë të vendosura në pjesën veriore të saj. Duke lënë jashtë mbulimit të gjitha fshatrat që shtrihen në pjesën jugore. Njësia Velabisht e ofron këtë shërbim në 4 fshatra duke lënë jashtë mbulimit një numër të konsiderueshëm të popullsisë.

## Mirëqenia ekonomike

Figura 41. Burimi i të ardhurave të Njësive Ekonomike Familjare



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Bazuar tek të dhënat e INSTAT 2011, njësia Berat burimin kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin dhe të gjitha llojet e pensioneve. Përkatësisht 51.35% dhe 41.85%. Njësia Roshnik burimi kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin, e cila shënon shifra 80.83%.

Krahasuar me njësitë e tjera, shifrën më të lartë të parave të siguruara nga remitancat e shënon njësia Otlak me 25.07%.

### Përfundime

- Në bashkinë Berat, niveli arsimor fillor i përfunduar shënon vlerën 53.2 %, arsimi i mesëm 33% dhe arsimi universitar 8.9 %. **Berati** (qytet) shënon shifrën më të ulët të raportit të numrit të personave që kanë kryer arsimin fillor dhe tetë ose nëntë vjeçar, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart 42.02% (52.10% mesatarja kombëtare). Dhe shifrën më të lartë të këtij raporti për arsimin e mesëm, universitar dhe pasuniversitar 12.55%. Krahasuar me mesataren kombëtare 11.80% , mesataren në nivel qarku 6.80% dhe njësitë përbërëse të bashkisë Berat. **Shkalla e analfabetizmit** në nivel qarku 3.21%, është më e lartë se mesatarja kombëtare 2.8 %. Ndryshe nga treguesit në nivel qarku, shkalla e analfabetizmit në qytetin Berat është 2.5%, më e ulët se mesatarja kombëtare. Shkallën më të lartë të analfabetizmit, krahasuar njësia Velabisht, Otlak, Sinjë dhe Roshnik e shënon njësia Roshnik 5.2% (2.8% mesatarja kombëtare).

Për sa i përket institucioneve arsimore, në bashkinë Berat shërbejnë 46 kopshte, 43 shkolla 9 vjeçare dhe 11 shkolla të mesme. Territori i bashkisë Berat mbulohet pjesërisht nga këto institucione. Zonat të cilat ngelen jashtë shërbimit arsimor shtrihen ne njësinë Sinjë dhe Roshnik.

- Bashkia Berat shënon 41.6 % të punësuar në shërbime, 39.4 % në bujqësi dhe 18.9 % në industri. Numrin më të lartë të të punësuarve me arsim fillor dhe 8 / 9 vjeçar, ndaj numrit të të punësuarve gjithsej të njësisë e shënon Sinjë 75.28 % (qyteti i Beratit 23.78 % ,mesatarja kombëtare 38.1%). Berati shënon shifrën më të lartë të të punësuarve sipas arsimit të mesëm, profesional dhe universitar, përkatësisht 48.96 % dhe 26.4%. Krahasuar me mesataren kombëtare, qarkun Berat dhe njësitë e bashkisë Berat. Numrin më të lartë të të punësuarve në bujqësi ndaj numrit të punësuarve gjithsej e shënon njësia Roshnik me 89.5% (Berati 4.1 %, mesatarja kombëtare 26.1%). Gjithashtu Berati shënon numrin më të lartë të të punësuarve në industri dhe shërbime, përkatësisht 29 % (mesatarja kombëtare 20.4%) dhe 66.89% (mesatarja kombëtare 53.5%). Njësitë Velabisht, Otlak, Roshnik, Sinjë shënojnë shifra tepër të ulta të të punësuarve në këto sektorë ekonomik.

Shifra më e lartë të personave të papunë 15 vjeç e lart, ndaj forcave të punës 15 vjeç e lart shënohet në Berat me 32.9% (mesatarja kombëtare 29.3%, qarku Berat 20.7 %, Roshnik 3.2%). Gjithashtu Berati shënon shifrën më të lartë të numrit të personave të papunë të moshës 15-24 vjeç, ndaj popullsisë ekonomikisht aktive të moshës 15-24 vjeç, 60.2 % (mesatarja kombëtare 52.9 %, qarku Berat 40.6%). Raportin më të lartë të punësuarve me pagë, ndaj të punësuarve gjithsej, e shënon Berati 70.5%. krahasuar me mesataren kombëtare 54.5% dhe mesataren në nivel qarku 34.9%. ndërkohë shifrën më të ulët të punësuarve me pagë e shënon Sinja 8 %, gjithashtu shënon dhe shifrën më të lartë të vetëpunësuarve 92 %.

- Përsa i përket shëndetësisë, në Bashkinë Berat ka një spital rajonal, 2 qendra shëndetësore dhe 12 ambulanca. Njësia Sinjë e ofron këtë shërbim vetëm në 6 fshatra, të cilat janë të vendosura në pjesën veriore të saj. Duke lënë jashtë mbulimit të gjitha fshatrat që shtrihen në pjesën jugore. Njësia Velabisht e ofron këtë shërbim në 4 fshatra duke lënë jashtë mbulimit një numër të konsiderueshëm të popullsisë.
- Burimi kryesor i të ardhurave për bashkinë Berat është puna e paguar me 58.8 % dhe më pas renditen të ardhurat nga pensionet, të ardhurat nga remitancat dhe nga ndihma sociale me përkatësisht 36.8 %, 10.5 % dhe 8.5 %. Berati burimin kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin dhe të gjitha llojet e pensioneve, përkatësisht 51.35% dhe 41.85%. Njësia Roshnik burimi kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin, e cila shënon shifra 80.83%. Krahasuar me njësitë e tjera, shifrën më të lartë të parave të siguruar nga remitancat e shënon njësia Otlak me 25.07%.

## 1.5 Përdorimi i tokës dhe infrastrukturat


### 1.5.1 Përdorimi i tokës

Sipërfaqja totale e Bashkisë Berat është 380 km<sup>2</sup>, nga e cila 170 km<sup>2</sup> është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 180 km<sup>2</sup> është tokë natyrore (pyje, kullota). Njësitë Otlak e Velabisht kanë përqendrimin më të lartë të tokës bujqësore. E cila kryesisht kultivohet me dru frutorë e ullinj e fidanishte. Njësia Sinjë e Roshnik karakterizohen nga tokë bujqësore e fragmentizuar e sipërfaqen më të madhe të tokës natyrore (reliev kodrinor e malor). Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osunit dhe është tepër i pasur me ujëra nëntokësor e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore është 9 km<sup>2</sup>.

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km<sup>2</sup>. Sipërfaqja që zënë shërbimet është 0.07 km<sup>2</sup>. Institucionet, shëndetësia dhe arsimi zënë një sipërfaqe prej 0.21 km<sup>2</sup>. Dhe janë të përqendruara në qytetin e Beratit dhe fshatrat kryesorë të katër njësive.

Banimi shtrihet në një sipërfaqe të vogël, krahasuar me tokën bujqësore dhe natyrore, 4.63 km<sup>2</sup>. Qyteti i Beratit karakterizohet nga zona urbane të konsoliduara. Në njësitë e tjera zonat e banuara janë të vendosura përgjatë akseve rrugore. Në total bashkia Berat ka 812 km rrugë lineare.

Figure 42. Përdorimi i tokës, Bashkia Berat



Infrastruktura	Ujor	Natyror	Bujqësor	Urban
1 %	2 %	48 %	45 %	4 %

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015



### 1.5.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza

Me ndarjen e re administrative, bashkia Berat, përfshin brenda juridiksionit të vetë administrativ, qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.

Tabela 27. Shërbimi i furnizimit me ujë

Njësiti	Popullsia 2015	Ujësjetllës-kanalizime
Berat	36 685	Sh.a Berat-Kuçovë
Otlak	9 266	
Roshnik	2 526	Nuk ofrohet shërbim
Velabisht	8 497	
Sinjë	3 368	
Bashkia Berat	60 342	


Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve operon nëpërmjet shoqërisë aksionere rajonale Berat-Kuçovë ( e vetmja sh.a. rajonale në Shqipëri) e cila ofron shërbimin në bashkinë e Beratit dhe Kuçovës.

Berati furnizohet me ujë të pijshëm nga burimi i Bogovës i cili ndodhet në juglindje të qytetit, në një lartësi prej 343 m mbi nivelin e detit. Problematike paraqitet situata gjatë muajve të verës ku shënohen prurjet minimale të burimit.

Furnizimi me ujë në këtë periudhë kryhet me pompa nga pusët në zonën e Uznovës.

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Figura 43. Shërbimi i ujësjetllës-kanalizimeve në Bashkinë Berat



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Tabela 28. Kapacitetet e burimeve ujore**

Burimi/Pus	Kapaciteti Mesatar		Kapaciteti Minimal	
	litër/sek	m <sup>3</sup> /ditë	litër/sek	m <sup>3</sup> /ditë
Burimet e Bogovës	600	51 840	350	30 240
Puset e Uznovës	100	8 640	100	8 640
<b>Totali</b>	<b>700</b>	<b>60 480</b>	<b>450</b>	<b>38 880</b>

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

### Kërkesa aktuale për ujë në qytetin e Beratit

VKM Nr. 102, datë 16.3.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat" përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 150 litra ujë në ditë për frymë. Është kryer llogaritja e kërkesës për ujë në qytetin e Beratit. Gjatë kësaj llogaritje duhen marrë parasysh humbjet në rrjet. Të cilat synohet të reduktohen deri në 25%. Norma e konsumit për banor ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive:

**Tabela 29. Kërkesa totale për ujë në vitin 2015 për tre kategoritë e konsumatorëve**

Kategoria e Konsumatorëve	Popullsia në Vitin 2015 (Banorë)	Norma familjare e konsumit (l/f/d)	Kërkesa për ujë (m <sup>3</sup> /dite)	Kërkesa për ujë (l/s)
Familjare	36,496	100	3 649	42
Private		5	182	2
Buxhetore		15	547	6
<b>Totali</b>			<b>4 378</b>	<b>50</b>
<b>Totali me Koefic. Ditor të Jouniformitetit (1.3)</b>			<b>5 691</b>	<b>66</b>
<b>Totali me 25% Humbje</b>			<b>5 473</b>	<b>63</b>
<b>Totali me 35% Humbje</b>			<b>5 910</b>	<b>68</b>

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Figura 44. Rrjeti i tubacioneve dhe kanaleve në qytetin e Beratit**



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

### Sistemi i furnizimit me ujë në njësitë Otlak, Velabisht, Roshnik e Sinjë.

Njësitë Sinjë, Velabisht dhe Roshnik nuk mbulohen nga shërbimi i furnizimit me ujë që ofron sh.a Berat-Kuçovë. Në këto zona uji sigurohet nga banorët e njësive nëpërmjet puseve dhe burimeve ujore natyrore. Ndryshe paraqitet situata në njësinë Otlak, ku furnizimi me ujë dhe kanalizime në një pjesë të njësisë ofrohet nga sh.a Berat-Kuçovë, dhe pjesërisht nga UK Ura Vajgurore.

### Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza

Kanalizimi i ujërave të zeza ofrohet në qytetin e Beratit dhe pjesërisht në njësinë Otlak. Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar dhe derdhen në Lumin e Osumit.

Situata paraqitet edhe më e vështirë në njësitë jo urbane të cilat nuk ofrohet shërbimi i kanalizimeve të ujërave të zeza. Në këto njësi largimi i ujrave bëhet nëpërmjet gropave septike, duhet theksuar jashtë standarteve higjieno-sanitare, ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara.

### 1.5.3 Infrastruktura rrugore dhe transporti për Bashkinë Berat

Në aspektin e infrastrukturës rrugore Bashkia e Beratit ka qenë e izoluar nga korridoret kryesore të transportit të vendit, ndonëse kjo bashki është nga më të rëndësishmet e vendit për shumë sektorë. Qyteti i Beratit është i arritshëm nga rrjeti rrugor kombëtar nëpërmjet një rruge të vetme rajonale që përshkon Luginën e Osumit, *Rruga Shtetërore 72 (SH72)*, e cila efektivisht funksionon si një korridor i transportit kryesor lidhës i vendbanimeve të rajonit. Rruga shtrihet nga vendbanimet rurale në lindje dhe në jug të Beratit, për në ato të Lushnjës. Gjithashtu lidhet me zonat bregdetare të Shqipërisë, duke përfshirë edhe zonën metropolitane Durrës-Tiranë. Rruga kryesore rajonale që lidh Beratin me zonën metropolitane Tiranë-Durrës, ndjek shtratin lumor dhe është një linjë jetësore e komunikimit për fshatrat që shtrihen në jug të qytetit si dhe për zonën e Skraparit. Një rrugë kodrinore shkon në jug nga Berati në Tepelenë, por gjendja e rënduar e kësaj rrugë nuk lehtëson lëvizjen. Ky korridor është planifikuar për investime dhe për kthimin e tij në një rrugë kombëtare nga Tirana në Gjirokastër.

#### Infrastruktura rrugore

Tabela 30. Ndarja e infrastrukturës së Bashkisë Berat sipas kodit rrugor dhe sipas funksionit

Kategoria e rrugës	Gjatësia (Km)	Funksioni i rrugës	Gjatësia (Km)
Rrugë ndërqytetëse kryesore	23	Arterie	23
Rrugë ndërqytetëse dytësore	37	Bujqësore	220
Rrugë urbane kryesore	9	E brendshme kryesore	40
Rrugë urbane dytësore	114	E brendshme dytësore	4
Rrugë lokale	629	Kolektor	56
<b>Total</b>	<b>812</b>	Peizazh	449
		Çlodhëse	11
		Shërbimi	5

Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues të bashkisë Berat në 2013, rezultojnë që në qytetin e Beratit, me ndarjen e vjetër administrative, ka pasur **128 km rrugë lineare**. Analiza e infrastrukturës rrugore e kryer me sistemet e informacionit gjeohapësinor rezulton që në Bashkinë Berat tashmë ka **812 km linear rrugë**, ose gjashtë herë më shumë sesa para reformës territoriale të 2014-tës. Nga këto **188 km rrugë** janë të shtuara dhe **624 km** janë të pashtuara. Kjo tregon rëndësisë që duhet t'i jepet rrugëve rurale në hartimin e planit të përgjithshëm vendor.

Sipas Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), në periudhën 2005-2013, në Bashkinë e Beratit janë shtruar dhe rikonstruktuar **26.68 km rrugë**, respektivisht: Otlak-3.4 km; Roshnik-5.48 km; Velabisht- 7.7 km; Sinjë-**10.1 km.**

Analiza e infrastrukturës rrugore sipas funksioneve tregon që në territor mbizotërojnë rrugët me peizazhe, të cilat ndodhen kryesisht në terren kodrinor dhe malor. Kjo infrastrukturë është një potencial turistik për këtë Bashki që përforcon sektorin e rëndësishëm turistik të Beratit.

Pikat e ndërprerjes së rrugëve lokale me rrugët ndërqytetëse kryesore.

Një nga problemet e sistemit rrugor të Bashkisë së Beratit janë hyrje-daljet (*intersect*) e rrugëve lokale me rrugët ndërqytetëse kryesore. Në hartën më poshtë janë paraqitur pikat problematike të rrugëve lokale që hyjnë në rrugët ndërqytetëse kryesore, ku u evidentuan 66 pika konfliktuale. Konkretisht gjatë periudhës 2008-2015 pikat me problematike në këtë bashki janë:

- Në rrugën Berat Ura Vajgurore (Kombinat)
- Në rrugën Kombinat-sheshi "Agjencia" (lagjja Çlirim)
- Tek Ura e Goricës
- Në rrugën Uznovë-Berat (kthesa spital)

Këto pika duhet të studiohen me kujdes si vende me probabilitet të lartë aksidentesh rrugore.

Lëvizja e banorëve drejt vendit të punës dhe transporti ndërqytetës.

Sipas statistikave të marra nga INSTAT, Censusi i vitit 2011, 62 % e banorëve të bashkisë së Beratit shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 20.6 % shkojnë në punë me autobus, minibus, tren ose taksi kurse 13.9 % shkojnë në punë me automjete personale (makina ose motoçikleta). Nga analiza e transportit ndërqytetës, sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë bashkia e Beratit e ka me Tiranën (15 orare në ditë), Kuçovën (10 orare në ditë), Vlorën (6 orare në ditë) dhe Fierin (5 orare në ditë). Intensifikimi i lëvizjeve tregon marrëdhëniet që kanë këto Bashki me njëra tjetrën për sa i përket punësimit dhe jo vetëm. Aktualisht terminali i qytetit të Beratit ka një kapacitet prej 50 autobusësh dhe është në pronësi private.

## Përfundime

Ndonëse aktualisht territori lidhet vetëm me një rrugë kryesore, parashikohet një korridor i ri lidhës me Bashkinë Memaliaj që e vendos Beratin në boshtin jugor qendror kombëtar. Si pasojë e reformës territoriale, bashkia e Beratit ka tashmë një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore ku mbizotërojnë rrugët rurale me përdorim peizazhi. Problemi kryesor i rrjetit rrugor është numri i



lartë (66 pika) i kryqëzimeve të rrugëve lokale me ato ndërqytetëse kryesore që përbëjnë burim aksidenti.

#### **1.5.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta**

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në ish Bashkia Berat kryhet me anë të një kompanie private “Infinity Construction” sh.p.k, e cila kryen grumbullimin, transportin dhe depozitimin final të mbetjeve si dhe pastrimin e rrugëve të qytetit. Bashkia Berat ka vendosur një marrëdhënie me firmën private, të cilën ajo e paguan çdo muaj në varësi të një monitorimi të rregullt që kryen ndaj mënyrës së ofrimit të shërbimit nga kompania. Kompania ka në pronësi disa makina për largimin e mbetjeve (6-7 ton), ndërsa bashkia ka në pronësi kontenierët (rreth 270 kontenierë 1.1 m<sup>3</sup>).

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ofrohet për 100% të popullsisë të ish bashkisë Berat, ku në rrugicat e ngushta ku mjete teknologjik nuk arrij dot të hyjë, ato mblidhen me mjete të thjeshta (tezga) me krahë nga punonjësit e pastrimit. Në qytet ka rreth 80 pika të tilla, ku mbetjet mblidhen me krahë, duke zënë 6% në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve për ofrimin e shërbimit të pastrimit.

**Mbetjet e ngurta urbane:** Gjatë vitit të kaluar (2014), ish Bashkia Berat, ka gjeneruar rreth 13 883 ton mbetje/vit, me një normë gjenerimi 0.6 kg/banor/ditë. Mbetjet urbane pasi grumbullohen, depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve në Orizaj, i cili ndodhet 1 km larg nga rruga nacionale dhe 5 km larg nga qendra e qytetit. Ky vend-depozitim është në funksion që nga viti 1980, dhe pasi mbetjet depozitohen ato mbulohen me dhe' dhe ngjeshen. Lëndët toksike që çlirohen gjatë procesit të kompostimit, duke qenë se toka në këtë zonë ka shumë shtresa aluvione infiltron në ujërat nëntokësore e sipërfaqësore duke ndotur tokën, ujërat, lumin. Në këtë vend-depozitim kryhet djegia e mbetjeve plastike, duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit. Shpesh herë është diskutuar për zhvendosjen e vend-depozitimit aktual në një zonë tjetër, por gjithmonë është hasur në problem me vendin e duhur, pasi të gjitha tokat në pronësi shtetërore janë buzë shtratit të lumit Osum. Ndërkohë në bazë të një VKM nr. 452, datë 11.07.2012 të gjithë operatorët e vend-depozitimeve (të pajisur apo jo me leje) duhet që të mbyllin këto vend-depozitime brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi janë jashtë kushteve higjeno-sanitare.

Ish Bashkia Berat raporton që komuniteti Rom është ndër operatorët kryesorë jo formal për grumbullimin e mbetjeve të plastikës.

**Mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi (mbetjet inerte):** Gjatë vitit 2014, ish bashkia Berat ka gjeneruar një sasi prej 17 588 m<sup>3</sup>/ vit mbetje, të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet si dhe prishjet e objekteve pa leje. Për largimin e këtyre mbetjeve janë angazhuar përveç brigadave të pastrimit edhe bizneset, forcat e ushtrisë dhe komuniteti. Pjesa më e madhe e tyre janë përdorur për të mbushur gropat e moçaleve të krijuara nga marrja e inerteve. Ndërkohë, për këtë rrymë të caktuar mbetjesh nuk ka një vend të dedikuar për depozitimin e tyre, dhe në të shumtën e rasteve ato depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve urbane.

Zonë problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në qytetin e Beratit është zona pranë Qendrës Lira, e cila është përfshirë në Planë Veprimet e hartuara në 2014-të, ku janë realizuar fushata pastrimi dhe ndërgjegjësimi dhe është një zonë në vëzhgim të vazhdueshëm.

**Mbetjet Spitalore:** Nga kontrolli që është kryer në Spitalin Rajonal të Beratit, rezulton se mbetjet e rrezikshme spitalore ndahen sipas kategorive: mbetje anatomike, infektuese etj., dhe me anë të një kontrate të lidhur me operator ekonomik Euroteam, i cili ofron shërbimin e sterilizimit dhe grirjes të mbetjeve spitalore 2 herë në javë. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Në të gjithë territorin e Bashkisë së re Berat, nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe nuk ka një vend depozitim mbetjesh sipas standardeve evropiane. Në të gjithë territorin e bashkisë së re mund të numërohen një sërë vend depozitimesh ilegale në vende të papërshtatshme.

Ndërkohë në territorin e ish bashkisë Berat, janë ndërmarrë disa iniciativa në lidhje me investime të mundshme që kanë të bëjnë me para trajtimin dhe trajtimin final të mbetjeve:

1. Gjatë vitit 2014 së bashku me shoqërinë civile, bashkia Berat ka kryer një studim fizibiliteti "Partneriteti Publik Privat", ku është bërë e mundur edhe zëvendësimi i 85 kontenierëve;
2. Ndërkohë, ish Bashkia Berat, ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Doganës për mirë menaxhimin e mjedisit në vitin 2014. Në sajë të kësaj marrëveshje, ish Bashkia Berat ka kërkuar që të gjitha subjektet private që janë objekt i veprimtarisë pranë doganës, të drejtohen pranë Bashkisë për t'u pajisur me autorizimin për mbetjet e ngurta që krijojnë nga zhvillimi i aktiviteteve të tyre;
3. Me Ministrinë e Zhvillimit Urban, ish Bashkia Berat, në vitin 2014 aplikoi në platformën e projektit MED-3R, e cila ka të bëjë me përfshirjen në platformën strategjike të mbetjeve për Mesdheun, ku një pjesë e këtyre qyteteve mund të gjejnë hapësira bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperiencash në fushën e mbetjeve.

## **1.6 Rëndësia kombëtare në territor**

Bashkia e Beratit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo ndodhet në afërsi me zonat ekonomike të Vlorës, Lushnjës dhe Fierit dhe gjendet në akset kryesore lidhëse kombëtare. Berati përshkohet nga Lumi Osun që së bashku me parkun kombëtar të Tomorit dhe pasuritë kulturore me njohje ndërkombëtare, ofrojnë një potencial turistik për zhvillim të mëtejshëm.

### **1.6.1 Monumente kulture**

Kalaja e Beratit është shpallur monument kulture që në vitin 1948 (Ligji nr. 609 datë. 24/05/1948). Më pas kjo hapësirë është zgjeruar në qendrën historike të sotshme të Beratit e përbërë nga tre lagjet, e Goricës, Mangalemit dhe Kalasë, të shpallura zonë e trashëgimisë kulturore botërore me **datë 31.03.2009**. Vendimi i UNESCO-s cakton sipërfaqet e tyre si dhe një zonë mbrojtëse të shtrirë përreth tyre. Pjesa veri-perëndimore dhe jugore nuk lejojnë asnjë ndërtim, ndërsa pjesa lindore fushore dhe kodrinore kanë kufizime në densitet, lartësi, dhe stil arkitektonik.

Figura 45. Zona e mbrojtur e kishës së Shën Mërisë



LEGJENDA : — Perimetri i rrethimit të kishës — Perimetri i zonës së mbrojtur

Burimi: Ministria e Kulturës, 2015

Gjithashtu, në Bashkinë e Beratit ndodhen edhe 86 monumente kulture të kategorisë së parë dhe 363 monumente kulture të kategorisë së dytë të cilat administrohen sipas Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Neni 32 i ligjit të mësipërm specifikon që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me Vendim të KKT nr. 1, datë 09.09.2015 Kisha e Shën Mërisë në Sinjë është shpallur zonë e rëndësisë kombëtare në planifikim.

### 1.6.3 Zona të mbrojtura natyrore

Territori i bashkisë së Beratit prek parkun kombëtar të Tomorit në kufirin lindor të tij. Tomori është një *park kombëtar* (Zonë e mbrojtur, kategoria IV) i shpallur me sipërfaqe të zgjeruar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 18.7.2012, që gjithashtu bën pjesë në rrethin emerald. Ky park ka një zonë buferike prej 50 m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676 datë 20.12.2002 përcakton 6 monumente natyrore (Zonë e mbrojtur, kategoria III): Lisi i Çezmës së Prokopisë; Gështenjat e Mimasit ; Rrapi i Veleshnjës; Rrapi i Burimit në Paftal; Pylli i Kulajve në Velçan; dhe Ulliri i Drobonikut në Palikesh.

Me vendim të KKT nr. 1 më datë 08.10.2013 janë miratuar zona të rëndësisë kombëtare ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen e territorit dhe rehabilitimin mjedisor. Harta shogëruese<sup>69</sup> specifikon një fashë territori përgjatë bregut detar si dhe bashkitë e Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës. Vendimi i KKT-së pezullon dhënien e lejeve të zhvillimit nga të gjitha autoritetet e planifikimit deri në miratimin e planit të integruar ndërsektorial të bregdetit.

### 1.6.4 Menaxhim i integruar i burimeve ujore

Lumi i Osumit shtrihet me një gjatësi 26.6 km përgjatë territorit të bashkisë së Beratit. Të gjitha burimet ujore së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas



specifikimit të Ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Përgjatë trupave ujore, ky ligj specifikon distanca sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100 m deri në 200 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe kullimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësore rregullohen nëpërmjet Ligjit nr. 8518 i datës 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin” i ndryshuar. Sistemet të kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë në përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (Neni 9). Sipas strategjisë të **decentralizimit** dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor (draft), sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë në administrim bashkive si funksion i vetë.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200 m për kapacitet më pak se 5 000 banorë dhe 1 000 m për kapacitet 1,000-50,000 banorë.

### 1.6.5 Tokat bujqësore

Territori i bashkisë së Beratit ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej rreth 170.8 km<sup>2</sup> (45%) tokë **bujqësore**. Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, përcaktojnë mbrojtjen nga ndërtimet, mbrojtjen e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimin e një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuar në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”. Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, ligji nr. 8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, ajrore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i



administrojnë këto resurse për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

#### **1.6.6 Pyjet, drufrutorët dhe kullotat**

Përcaktuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, “Toka pyjore” janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jo-pyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, së bashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Bashkia e Beratit ka 174 km<sup>2</sup> toka pyjore me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë e këtij fondi pyjor kombëtar, mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha. Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar, pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata. Ndërsa për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor, kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.

Në bazë të Ligjit 7929 datë 11.05.1995 “Për mbrojtjen e drufrutoreve”, pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtat, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i është dhënë në administrim organeve të pushtetit vendor me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473 datë 14.10.1999.

Fondi kullor i përbërë nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote, apo livadhi nga fondi kullor, ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha.

#### **1.6.7 Zonat industriale**

Në zonat e Shpiragut dhe Molishtit, në njësitë Sinjë dhe Velabisht, është dhënë leje zhvillimore komplekse për puse kërkimi të naftës në baze të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 03.05.2013. Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, janë pronë ekskluzive të shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga ministria përkatëse. Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me Ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” i ndryshuar, një kontraktori mund t'i jepet e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike, ose private për të kryer operacione hidrokarburesh nën marrëveshjen e hidrokarbureve, ku kontraktori është palë.

Zona e kombinatit të tekstileve është në proces likuidimi dhe privatizimi. Hapësirat e tij prej 47.5 ha janë ndarë me legjislacion në parcela më të vogla për lehtësi në privatizim, dhe përfshijnë

industri ushqimore e cila është në përdorim nga subjekte private. Gjithashtu, në zonën e Uznovës gjendet ish fabrika e baterive edhe ajo gjithashtu jofunksionale. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

Me vendim të KKT nr 1, datë 04.07.2013 është miratuar plani kombëtar sektorial për gazsjellësin trans Adriatik (Projekti TAP) i cili kushtëzon të gjitha autoritet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Shoqëria Trans Adriatik Pipeline (TAP) AG do të ndërtojë një segment tubacioni rreth 16 km në të cilin ushtrohen tre zona sigurie. Në zonën e parë A prej 8 m (4 m në çdo anë) nuk do lejohet asnjë ndërtesë, as plugim i thellë dhe as pemë. Në zonën e dytë B prej 40 m (20 m në çdo anë) nuk do lejohen ndërtesa banimi. Në zonën e tretë C prej 400 m (200 m në çdo anë) do të jenë në konsideratë të veçantë të autoriteteve të planifikimit ku në bazë të standardeve të sigurisë për sistemet e gazit natyror me trysni të lartë mund të kufizojnë numrin e ndërtesave në zonën [sigurisë].

Krahas vënies në përdorim të një sasive të pronave shtetërore, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 802, datë 30.9.2015, në territorin administrativ të Bashkisë Berat, do të vendosen në dispozicion të përhershëm të Shoqërisë TAP AG: 20 073 m<sup>2</sup> tokë bujqësore dhe fond kullosor, 35 467 m<sup>2</sup> tokë fond pyjor, 3 309 m<sup>2</sup> sipërfaqe ujore, dhe 5 359 m<sup>2</sup> rrugë automobilistike, sipas hartës të shtrirjes së zonës A të projektit.

### 1.6.7 Të tjera

Kullat e telekomunikacionit që janë të larta mbi 25 metra nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të përcaktuara si zona banimi. Distanca e tyre minimale nga kufiri i pronës më të afërt të ndërtuar është 30 metra.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 29.10.2014 për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Në të mund të parashikohet vetëm mbjella e drurëve dhe gjelbërimit, ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Për qendrat e banuara, me popullsi > 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 m linear, për qendrat e banuara me popullsi < 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 m linear.


### 1.7 Financat vendore

Për realizimin e kësaj analize u përdorën të dhëna nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave për periudhën 2010-2014 dhe bashkia Berat. Me ndarjen e re administrative bashkia Berat përbëhet 5 njësi administrative. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie (ish komuna) në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

Performanca e të ardhurave totale të Bashkisë Berat (pas reformës territoriale) rezulton të ketë ndjekur një prirje përmirësuese duke filluar që prej vitit 2011. Burimet financiare totale (transferta ndërkombëtare dhe nga burimet e veta vendore) në dispozicion të Bashkisë së re të Beratit janë luhatur në nivelin 0.9-1 miliard lekë në vit gjatë periudhës 2010-2013. Në vitin 2014

të ardhurat totale shënuan nivelin e 1.1 miliard lekëve, në rritje me rreth 14.5% krahasuar me një vit më parë. Në linja të përgjithshme, përcaktues në performancën financiare të Bashkisë Berat rezultojnë të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare. Ato përfaqësuan mesatarisht në pesë vitet në analizë rreth 78.6% të të ardhurave totale. Ndërkohë, të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë ruajtur pothuajse një peshë të pandryshuar në totalin e të ardhurave të Bashkisë së re Berat gjatë periudhës së konsideruar (mesatarisht 21.4%). Në terma kontributesh, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ato nga burimet e veta vendore kontribuan përkatësisht me rreth 10.7 dhe 3.8 pikë përqindjeje në normën e rritjes së të ardhurave totale për vitin 2014. Në ndarjen sipas njësive administrative përbërëse, kontribuesi kryesor në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave është Berati, i cili përfaqësoi mesatarisht 70.6% ndaj totalit të të ardhurave në pesë vitet në analizë. Në nivel njësie jo urbane (ish komuna), veçanërisht në vitet 2013 dhe 2014, vihet re një rritje e kontributit të të gjitha njësive përbërëse në ecurinë e të ardhurave totale. Kështu, në vitin 2013 rritja vjetore e të ardhurave totale u mbështet nga ecuria pozitive e të ardhurave të gjeneruara nga njësitë Otlak, Velabisht, Roshnik e Sinjë ndërkohë që në Berat u shënuar tkurrje e tyre.

Figura 46. Kontributi i njësive në ecurinë e të ardhurave totale të Bashkisë Berat (grafiku majtas, në pikë përqindjeje); Kontributi sipas burimit në të ardhurat totale (grafiku djathtas, në pikë përqindjeje).



Burimi: Ministria e Financave, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Pamjet grafike tregojnë për një varësi të lartë financiare të njësisë së qeverisjes vendore nga burimet ndërqeveritare dhe në veçanti transfertat e kushtëzuar. Varësia financiare bën që projektet për investime kapitale të jenë subjekt pothuajse tërësisht i vendimeve të qeverisë qendrore. Përdorimi i instrumentit të huas bankare mund të jetë një mënyrë për të rritur autonominë financiare dhe për të realizuar investime kapitale por, kosto në terma interesash dhe mundësia e ri-pagimit të kryegjësë nuk duhet të rëndojnë planet e ardhshme për investime kapitale të njësisë së qeverisjes vendore.

Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të Bashkisë Berat (pas reformës) rezultojnë të jenë element dominues dhe në rritje në strukturën e të ardhurave totale. Pësia e tyre ndaj totalit të të ardhurave ka ruajtur pothuajse të njëjtin nivel në pesë vitet në analizë. Mesatarisht, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfaqësuan rreth 78.6% të totalit të të ardhurave dhe janë përcaktues i kahut të zhvillimeve në të ardhurat totale. Pas rënies vjetore të shënuar në vitin 2011, të ardhurat ndërqeveritare ndoqën një trajektore rritëse në tre vitet në vijim. Kështu, ato u zgjeruan me rreth 2.6% dhe 6.8% përkatësisht në vitet 2012 dhe 2013. Niveli i të ardhurave ndërqeveritare rezultoi të jetë rreth 892 milionë lekë në vitin 2014, në rritje me rreth 13.5% krahasuar me një vit më parë. Sipas elementëve përbërës së të ardhurave nga transfertat




ndërqeveritare, peshën kryesore e zënë të ardhurat nga transfertat e **kushtëzuar** (mesatarja e 5 viteve është 63.9%), pesha e së cilës ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare rezulton të ketë pësuar rritje të lehtë përgjatë 5 viteve në analizë. Mesatarisht në pesë vitet e fundit, 81.1% e transfertës së kushtëzuar vjen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë. Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar përfaqësojnë mesatarisht rreth 33.3% të të ardhurave ndërqeveritare gjatë pesë viteve në analizë. Në periudhën 2010-2013 niveli i transfertës së pakushtëzuar ka qenë pothuajse i pandryshuar ndërkohë që në vitin 2014 shënohet një rritje e saj me rreth 17.6% në terma vjetorë. Të ardhurat nga taksat e ndara rezultojnë në një nivel të ulët ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare dhe në rënie progresive përgjatë viteve 2010-2014 (mesatarisht përfaqësojnë rreth 2.8% të të ardhurave ndërqeveritare).

Pavarësia financiare e Bashkisë Berat, matur si raport i të ardhurave vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton të ketë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel përgjatë pesë viteve të marra në konsideratë. Raporti i të ardhurave vendore ndaj të ardhurave totale përgjatë kësaj periudhe qëndron pranë nivelit mesatar prej 21.4%. Në terma të përgjithshëm, niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tatimeve vendore. Kontribut më të vogël në të ardhurat vendore në tarifatat dhe të ardhurat nga asetet shtetërore. Pas një zgjerimi me rreth 3.2% në vitin 2011, të ardhurat vendore shënuan rënie me rreth 4.0% në vitin 2012 si pasojë e një performante të dobët kryesisht në mbledhjen e taksave dhe tatimeve (përcaktuar ndjeshëm nga turrja e të ardhurave nga taksa vendore e *ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimet*). Nën kontributin pozitiv të ecurisë së taksave dhe tatimeve vendore, viti 2013 dhe 2014 regjistroi rritje në nivelin e të ardhurave vendore vjetore përkatësisht me rreth 5.3% dhe 18.4%. Brenda kategorisë së taksave dhe tatimeve vendore kontributin kryesor pozitiv në vitin 2014 e dhanë të ardhurat nga *taksa mbi ndërtesat, tatimi mbi tokën bujqësore dhe taksa vendore e gjelbër*. Ndër përbërësit e tjerë të klasifikuar si të ardhura vendore, tarifatat vendore, janë elementi i dytë me peshën më të madhe në totalin e të ardhurave vendore (mesatarisht rreth 17.4% ndaj totalit të të ardhurave vendore në pesë vitet e fundit). Rritja e të ardhurave nga tarifa e pastrimit dhe higjienës në vitin 2014 kontribuoi pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga tarifatat vendore dhe të ardhurat vendore në total. Elementi i tretë më i rëndësishëm për nga pesha në totalin e të ardhurave vendore janë të ardhurat nga asetet shtetërore (mesatarisht rreth 9.0% për periudhën 2010-2014). Kjo kategori të ardhurash vlerësohet të ketë kontribuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave vendore në përgjatë tre viteve të fundit (kryesisht nga ecuria pozitive e të ardhurave nga *qiratë për tokën bujqësore dhe ndërtesat dhe ato nga kopshtet dhe çerdhet*).

**Shpenzimet totale** të kryera nga Bashkia e Beratit (pas reformës) gjatë pesë viteve të shqyrtuara në këtë analizë rezultojnë të jenë luhatur në 0.9-1.4 miliardë lekë. Pas një ngushtimi me rreth 3.6 dhe 1.9% në terma vjetorë përgjatë viteve 2011 dhe 2012, shpenzimet e kryera nga Bashkia Berat ndoqën një prirje rritëse në dy vitet në vijim. Kështu, shpenzimet totale shënuan vlerën 1.4 miliardë lekë në vitin 2014 (vlera më e lartë për pesë vitet e konsideruara), në rritje me rreth 42.3% krahasuar me një vit më parë. Përgjatë pesëvjeçarit të konsideruar, ecuria e përgjithshme e zhvillimeve në shpenzimet totale vlerësohet të jetë përcaktuar si nga transfertat e kushtëzuara nga ministritë e linjës ashtu nga të ardhurat e veta të bashkisë Berat (ku përfshihen financimet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve prej rreth 254.1 milionë lek). Shpenzimet e realizuara me fonde të veta rezultuan përcaktuesi kryesor në rritjen e shpenzimeve totale për vitin 2014.




Figura 47. Kontributi sipas burimeve në shpenzime totale (në pikë përqindjeje, grafiku majtas); Kontributi sipas programeve në shpenzimet totale (në pikë përqindjeje, grafiku majtas)



Burimi: Ministria e Financave, 2015; Përgatiti: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

Në ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve **buxhetore** struktura e shpenzimeve të bashkisë Berat rezulton të dominohet nga shpenzimet për funksionet e “mbrojtjes sociale”, “shërbimet e përgjithshme publike”, “çështjet ekonomike” dhe “strehimi dhe komoditetet e komunitetit”.

Figura 48. Shpenzimet totale sipas përdorimit dhe funksioneve.



Burimi: Ministria e Financave, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Shpenzimet e kryera nga bashkia Berat (pas reformës) gjatë periudhës në analizë përfaqësohen në masën më të madhe nga ato operative dhe të personelit. Këto dy kategori paraqesin elasticitet të ulët ndaj kufizimeve të mundshme buxhetore. Pra, në raste shkurtimesh të buxhetit, përgjithësisht janë shpenzimet kapitale ato që preken më shumë. Bashkia Berat paraqet nivelin më të lartë të shpenzimeve në secilën prej kategorive të shpenzimeve të konsideruara (investime dhe korente).

Në ndarjen sipas programeve, “mbrojtja sociale” rezulton programi në të cilin përthithet një pjesë e konsiderueshme e fondeve në dispozicion të bashkisë Berat (mesatarja e pesë viteve të konsideruara është 41.4% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera). Pas rënies vjetore në vitet 2011 dhe 2012, shpenzimet e destinuar për përmbushjen e këtij funksioni ndoqën një prirje rritëse në

dy vitet në vijim. Kështu, shpenzimet për mbrojtjen sociale për vitin 2014 rezultuan në rreth 530.8 milion lekë, në rritje me rreth 21.2% në terma vjetorë. Mbi 93.6% e fondeve të caktuara për mbrojtjen sociale (kryesisht *ndihmë ekonomike dhe pagesa për personat me aftësi të kufizuar*) vijnë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës së kushtëzuar. Shpenzimet për këtë program janë kryesisht në trajtën e *transfertave ndaj familjeve dhe individëve dhe të personelit për operimin e qendrave të shërbimeve sociale*. Investimet për qendrat sociale zënë një peshë të papërfillshme ndaj totalit të investimeve për pesë vitet e konsideruara.

Programi buxhetor *“shërbime të përgjithshme publike”* përfaqësoi mesatarisht rreth 18.4% të shpenzimeve totale përgjatë periudhës 2010-2013. Në vitin 2014, shpenzimet për këtë program rezultuan rreth 193.1 milionë lek (pesha ndaj totalit 13.7%), në rritje me rreth 1.9% krahasuar me një vit më parë. Brenda këtij programi, shpenzimet për administratën e bashkisë, komunave dhe institucioneve të varësisë *“planifikim, menaxhim dhe administrim”* zënë peshën kryesore ndër vitet e konsideruar. Mbi 95% e fondeve të shpenzuara në këtë program buxhetor erdhën nga fondet e veta të Bashkisë së re Berat dhe u shpenzuan kryesisht për paga dhe shpenzime të tjera operative.

Programi i shpenzimeve që lidhet me *“Strehimin dhe komoditetin e komunitetit”* ndaj totalit të shpenzimeve të kryera, rezulton të ketë ndjekur një trajektore rënëse përgjatë viteve konsideruara. Nga rreth 17.5% në vitin 2010, në vitin 2014 shpenzimet në këtë program u tkurrën dhe përfaqësuan rreth 13.7% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitin 2014, shpenzimet për strehim dhe komoditet të komunitetit rezultuan rreth 141.8 milionë lekë, në rënie me rreth 4.4% në terma vjetorë, si pasojë e tkurrjes së transfertave nga ministria përkatëse dhe/ose Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Në vitin 2014, 83.3% e shpenzimeve në këtë program u realizua me fonde të veta të cilat në masën më të madhe u përdorën për shpenzime operative dhe personeli.

Shpenzimet e destinuar për programin për *“çështjet ekonomike”* përfaqësuan mesatarisht rreth 12.1% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera nga bashkia Berat për periudhën 2010-2013. Në vitin 2014, shpenzimet në këtë program rezultuan rreth 401.1 milionë lekë, rreth 4.5 herë më të larta krahasuar me një vit më parë (ose përfaqësuan rreth 28.5% ndaj totalit të shpenzimeve). Rreth 36.3% e shpenzimeve në këtë program u krye me fonde të veta të bashkisë Berat ndërkohë që diferenca që përkethehet në rreth 254.1 milion lekë u financua nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Gjatë këtij viti, rreth 81.7% e fondeve të shpenzuara në këtë program u ndanë për investime kapitale në infrastrukturën rrugore vendore.

Programi buxhetor i *“arsimit”* zuri rreth 7.1% të shpenzimeve totale të realizuara nga bashkia e re Berat përgjatë viteve 2010-2014. Në vlerë, shpenzimet për arsimin rezultuan rreth 95.9 milionë lekë në vitin 2014, në rritje me rreth 11.1% krahasuar me një vit më parë. Në këtë program buxhetor, 47.9% e shpenzimeve u financua nga burimet e veta të bashkisë ndërsa 52.1% me anë të transfertës së kushtëzuar. Fondet e veta të Bashkisë Berat për vitin 2014 u përdorën kryesisht për mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe ato operative. Fondet në trajtën e transfertës së kushtëzuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit u përdorën për investime kapitale.

## **1.8 Qeverisja dhe përgjegjësia sociale**

### **1.8.1 Decentralizimi i Qeverisjes dhe Strukturat Përkatëse**

Më 29 korrik 2015, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Në këtë strategji prezantohet vizioni i qeverisë shqiptare për fuqizimin

e demokracisë dhe avancimin e procesit të decentralizimit në përputhje me vizionin dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe standardet e Bashkimit Evropian (BE). Me tregues krahasimisht të ulët të decentralizimit fiskal në rajon (me vetëm 2.2% të PPB-së) dhe efijencës, cilësi dhe standarde të dobëta në ofrim shërbimesh, kjo strategji, e parë në kombinim me reformën administrative territoriale dhe Ligjin e ri organik “Për Vetëqeverisjen Vendore”, shihet si një hap përpara për qeverisjen vendore.

Një risi thelbësore e ligjit të ri organik për qeverisjen vendore është prezantimi i parimit të decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e *subsidiaritetit*. Bashkitë me kapacitete njerëzore dhe financiare të përshtatshme kanë mundësi të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara.

Më specifikisht, kjo strategji parashtron katër objektiva strategjikë:

- (1) Përmirësimin e efijencës së përgjithshme të strukturave të qeverisë vendore-konsolidimi financiar dhe administrative i 61 bashkive pas adoptimit të ligjit të ri për ndarjen administrative territoriale; dhe mbështetje infrastrukture dhe institucionale për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.
- (2) Fuqizimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale-që synon reformimin e sistemit të të ardhurave vendore dhe përmirësimin e menaxhimit të financave vendore.
- (3) Mundësimi i zhvillimit të qëndrueshëm lokal;
- (4) Fuqizimi i qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Pas miratimit të Ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, qeverisja vendore në Shqipëri është organizuar në dy nivele, ku *bashkia*, njësi bazë, përbën nivelin e parë të qeverisë, ndërsa *qarku* përbën nivelin e dytë. Në ndryshim nga 373 bashkitë e komunat përpara ndarjes territoriale, aktualisht ka 61 bashki, të cilat përbëhen nga njësi administrative, të organizuara në qytete dhe fshatra. Ndarja në qarqe (12) mbetet në fuqi, ku çdo qark ka mesatarisht 5 bashki. Ndërsa funksionet dhe përgjegjësitë e bashkive janë rishikuar në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, roli i qarkut mbetet ende i paqartë.

### 1.8.2 Vështirësitë e Qeverisjes Vendore

Sfidat me të cilat përballen sot 61 bashkitë e krijuara nga ndarja e re administrative-territoriale janë njëherësh të trashëguara, por dhe të lidhura ngushtësisht me reformën territoriale (konsolidim nga 373 në 61 NJOV).

Bashkia e Beratit ka pësuar rritje, me një territor prej 381.5 km<sup>2</sup> në krahasim me shtrirjen 22.4 km<sup>2</sup> përpara reformës. Nisur nga burimet në dispozicion dhe konteksti, disa nga vështirësitë më të mëdha të Bashkisë Berat mund të përmbledhen si më poshtë:

*-Territore të reja më të mëdha për planifikim, menaxhim dhe për administrim shërbimesh. Me zgjerimin e territorit, bashkisë së Beratit do t'i duhet të ofrojë shërbime për një popullsi rreth 1.8 herë më të madhe se më parë, (23 657 banorë në 4 njësi administrative, krahas qytetit të Beratit). Në këto kushte, bashkia përballlet me nevojën për planifikim urban e rural, shtimin e kërkesës për ofrim shërbimesh, rritjen e rrezes së ofrimit të tyre, si dhe diversifikimin e llojit të shërbimeve të ofruara për shkak të karakterit urban dhe rural dhe zgjerimit të kompetencave (pyjet, kullotat, rrjeti dytësor i kullimit e ujitjes, etj.).*

- *Ndryshim, ose diversifikim i prioriteteve të zhvillimit.* Në kushtet e një territori të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një hap urgjent për t'u ndërmarrë. Do të duhet që vizioni, objektivat, programet, projektet prioritare dhe të gjitha dokumentet e lidhura me zhvillimin (përdorimi i tokës, planit të infrastrukturës, rregulloret, etj.) të formulohen dhe të reflektojnë qartësisht karakteristikat e territorit të ri të bashkisë Berat.

- *Mungesë kapacitetesh institucionale, përfshirë këtu administratën vendore, për të garantuar kryerjen e proceseve në mënyrë efektive dhe efikase.* Cilësia dhe aftësimi i burimeve njerëzore të bashkisë mbetet sfidë, sidomos në kushtet ku stafi, veçanërisht ai teknik, do të duhet të kryejë procese të një natyre të diversifikuar dhe shkalle më të gjerë. Me një territor më të madh për të administruar, stafi duhet të aftësohet për të koordinuar veprimet për 5 njësitë përbërëse të bashkisë, përkatësisht: Berat, Otlak, Velabisht, Roshnik dhe Sinjë. Mbështetja teknike dhe ngritja e kapaciteteve e deritanishme shpesh ka rezultuar me humbje për shkak të ndryshimit të stafit sipas ndryshimit politik në bashki. Funkcionet dhe përgjegjësitë (ekzistuese e të reja) që i kalojnë bashkive në kuadër të strategjisë së decentralizimit dhe ligjit organik, parashtrajnë nevojën për ngritje të kapaciteteve institucionale me fokus në: administrimin e shërbimit përkatës, menaxhim të financave publike, statistikë, planifikim strategjik, shkrim dhe menaxhim projekti, qeverisje territoriale, etj. Adresimi i kësaj sfide shihet si veçanërisht e lidhur me arritjen e përmirësimit të efikasitetit të strukturës së bashkisë Berat.

- *Autonomia fiskale:* Zgjerimi i portofolit të kompetencave dhe përgjegjësisë të bashkisë shoqërohet me sfidën e burimeve të pamjaftueshme. Mes transfertave të pakushtëzuara, të rezultuara si të ulëta, të paqëndrueshme dhe të ardhurave të veta të bashkisë, do të duhet të përmbushen funksionet e veta dhe ato të përbashkëta. Kjo sfidë nënvizon dhe nevojën për të përmirësuar aftësinë për mbledhur të ardhurat veçanërisht nga taksat dhe tarifat, si p.sh., taksa e pronës, taksa e pastrim-gjelbërimit, etj.

- *Sfida Mjedisore:* Mungesa e një inventari të hollësishëm të territoreve dhe pikave burimore (brenda territorit të saj) me rrezik ndotjeje për tokën bujqësore, ajrin, akuiferet, etj., dhe për pasojë dhe mungesa e projekteve parandaluese dhe rehabilituese. Përtej hartimit të një inventari të plotë dhe projekteve parandaluese apo rehabilituese, do të duhet që njëkohësisht, bashkia të bashkëpunojë me bashkitë e tjera dhe me institucionet qendrore të mjedisit dhe të burimeve natyrore për mbrojtjen e tyre nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.

Vështirësi të tjera të bashkisë Berat përfshijnë: *paqartësi për sa i takon funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta* pamundësi për t'u përfaqësuar nga një shoqatë bashkish e legjitimuar dhe pranuar nga të gjitha forcat politike, në procese konsultimi dhe dialogu në nivel qeverisje vendore, dhe sigurimi i përfaqësimit të popullsisë në procese të planifikimit dhe buxhetimit me pjesëmarrje (por jo vetëm).

### **1.8.3 Perceptimet Qytetare në lidhje me qeverisjen e tyre vendore, format e organizimit komunitar dhe bashkësia e OJF-ve, instrumente të transparencës, etj.**

Bashkia e Beratit ka organizata të regjistruara të shoqërisë civile, që mbulojnë një spektër të gjerë çështjesh, përfshirë: të drejtat e fëmijëve, të drejtat e gruas, të drejtat e komunitetit Rom, familje në varfëri ekstreme, njerëz më aftësi të kufizuara, etj.

Nisur nga studimet, rezulton që lidhja shoqëri civile/ institucione të tjera që operojnë në bashki (kryesisht përpara reformës, por dhe gjatë 2014 e në vazhdim), të jetë krahasimisht e mirë.



Megjithatë, sfida si mungesa e financimit nga pushteti vendor, ngritja e kapaciteteve të vetë OSHC-ve dhe nevoja për asistencë teknike janë po aq pranishme dhe në këto organizata. Disa nga format më të aplikuara të bashkëpunimit OSHC- Bashki, janë praktikat e buxhetimit me pjesëmarrje prej vitit 2005, dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje prej vitit 2009, konsultimet në kuadër të hartimeve të dokumenteve strategjike, etj.

## 1.9 Procese dhe dokumente planifikimi

### 1.9.1 Plani Rregullues i Beratit i Vitit 1983

Figura 49. Skica të planit rregullues të Beratit të vitit 1983



Burimi: Plani i Konsoliduar Urban i Bashkisë Berat, 2010

Plani i parë urbanistik për Beratin është hartuar në 1983-shin nën regjimin Komunist në Shqipëri. Objektivi i tij ishte shtrirja e zhvillimit urban përgjatë lumit dhe të përcaktonte shpërndarjen hapësinore të përdorimit të tokës për të orientuar zhvillimin e ardhshëm.

Plani pati ndikim në aspektin a planifikimit duke zgjeruar vijën e verdhë të ndërtimit. Deri në 1990 plani u ndoq duke influencuar fazat e dendësimit si dhe zhvillimin e hapësirave publike në qendër të qytetit.

### 1.9.2 Studim për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Beratit

Ky studim është kryer në një bashkëpunim midis bashkisë së Beratit dhe Co-PLAN-it në vitin 2007. Ai përmbledh informacione të gjendjes ekzistuese të qytetit të Beratit së bashku me analiza të kësaj situatë me qëllim identifikimin e problematikave kryesore gjatë hartimit të planit të përgjithshëm rregullues. Studimi parashton disa udhëzime orientuese për zgjidhjen e problematikave të hasura në një gamë të gjerë temash duke përfshirë: infrastrukturën, qasjet mjedisore, tendencat demografike, problematikat sociale, dhe problemet urbanistike e të pronësisë.


Me tej studimi parashton një vizion, disa udhëzime dhe parime orientuese për hartimin e planit rregullues duke u bazuar nga pyetësori social-ekonomik për qytetarët e Beratit.

### 1.9.3 Plani i Konsoliduar Urban i Bashkisë Berat

Plani është realizuar nëpërmjet projektit LAMP II (*The Land Administration and Management Project*) që përfshin "Përgatitjen e Planeve Urbane dhe Rregulloret për qytetet e Beratit, Korçës,

Lushnjës dhe Gjirokastrës". Plani propozon zgjerimin e një qyteti kompakt, për të përfshirë një popullsi prej 70,000 banorë deri në 2030, ndonëse plani është parashikuar të jetë i vlefshëm vetëm për një periudhë 10 vjeçare deri në vitin 2020. Ai bazohet në tre qëllime kryesore të: atraksionit turistik, një gjallëri që lind nga qenia e një qendre rajonale dhe një strukture të konsoliduar e lidhur përgjatë parkut të lumit të Osumit. Zhvillime të reja propozohen në periferinë lindore dhe jugore të qytetit, duke përfshirë zhvillimin e rëndësishëm të zonës së Pjeshkores. Synohet zhvillimi i parkut të lumit Osumit me një rëndësi rajonale, që do të lidhë dy pjesët e qytetit nga ndërtimi i një shëtitore dhe do të sigurojë aktivitetet sezonale në hapësirat e mëdha të tij. Zhvillimi i parkut përfshin rregullimin e lumit dhe integrimin e korridorit infrastrukturor të boshtit të qytetit. Parku së bashku me restaurime të zonave historike frymëzohen nga qasja turistike e planit.

**Figura 50. Plani Rregullues i Qytetit të Beratit: Përdorimi i Tokës**



*Burimi: Plani i Konsoliduar Urban i Bashkisë Berat, 2010*

Plani propozon zgjerim të qendrës së qytetit në zonat veriore të dy urave të Goricës dhe të Velabisht, si dhe kthimin e tyre në zona tregtare me ndërtesa 3-katëshe. Një qendër shtesë dytësore e qytetit do të ndërtohet përgjatë dhe në të dy anët e rrugës kryesore Antipatrea që të çon në lindje drejt Malit të Tomorit, në pjesën veriore të zonës së "pjeshkores". Pranë kësaj qendre si dhe në periferitë perëndimore të qytetit parashikohej zonë me densitet të lartë me ndërtesa 8-katëshe.

Zonat e banuara në pjesën e vjetër historike të qytetit dhe rreth zonës tampon ruajnë karakterin e tyre të veçantë. Përveç kësaj, ndërtesa të ulëta lejohen në fundet e kodrave, përgjatë parkut të lumit dhe pranë zonave informale në periferi të qytetit, për të ruajtur formën e tyre ekzistuese, integrimin e tyre në qytet dhe pajisjen e tyre me mundësi më të mira së bashku me objekte dhe shërbime publike.

Ndonëse hartuar që në 2010, Plani i Përgjithshëm Vendor, për Planifikimin e Territorit të Njësisë Vendore bashkia, Berat u miratua datë 20.12.2012 me Vendimin Nr. 7 të KKRTSH.

#### **1.9.4 Plane Strategjike**


**Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet Objektivave të Mijëvjeçarit** është një dokument i hartuar nga drejtoria e Programim-Zhvillimit të Bashkisë Berat dhe Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC) me mbështetjen e UNDP në vitin 2002-2003. Studimi fokusohet në objektivat e mijëvjeçarit për zhvillimin ekonomik dhe të ardhurave, përhapjen e arsimit, barazimin gjinor e forcimin e rolit të gruas, dhe rritjen e përkujdesit për nënat dhe foshnjat. Krahas politikave sociale studimi propozon lidhjen rrugore për zonat rurale Velçan-Osmenezë e Re, Sinjë-Velabisht, dhe Otlak-Balibardhë.

**Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik 2005-2010** është hartuar nga Bashkia e Beratit nën drejtimin e Bankës Botërore, Institutit të Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG. qëllimet kryesore të këtij plani përfshijnë zhvillimin e agrobiznesit e të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimin e turizmit nëpërmjet pasurive historiko-kulturore të qytetit të Beratit, dhe përmirësimin e hapësirës urbane në përputhje me parametrat bashkëkohore. Strategjia kufizohet në gamë për të përfshirë vetëm hapësirat e qytetit të Beratit si dhe mirëfunksionimin e organeve të tij qeverisëse.

**Plani i investimeve kapitale 2009-2013** hartuar nga Bashkia Berat në bashkëpunim me Co-PLAN në 2010 synon të mobilizojë burimet publike dhe private për stimulimin e investimeve kapitale. Ajo bën një përkthim të **planit strategjik të zhvillimit ekonomik dhe social të bashkisë** në projekte konkrete kapitale. Projektet strategjike kryesore të konsideruara janë ndërtimi i Unazës së qytetit, ndërtimi i aksit ura e Goricës- ura e re, sistemim të hapësirave urbane në qytet, rehabilitim i kalasë dhe financimi i projekteve për qendrën historike dhe ngritja e muzeut historik.

**Plani strategjik dhe i veprimit për turizmin në Berat 2011-2021** është një dokument zyrtar i hartuar nga Komiteti i Turizmit, ndritur me pjesëtarë të qeverisë vendore, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ai përcakton një vizion, qëllime të bazuara në cilësi dhe qëndrueshmëri. Më tej ai parashtron një listë projektesh paraprake si dhe planin e veprimit për të vënë në jetë këto qëllime. Projektet ndahen në kategoritë e: zhvillimit të produktit e rritjes së cilësisë; infrastrukturës e aksesit; marketingut dhe promocionit; si dhe burimeve njerëzore e menaxhimit të destinacioneve.

**Figura 51. Kufijtë e Qendrës Historike**



*Burimi: Strategjia e Turizmit dhe Plani i Veprimit, Berat, 2011*

Për promovimin e politikave të përmirësimit dhe rritjes të shërbimit, dokumenti parashikon përgatitjen e një plani të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të ndjeshme që kanë tërheqje turistike. Gjithashtu plani i veprimit përshkruan edhe projekte të rëndësishme infrastrukturore si: përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore (ujë, kanale, telekomunikacion) dhe mbitokësore (mbrojtja kundër zjarrit, ndriçim publik, banjo publike, parkim); rrugë për akses të disa monumenteve natyrore dhe kulturore; restaurimin e objekteve historike dhe monumenteve; etj. Plani bazohet, evidenton dhe ka për qëllim përputhshmërinë me zgjidhjet e përcaktuara në planin urbanistik të 2010.

**Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016** është përgatitur nëpërmjet projektit “Mbështetje e Integruar për Decentralizimin” i financuar nga BE-PNUD në qershor të vitit 2012. Plani është i shtrirë në nivel qarku dhe shtjellon objektiva ndërsektoriale për zhvillimin së bashku me projekte prioritare. Objektivat përfshijnë:

- “Të zhvillojë, mbështesë dhe ruajë kapacitetet zhvilluese të aktorëve dhe institucioneve të rajonit për të nxitur më tej procesin e zhvillimit rajonal.
- Të zgjerojë pjesën produktive të ekonomisë së rajonit, veçanërisht në sektorë/fusha të afta për të gjeneruar të ardhura për gjithë rajonin.
- Të sigurohet një nivel i duhur për lidhjen me rrugë brenda rajonit, shumë e rëndësishme kjo për qëllime ekonomike dhe sociale.
- Të vlerësohet dhe përmirësohet mjedisi natyror i Rajonit si aspekt kyç për identitetin dhe atraktivitetin e tij , veçanërisht duke shmangur gjithë efektet negative në mjedis që vijnë nga veprimtaria njerëzore.
- Të sigurojë ofrimin e përshtatshëm të shërbimeve bazë për qytetarët ku të garantohet shëndeti i mirë.
- Të zhvillohen kapacitetet njerëzore në rajon dhe të ofrohen kushte të përshtatshme për drejtësi, përfshirje dhe mundësi për të gjithë në mënyrë që sigurohet pjesëmarrje sa më e gjerë e qytetarëve në ekonomi dhe jetën sociale.”

Pjesa dërrmuese e projekteve të hartuara kërkojnë një financim të jashtëm dhe si rrjedhojë nuk janë zbatuar si të parashikuara në strategji.



**Raporti për gjendjen e mjedisit** është një dokument i hartuar nga Ministria e Mjedisit në 2014 që evidenton në nivel qarku problematikat dhe gjendjen e pasurive natyrore kombëtarë në Berat. Studimi analizon një gamë gjithëpërfshirëse si ujërat, mbetjet urbane, gjendja e ajrit, tokave e pyjeve si dhe zonat e mbrojtura e monumentet e natyrës.


Raporti evidenton problematika në bashkëpunimin e të gjithë aktorëve për miradministrimin e zonave të mbrojtura dhe monumenteve natyrore, pasi aktorët nisen nga interesi i momentit dhe jo në interes afatgjatë. Rekomandimet përfshijnë: përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve lidhur me transportin urban; përmirësim e cilësisë së lëndës djegëse që përdorin automjetet; reduktimin e zonave të ndërtimit dhe shtimin e hapësirave të gjelbra; monitorimi e cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE; dhe krijimin e një rrjeti të plotë të monitorimit urban në përputhje me kërkesat e BE.

**Plani kombëtar** është duke u hartuar nga Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe synon të japë një vizion të qartë mbi zhvillimin e territorit të Shqipërisë në vitet 2015- 2030. Ai përqendrohet në qëllime specifike strategjike të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve, mbrojtjen e interesave publike dhe private si dhe nxit planifikimin e harmonizuar të territorit.

Në variantin *draft* aktual, Plani Kombëtar e trajton Bashkinë Berat si një nga qendrat urbane të rëndësishme (kryeqendra) dhe si pjesë e rrjetit të rrugëve prioritare të vendit. Kjo nënkupton që Berati do të trajtohet si një zonë urbane me përdorim të përzier, me tregti, shërbime, transport, komunikim, zhvillim teknologjish, etj. Gjithashtu ky plan e trajton Beratin si një nga qendrat urbane të cilat do të jenë qendra të shërbimit shëndetësor të avancuar, qendra të arsimit të lartë dhe qendra kërkimore të zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit.

Referuar hartës së ndërlidhjeve hapësinore që vizioni i këtij plani propozon, mund të thuhet se Bashkia Berat bën pjesë në trekëndëshin motorik ekonomik të Vlorës, Fierit, dhe Lushnjës. Berati në këtë rajon duket se do të ketë rolin e një qendre inovacioni.

**Figura 52. Zonat buferike rreth qendrës historike**



Burimi: *Strategjia e turizmit dhe plani i veprimit, Berat, 2011*

### **1.9.5 Studime dhe projekte të pjesshme urbane**

“Management plan for the conservation and the development of Berat” është dokumenti i nominimit të zonës historike të qendrës së Beratit në listën e vendeve të trashëgimisë kulturore, hartuar në 2005 nga Comes Studio Associato. Krahas një përshkrimi të situatës së qytetit studimi parashtron dhe një plan menaxhimi që përcakton kufijtë e zonës historike, kufijtë e zonës buferike, hapësirat këmbësore dhe të trafikut automobilistik, urat dhe një plan përmirësimi të shërbimeve dhe infrastrukturës. Këto propozime e kanë përmbushur qëllimin e pranimit të kërkesës nga UNESCO për këtë zonë historike të qytetit.

Në qershor të 2012, Këshilli Bashkiak i Beratit ka miratuar **projektin e bajpasit**, të qytetit muze. Projekti përfshin ndërtimin e bajpasit të Beratit, sistemimin e Lumit Osum dhe përfshirjen e tij në planin e përgjithshëm rregullues të qytetit. Pozicioni i bajpasit kalon nga Ura e Re, dhe me një tunel 1.2 km në kodrën e Urës së Goricës, kalon në fshatin Bilçë për të përfunduar në lagjen Uznovë. Ky projekt nuk ka filluar ende fazën e ndërtimit pasi nuk ka siguruar fondet e nevojshme.

### **1.9.6 Përfundime**

Qyteti i Beratit është i mirë studiuar si pasojë e rëndësisë kulturore ndërkombëtare të tij. Ai posedon studime të shumta për lagjet historike dhe për qendrën e tij urbane. Në rang qarku ka plane të zhvillimit turistik, dhe të zhvillimit ekonomik-social rajonal. Sidoqoftë, mungojnë plane të detajuara për njësitë administrative përreth, që përbëjnë 95% të territorit të bashkisë pas reformës territoriale.


## 1.10 Mbi drejtimin e zhvillimit

### 1.10.1 Koncepti rajonal i zhvillimit

Bashkia e Beratit, e pozicionuar në Shqipërinë qendrore, lexohet si pjesë e disa rajoneve, nisur nga kriteret e përdorura në përcaktimin e rajonit. Për shembull, Berati shtrihet në basenin e lumenjve Seman e Devoll (dhe Osum) dhe bën pjesë në rajonin e zhvillimit të qarqeve Berat-Elbasan-Korçë<sup>80</sup>. Nga pikëpamja historike, territori i sotëm i Beratit ka qenë pjesë e disa provincave, principatave, apo vilajeteve. Në periudhën e antikitetit, ky territor shtrihet në provincën e Antipatrea-Bylis-Apollonia-Amantia ku ndodhet edhe Fieri i sotëm<sup>81</sup>. Në shekujt XII-XV të erës sonë, duket se pjesa më e madhe e territorit të Beratit shtrihet në principatën e Muzakajve<sup>81</sup>. Para shpalljes së pavarësisë në 1912, Berati ishte pjesë e sanxhakut të Beratit në vilajetin e Janinës, së bashku me Lushnjën, Fierin e Gjirokastrën. Berati (në 1923) bënte pjesë si nënprefekturë në prefekturën e Beratit (bashkë me Fierin, Lushnjeë, Mallakastrën dhe Skraparin) dhe përfshinte rrethin e Beratit dhe krahinat Sinjë-Zhabokikë, Kapinovë e Roskovec<sup>82</sup>. Aktualisht, Berati është një nga 5 bashkitë e qarkut të Beratit.


Sa më sipër pasqyron natyrën e ndryshueshme të rajonit si territor, në varësi të kriterëve që përdoren në përcaktimin e tij. Meqë në Shqipëri nuk kemi rajone administrative/qeverisëse, për qëllime planifikimi, Berati mund të jetë pjesë e rajoneve të ndryshme. Për qëllime të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të territorit të bashkisë së Beratit, rajoni i studimit të saj është konsideruar territori, pikat më të largëta të të cilit janë: Bashkia Elbasan në veri; bashkia Devoll në lindje; Bashkia Tepelenë në Jug; dhe Bashkia Fier në lindje. Ky rajon planifikimi është përcaktuar mbi bazën e kriterëve të shpjeguara më sipër, si edhe të: 1) korridoreve rrugore kombëtare që ndërthuren në territorin e Beratit dhe në kufijtë e tij; 2) rrjetit të zonave të mbrojtura natyrore që lidhen brenda këtij rajoni dhe në afërsi të territorit të Beratit; 3) zonave të rrezikut mjedisor nga ndotja e përcjellë prej lumenjve dhe ndikimi i zonave naftëmbajtëse; 4) sistemit të tokave bujqësore të Beratit, Kuçovës, Fierit dhe Lushnjes, 5) zhvillimeve historike dhe identitetit në shekuj.

Figura 293. Kriteret e përcaktimit të rajonit të studimit



Burimi: Planet kombëtare dhe studimi i policentrizmit; Përgatiti: PLGP, 2015

Figura 54. Sistemi urban dhe infrastruktura




Burimi: PLGP, 2015

Figura 55. Sistemi natyror





- Legjenda**
- Toka Bujqësore
  - Lumenj
  - Liqene
  - Rrjeti Hidrik
  - Paigju Ujmbledhës
  - Paigju Ujmbledhës i Shkumbinës
  - Paigju Ujmbledhës i Semanit
- 1:250,000
- 0 10 20 30 40 Km



Burimi: Agjencia e Baseneve Ujore; Përgatiti: PLGP, 2015

Figura 56. Analiza historike




- Legjenda**
- Rruga Egnantia, shek. II p.K
  - Kufi Provincas
  - Provincia Dyrrektion- Terana Dyrrektion shek. VII p.K
  - Provincia Apollonia- Bylis- Arantia Apollonia shek. VI p.K
  - Bylis shek. IV p.K
  - Arantia IV p.K
  - Provincia Kaonia- pavarur shek. V-IV p.K
  - Kufi Principate
  - Principata e Kastriotëve 1389-1444
  - Shqiptarët / Arantët 1432-1444
  - Principata e Muzajevë 1335-1444
  - Principata e Shqipërisë 1368-1443
  - Kufi Vijelet në vitin 1881
  - Kufi Sanxhaku në vitin 1881
- 1:250,000
- 0 10 20 30 40 Km



Burimi: PLGP, 2015

Figura 57. Koncepti rajonal



Burimi: PLGP, 2015

Për të hartuar një vizion zhvillimi për territorin e bashkisë, nevojitet koncepti i zhvillimit të rajonit në të cilin ndodhet Berati. Arsyet për këtë renditen si më poshtë:

1. Berati nuk funksionon si një ishull, por si pjesë përbërëse e rajonit të cilit i përket. Ekonomia e Beratit dhe pozicionimi i saj në rajon varen nga ekonomitë rrethuese dhe marrëdhënia plotësuese-konkurruese e Beratit me këto ekonomi;
2. Territori vendor përshkohet nga infrastruktura dhe akse e korridore rrugore, të cilat kanë rëndësi kombëtare dhe/ose rajonale. Çdo vendim për territorin vendor ndikohet nga këto akse e korridore. Një pjesë e mirë e tyre merren të gatshme nga studime dhe projekte e plane kombëtare (si p.sh. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit, planet sektoriale për transportin, energjinë, etj.), por një pjesë janë subjekt propozimi;
3. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit si dhe disa plane sektoriale përcaktojnë vendime që prekin drejtpërdrejt ose jo edhe territorin e Bashkisë së Beratit dhe çdo vendim të PPV-së së Beratit;

Rajoni i planifikimit që ndikon dhe ndikohet nga zhvillimi në Bashkinë e Beratit, përmban disa qendra kryesore (Fieri, Elbasani, Lushnja, Pogradeci dhe Korça) me larmi funksionesh urbane dhe rurale, si edhe disa qendra në zhvillim (Kuçova, Peqini, Librazhdi, Patosi dhe Cërriku), profili i të cilave është në formim. Bashki të tjera si Divjaka, Belshi, Gramshi, Skrapari, Maliqi, Këlcyra, Devolli e Pusteci kanë natyrë të theksuar rurale, me potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë dhe të turizmit. Turizmi mund të marrë forma të ndryshme në këtë rajon, që variojnë nga turizmi bregdetar, në atë ekologjik, natyror, bujqësor, malor dhe historik/kulturor. Kjo larmi mbështetet nga burimet natyrore dhe nga konteksti historik i zhvillimit.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, rajoni në të cilin bën pjesë Berati ka një karakter zhvillimi që bazohet në kombinimin mes ekonomive bujqësore (prodhuese dhe përpunuese), ekonomisë së turizmit (sipas të gjitha formave të mësipërme), industrisë dhe funksioneve urbane. Sigurimi i balancës mes këtyre ekonomive përbën sfidë për vizionin e ardhshëm të zhvillimit urban e rural të territorit. Faktikisht, për mënyrën se si janë zhvilluar deri më sot, këto ekonomi kanë prodhuar më së shumti konflikte mbi burimet se sa harmoni dhe bashkëjetesë. Është detyrë e konceptit të vizionit rajonal të zhvillimit të territorit që të propozojë se si mund të garantohet balanca.


Aktualisht potenciali turistik përfaqësohet nga rrjeti i zonave të mbrojtura natyrore, zona bregdetare dhe malore, qytetet me zona historike dhe/ose të klasifikuara si muze, qytetet kryesore me larmi funksionesh, parqe arkeologjike, një tërësi monumentesh kulture dhe monumentesh natyrore të shpërndara në territor, si dhe vendbanime rurale në funksion të turizmit:

- Bregdeti i Adriatikut nga delta e Shkumbinit deri në deltën e Vjosës;
- Parqe kombëtare<sup>83</sup>
  - Prespa në Korçë e Devoll, me sipërfaqe rreth 277 km<sup>2</sup> (ka edhe status të zonës RAMSAR).
  - Mali i Tomorit në Berat, rreth 247 km<sup>2</sup>, me biodiversitet të pasur, vlera shkencore, peizazhi, estetike, çlodhëse e turistike, historike e kulturore që garantojnë zhvillimin e turizmit ekologjik e kulturor.
  - Shebenik-Jabllanicë në Librazhd, 339 km<sup>2</sup>, me biodiversitet të pasur, vlera eko-turistike, pyje të virgjëra ahu.
  - Divjakë-Karavasta, 222 km<sup>2</sup>, me pasuri habitatesh dhe specie të rralla, me vlera historike, kulturore, arkeologjike e potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit (plan menaxhimi në hartim).
- Parqe natyrore apo rezervate natyrore të menaxhuara<sup>84</sup>
  - Dardhë-Xhyre, Sopot, Stavraj, dhe Polis, me sipërfaqe 400-45 ha dhe të gjitha pa plan menaxhimi, si dhe Kuturman (3,600 ha, pjesërisht i dëmtuar dhe i tejshfrytëzuar)-të gjitha në Librazhd,
  - Bogova në Skrapar me rreth 330 ha,
  - Pishë-Poro në Fier me rreth 1,500 ha, e rrezikuar nga përmytjet, kripëzimi i tokës, erozioni detar dhe ndotja që sjell delta e Vjosës. Pylli i Levanit në Fier (200 ha) pa plan menaxhimi,
  - Gërmenj-Shelegur (430 ha) në Kolonjë, Cangonj në Devoll (250 ha, zonë ndërkufitare) dhe Krastafillak në Korçë (150 ha në gjendje të rënduar dhe pa plan menaxhimi),
  - Qafë Bushi Rrezomë (500 ha dhe e dëmtuar) në Elbasan,
  - Balloll në Berat (330 ha), pa plan menaxhimi.
- Peizazhi i mbrojtur Vjosë-Nartë (rreth 197 km<sup>2</sup>), i pasur me ligatina, i pakënetëzuar, i rrezikuar nga ndotja që përcjell delta e Vjosës<sup>85</sup>
- Zona e mbrojtur e burimeve të menaxhuara Piskal Shqeri (54 km<sup>2</sup>) në Kolonjë, pa plan menaxhimi, me vlera historike, peizazhi, kulturore e turistike<sup>86</sup>
- Parku Arkeologjik i Apollonisë;
- Manastiri i Ardenicës (i Shën Marisë) si monument kulture dhe me territorin natyror të tij si monument natyre;



- Qyteti i Beratit me lagjet muze, mbi 2000-vjeçare, i njohur nga UNESCO, dhe si qendër urbane shumë-funksionale që mund të ofrojë shërbime për plotësimin e zinxhirit të vlerës së turizmit në të gjithë rajonin malor që shtrihet në qarkun e Beratit, e më tej në veri të Përmetit dhe verilindje të Kolonjës;
- Qyteti i Elbasanit me lagjen Kala dhe lagje të tjera me vlera historike, si qendër urbane shumë-funksionale, në presion zhvillimi, me lidhje shumë të mirë me Tiranën dhe me Korçën, përgjatë korridorit 8;
- Qyteti i Peqinit, si një qytet në zhvillim, në territor bujqësor dhe me objekte historike në territorin e tij (kalaja e Peqinit);
- Gjinari, Llixhat në Tregan, lugina e Shkumbinit nga Qukësi deri në burimet e tij në Valamare si zona me potencial për turizëm malor, kombinuar me shërbime specifike si ato që ofrohen nga llixhat, mundësia për ndërtim të pistave të skive në Valamare apo ecje në natyrë përgjatë Shkumbinit nga Qukësi në Lenie;
- Kuçova si territori dhe vendbanimi i parë në Shqipëri ku janë shfrytëzuar burimet e naftës, me infrastrukturë zonash industriale të trashëguar nga periudha para viteve '90-të dhe me një strukturë tipike të qytetit të ndërtuar gjatë diktaturës komuniste, të ruajtur në ditët e sotme.

Figura 58. Potenciali turistik dhe zonat në presionin e ndotjes mjedisore



Burimi: PLGP, 2015

Nga leximi i shpërndarjes së potencialeve turistike (të kombinuara me format e tjera të zhvillimit ekonomik, veçanërisht bujqësia), vihet re presioni që shkakton ndotja e mjedisit mbi një pjesë të mirë të këtyre potencialeve dhe territoreve rreth tyre. Kështu, nisur nga analizat e cilësisë së ujërave sipërfaqësore për Shkumbinin, Devollin, Osumin dhe Gjanicën, kemi evidentuar zonat ku shtrihet ndikimi i ndotjes së lumit, sipas pikave kryesore burim ndotjeje në territor. Po ashtu, figura e mësipërme evidenton edhe zonat kryesore që shfrytëzohen si burime nafte dhe industri e



rëndë ndotëse (Patos-Marinza, Kuçova, Ballshi dhe Elbasani/Bradasheshi) dhe drejtimin e presionit të tyre në territor.

Sipas këtij leximi, në basenin e Shkumbinit, zona me presion të lartë të ndotjes nis menjëherë pas qytetit të Elbasanit (derdhja e ujërave të zeza në lumë dhe prania e vend-depozitimit të mbetjeve urbane përgjatë tij) dhe vjen duke u intensifikuar deri në derdhje, me pika të nxehta pas Peqinit dhe Rrogozhinës. Në basenin e Seman-Osum-Devoll pika e parë e nxehtë evidentohet menjëherë pas qytetit të Beratit (uzina e baterive, ujërat e zeza dhe mbetjet urbane përgjatë lumit), për t'u intensifikuar pas Urës Vajguore dhe Kuçovës ku lumi merr me vete edhe ndotjen e naftës, më tej pas zonës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës dhe qytetit të Fierit. Si rezultat i ndotjes së lumit dhe ndikimit të zonave industriale, rrezikohen fusha prodhuese e Fierit dhe ajo e Bubullimës, fusha e Bradasheshit dhe e Cërrikut, tokat bujqësore përgjatë Shkumbinit dhe në Divjakë, më pak masivi kodrinor i Dumresë, dhe sigurisht zonat e mbrojtura përgjatë bregdetit në brendësi apo kufi të cilave ndodhen deltat e tre lumenjve që përcjellin ndotje (Shkumbin, Seman dhe Vjosë). Ndërkohë vlen të përmendet edhe dalja e gazsjellësit të TAP në plazhin e Semanit, ku do të ndërtohet një stacion kompresimi.

Së fundi, edhe pse një skenar i largët, një nga problemet me të cilat mund të përballet rajoni është përmbytja si rezultat i ndryshimeve klimatike. Kjo përmbytje, në rast se deti ngrihet me një nivel prej 30cm në 30 vitet e ardhshme, prek territorin bujqësor deri në Fier e Lushnje, i cili në rastin më të mirë nuk arrin më tepër se 50 m mbi nivelin e detit. Në një skenar të tillë, parapërgatitja duhet të jetë lokale dhe rajonale.

Analiza e mësipërme parashtron disa çështje me rëndësi për vizionin e ardhshëm të zhvillimit të rajonit dhe sigurisht edhe të bashkisë:

1. Çfarë karakteri do të kenë qendërsitë urbane të niveleve të ndryshme në rajon?
2. Cili është rrjeti i lëvizjes që i shërben më mirë rajonit nga pikëpamja e zhvillimit dhe lidhshmërisë dhe cila është hierarkia e tij?
3. Çfarë karakteri do të kenë korridoret e lëvizjes dhe cilat janë zonat e fashat e zhvillimit territorial në rajon?
4. Cili është vizioni për mbarështimin e zonave të mbrojtura natyrore?
5. Çfarë masash do të merren për të ndaluar çlirimin e mëtejshëm të ndotjes nga burimet përkatëse dhe depërtimin e saj në territor, veçanërisht në zonat më të rrezikuara, dhe si përkthehen këto masa në vizionin e zhvillimit të rajonit?
6. Cili është pozicionimi midis tre ekonomive të zhvillimit: bujqësore, të turizmit dhe të industrisë dhe si lidhet ky pozicion me vendimmarrjen për zgjerimin e fushës së shfrytëzimit të naftës në Patos-Marinzë dhe për ndërtimin e *landfill*-it në territorin e ish-Metalurgjikut në Elbasan
7. Si do të trajtohet sistemi rrugor rajonal në mënyrë që të mos promovojë zhvillim urban në dëm të tokës bujqësore dhe asaj natyrore?
8. Çfarë parapërgatitjeje mund të realizohet në nivel rajonal për të përballuar skenarët negativë të ndryshimeve klimatike?

Koncepti rajonal i zhvillimit bazohet mbi adresimin e çështjeve të mësipërme. Ky koncept nuk mund të zgjidhë sfidën e balancës midis tre ekonomive pa një vendimmarrje kombëtare. Megjithatë, duke iu referuar edhe PPK-së, koncepti i vizionit rajonal ndërtohet si më poshtë:

**i) Rajoni mbërthen dy basene të rëndësishme lumore, në të cilat (historikisht) lumi, si shtylla kurrizore e basenit, ka formuluar marrëdhënien e njeriut/vendbanimeve me natyrën. Pavarësisht**

se zhvillimet infrastruktureore kanë thyer disa nga pengesat natyrore, duke krijuar lidhje të shpejta të Tiranës me Elbasanin, apo Fierit me Tiranën, **rajoni Shkumbin-Devoll (përfshirë Osumin e Semanin), funksionon si një organizëm, që rrjedh nga lindja në perëndim.**

ii) **Rajoni përshkohet nga një rrjet kombëtar rrugësh.** Korridoret në të cilat rezulton ky rrjet lidhin qendrat kryesore urbane, thyejnë pengesat natyrore ose shfrytëzojnë terrenin/topografinë dhe i japin formë karakterit ekonomik dhe përdorimit të tokës në rajon. Kështu, Elbasani dhe Korça lidhen në sistem përmes **Korridorit VIII**, i cili shkurton kohën e udhëtimit Tiranë-Korçë edhe përmes segmentit Qukës-Plloçë. Ky korridor ka dy dalje ndërkombëtare-Qafë Thanën për në Maqedoni dhe Kapshticën për në Greqi. **Korridori (Boshti) qendror i Jugut** lidh trinomin Kuçovë-Urë Vajgurore-Berat me Elbasanin, Tiranën dhe Sarandën, duke siguruar dalje të shpejtë në Greqi përmes pikave kufitare të Kakavijës dhe Qafë Botës. **Korridori Blu paralel me atë të jugut** vendos në një aks të shpejtë Durrësin, Lushnjën, Fierin dhe Vlorën/Gjirokastrën, ndërsa ruan edhe daljen Fier-Memaliaj përmes luginës së Vjosës.

iii) Lidhja mes qendrave jo kryesore dhe e qendërsive urbane me qendra të nivelit të dytë fuqizohet përmes akseve rajonale. Akset rajonale thyejnë pengesat psikologjike dhe fizike të lëvizjes duke respektuar topografinë dhe luginat e lumenjve. Këto akse depërtojnë diagonalisht territorin dhe lidhen me akset kombëtare duke krijuar orbitale, të cilat rrethojnë zonat malore dhe krijojnë mundësi aksesit e tranziti për vendbanimet e thella rurale në akset kombëtare. **Korridoret rajonale janë boshti i efektit kaskadë të lëvizjes në territor.** Cërriku Gramshi e Maliqi lidhen përmes aksit rrugor (historik) që shtrihet përgjatë luginës së Devollit. Aksi Berat-Skrapar lë pas kanionet e Osumit dhe pasi kalon tangent parkun kombëtar të Bredhit të Hotovës (në veri të tij) bashkohet (duke shfrytëzuar topografinë) me aksin rajonal Korçë-Ersekë. Dy boshtet kombëtare veri-jug lidhen diagonalisht përmes akseve rajonale Ura Vajgurore-Lushnje dhe Ura Vajgurore-Fier.

iv) **Itineraret alternative natyrore/bujqësore/turistike janë zemra e profilit ekonomik të rajonit.** Këto itinerare nuk kanë për qëllim aksesin e shpejtë, por përkundrazi synojnë të mbërthejnë banorët dhe vizitorët brenda rajonit, të rritin kohën e ndërveprimit të tyre me vlerat natyrore e historike të tij e të fuqizojnë rrjedhshmërinë e aktivitetit bujqësor brenda rajonit. **Itinerari alternativ që lidh të gjithë rajonin fillon në Kashar** përshkon luginën e Pezës dhe degëzohet në dy dalje, në jug të qytetit të Kavajës dhe në daljen perëndimore të qytetit të Peqinit. Më pas itinerari merr karakter fushor dhe pas një depërtimi drejt Vilë-Boshtovës deri në derdhjen e Shkumbinit në Adriatik (mbi lagunën e Karavastasë), kthehet drejt jugut në Divjakë e më pas në perëndim drejt Fier-Sheganit dhe rezervuarit të Murrizit (Thanës).

Itinerari devijon në veri dhe veri-lindje për të përshkuar Dumrenë deri në Belsh e më pas në Cërrik dhe Shirgjan, ku rifiton karakterin malor dhe depërton drejt Treganit (dhe Llixhave) për të dalë në Gramsh. Segmenti Gramsh-Çorovodë vijon përgjatë Tomoricës, në këmbët e parkut kombëtar të Malit të Tomorit, në lindje të tij. Nga ky moment, itinerari zbërthehet në drejtime të ndryshme për të depërtuar pjesën jugore të Shqipërisë. Ky itinerar **lidh vendbanimet rurale së bashku dhe me akset rajonale, lidh zonën funksionale bujqësore me atë të turizmit malor dhe ekologjik dhe bashkon burime të rëndësishme natyrore e historike me njëra tjetrën.** Të tjera itinerare alternative të rajonit (me të njëjtën natyrë, por më të shkurtra) janë ato Elbasan-Gjinjar, Elbasan-Labinot Mal, Qukës-Valamare, Levan-Selenicë dhe Berat-Këlcyrë.

Figura 59. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Rrjeti Rrugor




**Legenda**

- Zonat Urbane
- Dytësore
- Kryesore
- Në studim
- Rrjeti i zonave të mbrojtura dhe emerald
- TAP
- Rruge kryesore
- - - Rruge të propozuara
- Rruge dytësore
- Rruge rajonale
- - - Hekurudha
- Ujera Sferiqësore

1:250,000


Burimi: PLGP, 2015

Figura 300. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Korridoret e lëvizjes dhe hierarkia e qendrave



Burimi: PLGP, 2015

Figura 311. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Nënrajonet e lëvizjes



Burimi: PLGP, 2015

v) Një rrjet i pasur zonash të mbrojtura natyrore (një pjesë e të cilave ndodhen brenda Brezit të Gjelbër Evropian) mbështjellin si kurorë të gjithë rajonin, duke shërbyer edhe si kufizuesit natyrorë të tij dhe të dy baseneve lumore. Zonat fillojnë në veri të Librazhdit, vijnë gjatë kufirit lindor të rajonit dhe Shqipërisë, depërtojnë në brendësi të rajonit duke kulmuar me Malin e Tomorit dhe në perëndim përfaqësohen nga brezi Karavasta-Nartë përgjatë bregut të Adriatikut. Brenda rajoni ndodhen edhe një sërë zonash natyrore të mbrojtura (më të vogla në sipërfaqe se kurora mbështjellëse) si dhe qendërsi urbane me vlera historike e kulturore dhe monumente kulture. Për t'iu përgjigjur nevojës që ka Shqipëria për të rritur sipërfaqen e mbrojtur natyrore, në këtë rajon fuqizohet lugina e Shkumbinit nga Dardhë-Xhyre në Sopot dhe Gurin e Nikës, deri në Valamare, ndërsa zonave të mbrojtura aktuale u shtohen edhe sipërfaqet e



**identifikuara rreth tyre si zonat Emerald. I gjithë ekosistemi nga parku kombëtar i Karavastasë deri në atë të Vjosë-Nartë, lidhet si një brez i mbrojtur përgjatë bregut.**

**vi) Ruajtja e aseteve natyrore të rajonit në funksion të qëndrueshmërisë së zhvillimit aftësisë vetë-ripërtëritëse është një nga objektivat kryesore të këtij koncepti rajonal të zhvillimit. Bregdeti është një ndër këto asete dhe cilësia e vijës bregdetare është reflektim i shëndetit mjedisor dhe ekonomik të të gjithë rajonit. Tokat bujqësore të kripëzuara nga jugu i Karavastasë deri në Pishë-Poro shpallen brez i mbrojtur natyror. Në këtë mënyrë ato i shtohen ekosistemit në ruajtje dhe evoluojnë drejt natyralizimit. Përveçse i shton rajonit dhe Fierit një territor të rëndësishëm për zhvillimin e eko-turizmit, ky brez krijon pengesën mbrojtëse mes tokave të Myzeqesë dhe detit dhe trajtohet në nivel kombëtar e lokal me projekte që zbutin erozionin detar dhe mbrojnë tokat bujqësore nga përmbytjet.**

**vii) Sistemi bujqësor që kufizohet nga Rrogozhina në veri, Belshi në veri-perëndim, Kuçova e Berati në jug, Fieri në jug-lindje, depërton përgjatë Shkumbinit deri në Elbasan, dhe ka në qendër Lushnjën, është një nga më të rëndësishmit në Shqipëri. Ka sipërfaqen më të madhe dhe rendimentin më të lartë dhe ka krijuar mekanizma mbrojtës të tokës bujqësore nga fragmentimi urban, ndotja industriale dhe degradimi si pasojë e përmbytjeve dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit dhe ujitjes. Ruajtja e tokës bujqësore të këtij rajoni është kryefjala e zhvillimit të tij dhe aktiviteti bujqësor fuqizohet përmes aplikimit të bujqësisë organike, konsolidimit të produkteve bujqësore (në pamundësi të konsolidimit të fermave), ndërtimit të tregjeve rajonale dhe mbështetjes kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe produktit shqiptar.**


**viii) Rritja inteligjente e zonës urbane dhe e qyteteve si motori i ekonomisë urbane është një nga shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit. Qendrat urbane rigjenerohen përmes projektesh që kanë në thelb: densifikimin përmes mbushjes urbane; krijimit të rrjetit arterial të lëvizjes urbane; mbrojtjes së hapësirës natyrore e bujqësore rrethqytetëse nga ndërtimet; krijimit të zonave të shtrirjes së qytetit në 15-20 vitet e ardhshme mbi bazën e projekteve realiste të popullsisë dhe të bollshme për të lejuar zhvillime infrastrukture e për të shmangur zhvillime të pakontrolluara dhe spekuluese mbi tregun e tokës.**

**Nga pikëpamja ekonomike qendrat urbane dhe vendbanimet krijojnë një rrjet që funksionon mbi parimin e plotësueshmërisë dhe konkurrueshmërisë. Elbasani evidentohet si një qendër e madhe urbane me karakter shumë-funksional, të ngjashëm me Tiranën, ku presioni për zhvillime urbane dhe ekonomike dikton densifikim dhe zgjerim e ku qytetarët plotësojnë të gjitha nevojat e tyre për shërbime (banim, arsim, kulturë, turizëm, industri, shëndetësi, etj.). Fieri, Kuçova, Ura Vajgurore dhe Patosi janë qendra me karakter të shumëfishtë, që lëviz nga prioriteti për zhvillimin e industrisë, tek turizmi dhe bujqësia, të gjitha në një balancë funksionale dhe ku Fieri përbën qendrën kulmore të kësaj fashe ekonomike. Lushnja ka karakter të pastër bujqësor nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, ndërsa qendra urbane e saj ofron shërbimet për të gjithë territorin e bashkisë. Duke ndjekur sa territorin bujqësor dhe atë natyror, një rrjet qendërsish urbane (të hierarkive të ndryshme për nga madhësia) specializohet në ekonomi urbane të bazuara mbi (eko/agro)turizmin dhe më pak bujqësinë si bazë për zhvillimin rural të bashkive Divjakë, Belsh, Gramsh, Skrapar, Berat, Pogradec dhe Korçë. Këto qendërsi urbane janë porta hyrëse për parqet kombëtare (zonat e mbrojtura), brezin kodrinor të zhvillimit rural (masivet e kodrave rrethuese me lartësi 150-300 m mbi nivelin e detit) dhe zonën malore që shtrihet nga Sopot në Valamare e deri në Frashër. Veçanërisht Berati e Korça të vendosura në perëndim e lindje të kësaj zone malore,**

janë qendrat kryesore urbane (porta të turizmit alor), përmes të cilave aksesohet ky territor dhe që funksionojnë së bashku me të si një organizëm ekonomik e mjedisor.

ix) **Industria** zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe bashkëjeton me funksionet e tjera të tij. **Balanca mes industrisë, bujqësisë dhe vlerave natyrore të rajonit është e një rëndësie jetësore për garantimin e aftësive vetëripërtëritëse të tij.** Fasha me gravitet ekonomik industrial ndodhet në pjesën jugore të sistemit kryesor bujqësor (me fokus industrinë e naftës), midis Fierit dhe Kuçovës, si dy polet e fashës dhe me një zgjatim drejt Ballshit. Territorët me funksion kryesor industrinë gjenden edhe në fushën e Bradasheshit brenda kufijve të zonës së ish-kombinatit metalurgjik të Elbasanit. Këto territore janë pastruar nga ndotjet industriale të trashëguara nga e kaluara dhe janë në funksion të industrive prodhuese e përpunuese, me teknologji të pastër. Zgjerimi i territorit për kërkime në zonë naftëmbajtëse drejt Bubullimës është në tkurje. Po kështu janë pastruar edhe të gjitha territoret e tjera industriale në Berat, Lushnje dhe Fier.

Figura 322. Koncepti i zhvillimit të rajonit-Ndërthurja e sistemeve dhe qendërve



## 1.10.2 Përfundime dhe analiza SWOT

### Territori dhe mjedisi

Analiza e metabolizmit tregon se si funksionon territori i bashkisë në lidhje me disa nga flukset kryesore të burimeve të tij, nga prodhimi deri në konsumim dhe prodhim të mbetjeve. Në territorin e Beratit energjia diellore mund të përdoret në periudha të caktuar, ku rrezatimi diellor është më i lartë. Energjia diellore mund të përdoret kryesisht në mënyrë individuale nëpërmjet paneleve fotovoltaike, për ngrohjen e objektit, ngrohjen e ujit, për pajisje të tjera elektroshtëpiake, të cilat përdorin energji elektrike, etj. Në këtë mënyrë energjia që shpenzohet aktualisht për ngrohje, që përftohet kryesisht nga drutë e zjarrit duke rritur në këtë mënyrë mbrojtjen ndaj mjedisit. Shpejtësia mesatare e erës luhet nga 2.6-3.1 m/s, çka tregon për potencialin e prodhimit të energjisë duke përdorur erën si burim. Nëse të gjitha potencialet që ka bashkia Berat për prodhimin e energjisë përdoren, siç janë energjitë e rinovueshme, sasia e energjisë do të mbulojë të gjitha nevojat që ka ky territor për furnizim me energji. Gjithashtu përdorimi i burimeve alternative mbron mjedisin dhe përdor burimet në mënyrë efikase.

Shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtrihet në të gjithë territorin nën administrimin e Bashkisë Berat. Ky shërbim ofrohet më tepër në zonën urbane të bashkisë dhe sistemi i shpërndarjes është konvencional (rrjet tubacionesh), por mund të përdoren edhe pusët për në zona të caktuara, në këtë mënyrë sigurohet edhe një mbulim më i mirë i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm. Sasia e ujit që prodhohet për pirje aktualisht është 5,294 m<sup>3</sup>/orë ndërkohë që kërkesa aktuale për ujë është 577 m<sup>3</sup>/orë, pra prodhohet gati 9 herë më shumë se kërkesa aktuale. Duke pasur parasysh këtë potencial që ka Bashkia Berat për fluksin e ujit, duhet që shërbimi i furnizimit me ujë të ofrohet në të gjithë territorin.

Nga fluksi i ushqimit mund të kuptojmë që Berat është i specializuar në prodhimin e foragjerëve, perimeve, drithërave, rrush, sigurisht ullinj dhe pemë frutore. Territori i Beratit ka sipërfaqe të konsiderueshme natyrore të cilat janë potencial për mbjelljen e drufrutorëve, duke rritur kështu prodhimin e këtyre kulturave bujqësore. Duke iu referuar edhe Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme për Beratin janë: ullinjët, vreshtat dhe pemët frutore (më tepër qershi dhe pjeshkë). Kulturat blegtorale me prodhimin më të lartë janë qumështi, mjalti dhe vezët.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim, në këtë mënyrë do të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Për këtë pushteti vendor duhet të përdorë stimuj që nxisin procesin e diferencimit të mbetjeve që në burim. Vend-depozitimi që ndodhet Orizaj duhet transferuar diku tjetër pasi kjo zonë është e papërshtatshme, pranë lumit Osum në tokë aluvionale. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë Berat dhe jo vetëm në zonën urbane.

## Zhvillimi ekonomik

Në vitin 2012 për qarkun e Beratit, sektori i bujqësisë dhe peshkimit shënoi VSHB më të lartë. Bashkitë Ura Vajguore, Kuçova, Poliçani dhe Skrapari i mbështesin ekonominë e tyre në bujqësi. Nga viti 2009 në vitin 2012, PBB për qarkun e Beratit ka shënuar rënie nga 3.1% në -2.1%. PBB për frymë në qarkun e Beratit në vitin 2014 ishte 371 mijë lekë, nën mesataren e vendit (460 mijë lekë).

Bashkia Berat është qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia dhe shërbimet.

Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %. Njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi për vitin 2011 shënon vlerën 90%. Njësitë Velabisht e Otlak janë dy njësitë të cilat kanë numrin më të lartë të bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre. Njësia Roshnik është më pak e zhvilluar. Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitetin ekonomik është i vogël, krahasuar me njësitë jo urbane.

Ndërveprimi ekonomik midis njësive administrative tenton të jetë i qendëruar nga Berati në drejtim të njësive të tjera administrative dhe anasjellas.

Për sa i përket pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore, në Bashkinë Berat ndodhen 2 pika nga të cilat 1 është në njësinë administrative Otlak dhe 1 në njësinë administrative Velabisht.

Njësitë administrative Sinja dhe Roshniku, që shtrihen në perëndim dhe lindje të Bashkisë Berat dhe janë kultivuese të prodhimeve bujqësore, duhet të kenë pika të grumbullimit të këtyre produkteve.

Në qytetin e Beratit operon një treg, investimi në këtë treg është i viteve të fundit, i cili ka përmirësuar cilësinë dhe kushtet e tregimit të produkteve të ndryshme. Vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.

Bujqësia është një sektor me peshë në ekonominë e Bashkisë Berat. Zonat që kanë me shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Osum si pasojë e terreni me fushorë që kanë në raport me njësitet e tjera që kanë një potencial me të moderuar për zhvillim bujqësor (teren kodrinor-malor).

Turizmi luan rol të rëndësishëm në ekonominë e Beratit. Por ende nuk është konsoliduar si sektor. Turizmi malor dhe natyror mund të luajnë rol kyç në ekonomi në disa zona të bashkisë.

Për sa i përket klasifikimit të ekonomive të njësive administrative të Bashkisë Berat mund të themi se të gjitha njësitë administrative janë ekonomi agrare duke përjashtuar qytetin e Beratit që është ekonomi aglomeruese.



## **Demografia**

Popullsia e bashkisë Berat në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie prej rreth 60 mijë banorë, nga të cilët 30.5 mijë meshkuj dhe 29.8 mijë femra. Rreth 60% e kësaj popullsie klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që diferenca prej 40% si popullsi rurale. Gjithashtu rreth 69% e kësaj popullsie i përket grup-moshës (15-64) vjeç, 19% e grupmoshës (0-14) vjeç, të dhëna këto që tregojnë së bashkia ka potenciale të larta të popullsisë ekonomisht aktive, përfshirja e të cilës në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen performancës ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj e re, tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.

Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike, por edhe në rënien e numrit gjithsej të popullsisë.

Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e popullsisë rezidente të bashkisë është edhe migrimi i brendshëm i saj, pra lëvizjet e popullsisë nga një qark në tjetrin.

Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e Qarkut/ Bashkisë Berat do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1.4 % dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migrimi i brendshëm.

Popullsia rezidente e bashkisë Berat do të ketë edhe në një periudhe të afërme një tregues të varësisë totale të ulet në vlerat (45-55) duke demonstruar kështu për mundësinë ruajtjes së të ashtuquajturit “divident demografik” deri në vitin 2021.

Për të përfituar nga ky deident demografik, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar , arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullsisë, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

## **Mirëqenia socio-ekonomike**

Në bashkinë Berat, niveli arsimor fillor i përfunduar shënon vlerën 53.2 %, arsimi i mesëm 33% dhe arsimi universitar 8.9 %. Berati (qytet) shënon shifrën më të ulët të raportit të numrit të personave që kanë kryer arsimin fillor dhe tetë ose nëntë vjeçar, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart 42.02% (52.10% mesatarja kombëtare). Dhe shifrën më të lartë të këtij raporti për arsimin e mesëm, universitar dhe pasuniversitar 12.55%. Krahasuar me mesataren kombëtare 11.80% , mesataren në nivel qarku 6.80% dhe njësitë përbërëse të bashkisë Berat. Shkalla e analfabetizmit në nivel qarku 3.21%, është më e lartë se mesatarja kombëtare 2.8 %. Ndryshe nga treguesit në nivel qarku, shkalla e analfabetizmit në qytetin Berat është 2.5%, më e ulët se mesatarja kombëtare. Shkallën më të lartë të analfabetizmit, krahasuar njësia Velabisht, Otlak, Sinjë dhe Roshnik e shënon njësia Roshnik 5.2% (2.8% mesatarja kombëtare).

Për sa i përket institucioneve arsimore, në bashkinë Berat shërbejnë 46 kopshte, 43 shkolla 9 vjeçare dhe 11 shkolla të mesme. Territori i bashkisë Berat mbulohet pjesërisht nga këto institucione. Zonat të cilat ngelen jashtë shërbimit arsimor shtrihen në njësinë Sinjë dhe Roshnik.

Bashkia Berat shënon 41.6 % të punësuar në shërbime, 39.4 % në bujqësi dhe 18.9 % në industri. Numrin më të lartë të të punësuarve me arsim fillor dhe 8 / 9 vjeçar, ndaj numrit të të punësuarve gjithsej të njësisë e shënon Sinjë 75.28 % (qyteti i Beratit 23.78 % ,mesatarja kombëtare 38.1%). Berati shënon shifrën më të lartë të të punësuarve sipas arsimit të mesëm, profesional dhe universitar, përkatësisht 48.96 % dhe 26.4%. Krahasuar me mesataren kombëtare, qarkun Berat dhe njësitë e bashkisë Berat. Numrin më të lartë të të punësuarve në bujqësi ndaj numrit të punësuarve gjithsej e shënon njësia Roshnik me 89.5% (Berati 4.1 %, mesatarja kombëtare 26.1%). Gjithashtu Berati shënon numrin më të lartë të të punësuarve në industri dhe shërbime, përkatësisht 29 % (mesatarja kombëtare 20.4%) dhe 66.89% (mesatarja kombëtare 53.5%). Njësitë Velabisht, Otlak, Roshnik, Sinjë shënojnë shifra tepër të ulta të të punësuarve në këto sektorë ekonomik.

Shifra më e lartë të personave të papunë 15 vjeç e lart, ndaj forcave të punës 15 vjeç e lart shënohet në Berat me 32.9% (mesatarja kombëtare 29.3%, qarku Berat 20.7 %, Roshnik 3.2%). Gjithashtu Berati shënon shifrën më të lartë të numrit të personave të papunë të moshës 15-24 vjeç, ndaj popullsisë ekonomikisht aktive të moshës 15-24 vjeç, 60.2 % (mesatarja kombëtare 52.9 %, qarku Berat 40.6%). Raportin më të lartë të punësuarve me pagë, ndaj të punësuarve gjithsej, e shënon Berati 70.5%. krahasuar me mesataren kombëtare 54.5% dhe mesataren në nivel qarku 34.9%. ndërkohë shifrën më të ulët të punësuarve me pagë e shënon Sinja 8 %, gjithashtu shënon dhe shifrën më të lartë të vetëpunësuarve 92 %.

Përsa i përket shëndetësisë, në Bashkinë Berat ka një spital rajonal, 2 qendra shëndetësore dhe 12 ambulanca. Njësia Sinjë e ofron këtë shërbim vetëm në 6 fshatra, të cilat janë të vendosura në pjesën veriore të saj. Duke lënë jashtë mbulimit të gjitha fshatrat që shtrihen në pjesën jugore. Njësia Velabisht e ofron këtë shërbim në 4 fshatra duke lënë jashtë mbulimit një numër të konsiderueshëm të popullsisë.

Burimi kryesor i të ardhurave për bashkinë Berat është puna e paguar me 58.8 % dhe më pas renditen të ardhurat nga pensionet, të ardhurat nga remitancat dhe nga ndihma sociale me përkatësisht 36.8 %, 10.5 % dhe 8.5 %. Berati burimin kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin dhe të gjitha llojet e pensioneve, përkatësisht 51.35% dhe 41.85%. Njësia Roshnik burimi kryesor të të ardhurave ka punën e paguar ose vetëpunësimin, e cila shënon

shifra 80.83%. Krahasuar me njësitë e tjera, shifrën më të lartë të parave të siguruara nga remitancat e shënon njësitë Otlak me 25.07%.

### **Përdorimi i tokës dhe infrastrukturat**

Sipërfaqja totale e Bashkisë Berat është 380 km<sup>2</sup>, nga e cila 170 km<sup>2</sup> është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 180 km<sup>2</sup> është tokë natyrore (pyje, kullota). Njësitë Otlak e Velabisht kanë përqendrimin më të lartë të tokës bujqësore.

Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osunit dhe është tepër i pasur me ujëra nëntokësor e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore është 9 km<sup>2</sup>.

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km<sup>2</sup>. Sipërfaqja që zënë shërbimet është 0.07 km<sup>2</sup>. Institucionet, shëndetësia dhe arsimit zënë një sipërfaqe prej 0.21 km<sup>2</sup>. Dhe janë të përqendruara në qytetin e Beratit dhe fshatrat kryesore të katër njësiteve.

Banimi shtrihet në një sipërfaqe të vogël, krahasuar me tokën bujqësore dhe natyrore, 4.63 km<sup>2</sup>.

Ndonëse aktualisht territori lidhet vetëm me një rrugë kryesore, parashikohet një korridor i ri lidhës me Bashkinë Memaliaj që e vendos Beratit në boshtin jugor qendror kombëtar. Si pasojë e reformës territoriale, Bashkia e Beratit ka tashmë një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore ku mbizotërojnë rrugët rurale me përdorim peizazhi. Problemi kryesor i rrjetit rrugor është numri i lartë (66 pika) i kryqëzimeve të rrugëve lokale me ato ndërqytetëse kryesore që përbëjnë burim aksidenti.

### **Financat vendore**

Performanca e të ardhurave totale të Bashkisë Berat (pas reformës territoriale) rezulton të ketë ndjekur një prirje përmirësuese duke filluar që prej vitit 2011. Burimet financiare totale (transfertat ndërqeveritare<sup>87</sup> dhe nga burimet e veta vendore<sup>88</sup>) në dispozicion të Bashkisë së re të Beratit janë luhatur në nivelin 0.9-1 miliard lekë në vit gjatë periudhës 2010-2013. Në vitin 2014 të ardhurat totale shënuan nivelin e 1.1 miliard lekëve, në rritje me rreth 14.5% krahasuar me një vit më parë. Në linja të përgjithshme, përcaktues në performancën financiare të Bashkisë Berat rezultojnë të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare. Ato përfaqësojnë mesatarisht në pesë vitet e fundit rreth 78.6% të të ardhurave totale. Ndërkohë, të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë ruajtur pothuajse një peshë të pandryshuar në totalin e të ardhurave të Bashkisë së re Berat gjatë periudhës së konsideruar (mesatarisht 21.4%).



## Analiza SWOT

PIKAT TË FORTA	PIKAT TË DOBËTA
<ul style="list-style-type: none"> <li><u>Turizëm dhe mjedisi</u> Qytet muze i njohur nga UNESCO përbën një atraksion ndërkombëtar të rëndësishëm turistik</li> <li>Lumi i Osumit është një burim ujor me pika të forta turistike si ishulli i Beratit dhe kanionet e Osumit</li> <li>Mali i Shpiragut dhe Parku Kombëtar i Tomorit kanë vlera për turizëm malor dhe fetar.</li> <li><u>Bujqësi</u> Kultivimi i ullirit/drufrutorëve është një industri e zhvilluar me prodhimin e ullirit dhe të përpunimit të vajit më të madh në rang kombëtar.</li> <li>Kultivimi i vreshtave dhe prodhimi i pijeve alkolike është një industri e zhvilluar dhe e njohur në vend.</li> <li>Vetëpunësim i lartë në agrikulturë është tregues i një sektori të shëndetshëm.</li> <li><u>Infrastrukturë dhe ekonomi</u> Ka një hapësirë të zonuar industriale të bollshme për zhvillimin ekonomik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><u>Turizëm dhe mjedisi</u> Mungesa e infrastrukturës për turizmin natyror e lehtë këtë sektor të pashfrytëzuar.</li> <li>Mosmenaxhim i zonave dhe monumentet historike i lë shumë pasuri kulturore në hije apo dhe në rrezik degradimi</li> <li>Ndotja e elementëve natyrore (lugina e Osumit, etj.) përbën problem shëndetësor si dhe përkeqëson eksperiencën turistike të zonës</li> <li>Mos-standartizimi i shërbimeve turistike të ofruara vështirëson kryerjen e një turizmi pozitiv dhe komod për turistët</li> <li><u>Bujqësi</u> Degradimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse rrezikon përmytjen e tokave bujqësore dhe të mbjellave</li> <li>Kosto e lartë e punimit të tokës ul konkurrencën e produkteve në treg</li> <li><u>Infrastrukturë dhe ekonomi</u> Konfliktet e pronësisë ngadalsojnë zhvillimin ekonomik</li> <li>Ndotja kimike e zonës industriale jo vetëm rrezikon banorët, por edhe rrit koston e rehabilitimit të ambienteve</li> <li>Struktura të amortizuara/degraduara të zonës industriale kërkojnë investime kapitale me të mëdhaja për rehabilitim</li> <li>Mungesa e lidhjeve rugore midis fshatrave rrit koston e komunikimit dhe tregtisë</li> </ul>
MUNDËSITË	KËRCËNIME
<ul style="list-style-type: none"> <li><u>Turizëm dhe mjedisi</u> Zhvillimi i shumëllojshmërisëshumëllojshmërisë të aktiviteteve turistike (turizmi soft) ofron mundësi zgjedhjeje dhe diversiteti për grupe të ndryshme të synuara.</li> <li>Krijimi i një itinerari peizazhi/turistik kombëtar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><u>Turizëm dhe mjedisi</u> Rritja e fluksit turistik në mënyrë të paqëndrueshme që sjell degradimin e mjedisit si pasojë e keq menaxhimit të aktiviteteve turistike, kryesisht natyrore.</li> </ul>



nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint që ta integrojë Beratin në paketat turistike për rajonin jugor.

Identifikimi i Beratit si qendër rajonale e turizmit për ofrimin e shërbimeve dhe akomodimit të turistëve.

- Bujqësi

Krijimi i kooperativave private për kultivimin dhe nxjerrjen në treg të produkteve bujqësore. Mundëson ndarjen e kostove dhe gjetjen e tregut.

Promovimi dhe mbështetja e industrisë së pularive.

- Infrastrukturë dhe ekonomi

Lidhje te reja rrugore me Elbasanin dhe Memaliajn edhe nëpërmjet *Bypass-it* të qytetit Berat do të krijojnë zhvillimin e tregtisë nga rritja e aksesit.

Rigjenerimi i zonës industriale

Mundësitë e investimit nga burimet e huaja duke përfshirë remitancat dhe kapitalin e investuar nga emigrantet e kthyer.

- Bujqësi

Prishja e produkteve ushqimore nga mungesa e tregut.

Kosto e lire e produkteve ushqimore të importit të cilat konkurrojnë prodhimin vendas.

- Infrastrukturë dhe ekonomi

Largimi i forcës së punës për shkak të migrimit të brendshëm dhe emigrimit.

## II. VIZIONI I TË ARDHMES PËR BERATIN

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Beratit është hartuar mbi bazën e gjetjeve dhe përfundimeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupe interesi e institucione publike dhe reflektime të grupit të punës, gjatë studimit të kontekstit rajonal, në të cilin ndodhet bashkia. Po ashtu, vizioni i Beratit bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit të prezantuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dhjetor 2015. Mbi këto baza, aktorët e interesuar, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord në formulimin e vizionit strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme, si më poshtë:


*“Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat e qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture moderne, si një destinacion i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse/pritëse për një rajon të pasur natyror. Koncepti i propozuar për zhvillimit e Beratit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. Këto janë themele të forta, të cilat garantojnë që i gjithë komuniteti të përfitojë sot, duke iu trashëguar njëkohësisht brezave të ardhshëm një territor e mjedis të shëndetshëm e të vetëripërtërishëm, krahas zhvillimit ekonomik dhe social të qëndrueshëm.*

*Urbanizimi është një proces dinamik, por i kontrolluar e me rritje graduale në Berat. Ai fokusohet në forcimin dhe konsolidimin e qendrave ekzistuese, si dhe shfrytëzimin e drejtë të hapësirave publike dhe orientimin drejt poleve urbane të zhvillimit. Në këtë mënyrë shërbimet sillen më afër komunitetit, në mënyrë efikase nga pikëpamja ekonomike dhe mbi të gjitha, krijohet një klimë e shëndetshme për biznesin, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë. Përmes fuqizimit të ekonomisë rurale së saj, Bashkia Berat synon të konsolidojë profilin si pol rajonal i zhvillimit ekonomik turistik, duke u bërë konkurruese në nivel vendi dhe më gjerë. Duke u mbështetur tek parimet e subsidiaritetit, synohet përforsimi i një rrjeti shumë-qendërsish në territor, të decentralizuara si poleve të zhvillimit ekonomik dhe administrativ. Këto qendra të përbëra nga vendbanime cilësore dhe aktivitete ekonomike plotësuese brenda rrjetit, kulmojnë me qytetin e Beratit, ku fokusohet shumica e aktiviteteve urbane dhe e shërbimeve publike e komunitare. Këto shërbime ofrohen me të njëjtin standard për të gjithë banorët, në të gjithë territorin e bashkisë, me qëllim zvogëlimin e diferencës urbane-rurale sa i përket ofrimit të infrastrukturës fizike, arsimit, shërbimit shëndetësor, si dhe mundësive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të natyrës urbane e rurale.*

*Një nga asetet më me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktivë në tregun e punës. Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat”*

Bazuar në këtë vizion të ardhshëm zhvillimi, informacionet e analizuara në kapitujt paraardhës dhe në prioritetet e administratës publike dhe banorëve, në vijim janë përcaktuar Objektivat Strategjike të zhvillimit të territorit të Bashkisë Berat.

Figura 63. Harta e Vizionit, Bashkia Berat



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015




### III. OBJEKTIVA STRATEGJIKE DHE PROGRAME

#### 3.1 Objektivat dhe programet strategjike

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Figura 64. Fashat dhe qendërsitë



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

**Objektivi strategjik 1:** Orientimi i zhvillimit hapësinor me instrumente inovativ të manaxhimit të tokës me qëllim strukturimin e hapësirës urbane në funksion të nxitjes dhe fuqizimit të një ekonomie të larmishme në sektor dhe mjedis cilësor për komunitetin.

Zhvillimi ekonomik dhe territorial i bashkisë do të mbështetet mbi modelin policentrik, me qëllim decentralizimin e funksioneve të shumëllojshme dhe plotësuese të njëra-tjetrës në pika të ndryshme gravitacionale në territor dhe përgjatë fashave të rëndësishme territoriale. Qyteti i Beratit do të vazhdojë të ketë profilin e një ekonomie me sfond zhvillimin e turizmit (një shumëllojshmëri formash dhe veçanërisht atë historik) dhe zhvillimin rural. Bërthama urbane e



bashkisë, ku do të përqendrohen funksionet administrative, zonat urbane të banimit dhe shërbimet kryesore publike, do të jetë qyteti i Beratit. Është e rëndësishme që të konsolidohen sa më shumë lidhjet e kësaj bërthame urbane me akset nacionale të lëvizjes, si bypass-i i Beratit dhe Boshti Qendror i Jugut, si dhe me itineraret lokale e për rrjedhojë me vendbanimet në qendrat e tjera administrative.

Qasja kryesore e urbanizimit të mëtejshëm të territorit të Bashkisë Berat përfaqësohet nga ritme dinamike densifikimi në dy skajet e qytetit, në pjesën veriore drejt zonës industriale dhe në pjesën jugore drejt Uznovës. Në këtë mënyrë qyteti do të ketë një zhvillim linear, ku qendra e qytetit do të vazhdojë të ruajë rolin e saj si një pol administrativ, kulturor dhe banimi.

Zgjatimi i qytetit drejt skajeve të veta, krijon nyje me rëndësi sa i përket mundësisë për të përqendruar banim intensiv të ndërthurur me biznese, shërbime tregtare dhe aktivitete të industrisë përpunuese (ushqimore dhe tekstile). Këto pole bëhen të domosdoshme për procesin urbanizues dhe densifikimin e mëtejshëm të qytetit të Beratit, veçanërisht për shkak të sipërfaqeve të mëdha dhe ndërtesave ish-industriale të papërdorura në mënyrë eficiente deri më sot.

Gjithashtu, në dy skajet e qytetit propozohen hapësira të zgjerimit të qytetit përse i përket banimit me densitet të ulët. Në këto zona (qendërsi 11 dhe fasha 15), bashkia synon të nxitë banorët/pronarët që në pronat e tyre të zhvillojnë bujqësi urbane duke plotësuar jo vetëm nevojat personale apo plotësuar disi tregun, por mbi të gjitha duke rritur cilësinë estetike dhe mjedisore në zonë. Ky propozim vjen paralelisht me nxitjen për të zhvilluar hapësirat përkrah për industrinë ushqimore përpunuese (respektivisht fashat 9 dhe 16).

Zgjerimi i qendrës ekzistuese në drejtimin e aksit kryesor të qytetit (fashat 3, 4, 5 dhe qendërsia10) do të synojë shtimin dhe përmirësimin e hapësirave dhe shërbimeve publike. Ndërkohë në veri të këtij aksi (sidomos në fashën 8) propozohet mbushje urbane për të akomoduar banorë të rinj të qytetit, duke e ndërthurur me plotësimin me shërbime publike në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe me hapësira të hapura publike.

Për këtë objektiv strategjik janë parashikuar katër programe strategjike, të cilat paraqiten më poshtë. Projektet për çdo program paraqiten në planin e veprimit në kapitullin në vijim.

Programi Strategjik OIP1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy poleve ekonomike rajonale, pranë njësive Otlak dhe Velabisht.

Programi Strategjik OIP2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative.

Program Strategjik OIP3: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve.

**Objektivi Strategjik 2:** Zhvillimi i turizmit shumëdimensional historiko-kulturor dhe [eko/agro]turizmit, në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm e me vlera natyrore, si sektori bazë për zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e mirëqenies sociale të komunitetit.

Turizmi në Bashkinë e Beratit merr rëndësi si një sektor ekonomik gjenerues i zhvillimit urban dhe rural. Nëpërmjet ndërthurjes së aktiviteteve të turizmit historik dhe kulturor me atë natyror e agrar në zonat rurale dhe natyrore, synohet riaktivizimi i ekonomive lokale të njësive

administrative, nxitja e popullsisë për të zbuluar dhe përdorur një mundësi të re për aktivitete ekonomike, si dhe nxitja e punësimit në këtë sektor pak zhvilluar deri më sot përkundrejt potencialit.

Për këtë qëllim, bashkisë i duhet jo vetëm të nxitë krijimin e paketave të reja turistike, të pajisë territorin me sinjalistikë e të kryejë investime të infrastrukturës së turizmit (p.sh. itinerare për ecje në natyre, masa mbrojtëse dhe sigurie për eksplorimin e zonave të thella malore/natyrore, sinjalistika e rafting, etj.), por edhe të garantojë ruajtjen e burimeve dhe vlerave natyrore. Këto të fundit janë atraktorë për grupet dhe operatorët turistikë, por edhe faktorë për të fuqizuar aftësinë vetëripërtëritëse të territorit në Berat.

Ky objektiv ka në thelb turizmin si sektori bazë i zhvillimit lokal në Berat, por edhe mbrojtjen e mjedisit, si vlera më e rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Për këtë qëllim, programet variojnë mes programeve thellësisht me karakter mjedisor dhe atyre me karakter fuqizimin e sektorit të turizmit.

Programi Strategjik O2P1: Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kondrinore-malore.

Programi Strategjik O2P2: Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Gorricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik.

Programi Strategjik O2P3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar, hotelier dhe informativ për turistët në qytetin e Beratit si dhe përgjatë rrugëve panoramike dhe peizazhistike

Programi Strategjik O2P4: Mbështetja me infrastrukturat dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësinë Roshnik.

Programi Strategjik O2P5: Mbrojtja e sistemit urban nga përmytjet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor.

Programi Strategjik O2P6: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ si dhe ndërtimi i impantit të trajtimit të ujërave të zeza.

Programi Strategjik O2P7: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale.

Programi Strategjik O2P8: Modernizimi i shërbimit të menaxhimit e integruar të mbetjeve urbane dhe ndërtimi i një landfilli rajonal për menaxhimin e mbetjeve.

Programi Strategjik O2P9: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial.

**Objektivi Strategjik 3:** Fuqizimi i aksesit brenda territorit të bashkisë dhe ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin.

Zhvillimi i Bashkisë Berat sipas modelit policentrik kërkon pajisjen me një rrjet infrastrukturor të mirëorganizuar dhe hierarkik. Për këtë qëllim, është janë hartuar programe specifike që adresojnë segmente të rëndësishme rrugore dhe itinerare të lëvizjes.

Programi Strategjik O3P1: Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat në funksion të trafikut ndërqytetas.

Programi Strategjik O3P2: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare.

Program Strategjik O3P3: Menaxhimi i trafikut lokal përmes sistemit të informacionit dhe ndërhyrjeve pikësorë në infrastrukturë.

Program Strategjik O3P4: Hartimi dhe zbatimi i një plani sektorial të transportit publik të integruar për bashkinë Berat.

**Objektivi Strategjik 4:** Zhvillimi i sektorit të bujqësisë e blegtorisë në funksion të zhvillimit rural dhe uljes së papunësisë.

Vec mbështetjes për ekonomitë fermere, incentivave për konsolidim të kulturave bujqësore dhe trajnimeve për fermerët, ky program parashikon edhe investime në infrastrukturën kulluese-vaditëse, magazinuese-grumbulluese, përpunuese dhe tregtuese të produkteve bujqësore, për të përmirësuar të gjithë zinxhirin e prodhimit. Përveç pikave ekzistuese të grumbullimit të produkteve bujqësore në Otlak, do të nxitet sektori privat për krijimin e strukturave magazinuese dhe tregjeve të shumicës për produktet ushqimore në disa fasha (9 dhe 16) të pozicionuar në periferi të qytetit të Beratit, si dhe në njësitë Velabisht dhe Otlak.

Programi Strategjik O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkërendim i punës me institucionet qendrore për sistemin e ujërave të larta të stuhive.

Programi Strategjik O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore nga zhvillimet urbane.

Programi Strategjik O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, konsolidime të kulturave, kooperativa bujqësore, etj.) përmes PPP-ve dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve.

Programi Strategjik O4P4: Mbarështimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në blegtori e bujqësi.

**Objektivi strategjik 5:** Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit arsimor dhe shëndetësor, si dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse të zbutjes së pabarazive sociale dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Arsimi dhe shëndetësia janë tregues të mirëqënies sociale. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe dhe rritja e cilësisë në këto institucione është një objektivi i rëndësishëm i Bashkisë Berat. Konsideratat e kësaj strategjie për sektorin e strehimit, shkojnë përtej ndarjes së funksioneve mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore, duke ngritur nevojën për krijimin e partneriteteve solide mes niveleve të qeverisjes dhe me sektorin privat për projekte të mundshme PPP.

Programi Strategjik O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.

Programi Strategjik O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ambulancave në njësitë administrative të Bashkisë Berat.

Programi Strategjik O5P3: Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë, nxitje për arsimin profesional dhe universitar.

Programi Strategjik O5P4: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë administrative të Bashkisë Berat.

Programi Strategjik O5P5: Zbatimi i programit lokal për strehimin social.

**Objektivi strategjik 6:** Mbështetja e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxitja e sipërmarrësve të rinj, me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkuresh në rajon.

Duke qenë se bashkia Berat synon një zhvillim inteligjent të territorit të saj për një shoqëri intelektuale, do të mbështesë me burimet e saj njerëzore dhe financiare çdo iniciativë nga sipërmarrësit e rinj me ide inovative në fusha si [eko/agro]turizmi, bujqësia organike apo dhe energjitë e rinovueshme (eolike/diellore).

Programi Strategjik O6P1: Mbështetje, marketim, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.

Programi Strategjik O6P2: Nxitje e sipërmarrësve të rinj për jetësimin e projekteve me ide inovatore për tregun aktual.

### **3.3 Konsiderata financiare**

Bashkia e re Berat, ndonëse renditet e trembëdhjeta në vend për nga niveli i të ardhurave të gjeneruara nga **burimet e veta** paraqet një nivel të ulët autonomie financiare përgjatë pesë viteve të konsideruara. Mesatarja e raportit të të ardhurave të veta ndaj të ardhurave totale rezulton të jetë mesatarisht 21.4% për periudhën 2010-2014. Këto të ardhura mbuluan mesatarisht 20.3% të shpenzimeve totale të realizuara gjatë periudhës së konsideruar. Nëse në të ardhurat e veta do të shtonim edhe të ardhurat nga taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar, burimet totale në dispozicion të bashkisë do të përfaqësonin mesatarisht 49.8% të të ardhurave totale dhe mesatarisht do të mbulonin 39.6% shpenzimeve totale. Në vijim të ndarjes së re administrative-territoriale dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia e re e Beratit përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrazi nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së tatueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative). Ligji ri për buxhetin vendor të viti 2016 solli disa risi në kuadrin nivelit, llojit dhe numrit të taksave. Përgjithësisht, në periudhën afatshkurtër efektet e heqjes së disa taksave dhe futjes/modifikimit të disa të tjera vlerësohet të do të baraspeshojnë njëra tjetrën duke u përkthyer në një efekt pothuajse neutral për buxhetin vendor.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive);



fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF etj) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

## IV. PLANI I VEPRIMIT

### 4.1 Plani i veprimit

Programet strategjike	Projektet	Vlera	Burim mundshëm kryesor	Burim mundshëm kryesor	Tregues vlerësimi	Fazat e zbatimit				
						I: '16-'18	II: '19-'20	III: '21-'25	IV: '25-'30	
<b>Objektivi Strategjik 1:</b> Orientimi i zhvillimit hapësiror me instrumente novatore të menaxhimit të tokës me qëllim strukturimin e hapësirës urbane në funksion të nxitjes dhe fuqizimit të një ekonomie të larmishme në sektor dhe mjedis cilësor për komunitetin.	<b>Programet strategjike</b>									
<b>OIP1:</b> Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy poleve ekonomike rajonale, pranë njësisë Otlak dhe Velabisht.	Hartimi i PDV-së së Polit ekonomik pranë fshatit Otlak	Për t'u llogaritur	Buxheti i Bashkisë	Ministria e Zhvillimit Urban	Dokumenti i PDV-së i hartuar					
<b>OIP2:</b> Intensifikimi i aktiviteteve urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative.	Hartimi i PDV-së së Polit ekonomik pranë fshatit Velabisht	Për t'u llogaritur	Buxheti i Bashkisë	Ministria e Zhvillimit Urban	Dokumenti i PDV-së i hartuar					
<b>OIP3:</b> Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të njësive administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve	Rigjenerimi dhe rivitalizimi i qendrave të Njësive Administrative	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Zhvillimit Urban	Qendrat e NjA-ve të përmirësuara					
	Rikonstruksion i hapësirave urbane në lagjen "Murat Çelebiu"	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Donatorë ndryshëm	Rivitalizim i hapësirave urbane					
	Rikonstruksion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit.	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Donatorë ndryshëm	Rikonstruksion i fasadave					
	Ofrimi i Zonave hapësirave rekreative dhe argëtuese për banorët e qytetit në pollet e zhvillimit 5, 10, 12, 14 dhe 18	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Donatorë të ndryshëm	Hapësira rekreative dhe argëtuese në qytetin e Beratit					
<b>Objektivi Strategjik 2:</b> Zhvillimi i turizmit shumëdimensional historiko-kulturor dhe [eko]agroturizmit, në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm e me vlera natyrore, si sektori bazë për zhvillimin ekonomik lokal dhe krijen e mirëqenies sociale të komunitetit.	<b>Objektivi Strategjik 2:</b> Zhvillimi i turizmit shumëdimensional historiko-kulturor dhe [eko]agroturizmit, në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm e me vlera natyrore, si sektori bazë për zhvillimin ekonomik lokal dhe krijen e mirëqenies sociale të komunitetit.					I	II	III	IV	
<b>O2P1:</b> Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin	Përcaktimi i itinerareve dhe destinacioneve tërheqëse për turizmin në qytet në zonat	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Itineraret në zonat turistike dhe kalendari i					

dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kodrinore-malore.	kodrinore-malore duke krijuar një kalendar veprimtarish vjetore	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Harta me asetet historike	veprimtarive		
	Hartëzimi i aseteve historike të bashkisë				Botimi i broshurave promovuese për turizmin historik, natyror dhe kulturor të Bashkisë Berat	Botimi i broshurave promovuese për turizmin historik, natyror dhe kulturor		
	Publikimi i broshurave promovuese për turizmin historik, natyror dhe kulturor të Bashkisë Berat	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarjes				
	Krijimi i një itinerari peizazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint që ta integrojë Beratin në paketat turistike për rajonin jugor. I cili i mundëson turistëve që me automjetet e tyre të vizitojnë tre qendra historike dhe njëkohësisht të mund të shijojnë peizazhin e bukur të rajonit jugor.	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Integrimi i Beratit në rajonin jugor turistik			
O2P2: Modernizim i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Gorricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik.	Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes "Mangalem" (16 banesa)	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Restaurimi i banesave			
	Restaurimi i godinave të amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri, në zonat historike.	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Rritja dhe konservimi i vlerave historike të qytetit			
O2P3: Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar, hotelier dhe informativ për turistët në qytetin e Beratit si dhe përgjatë rrugëve panoramike dhe me	Krijimin e paketave të reja turistike	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Promovimi i Beratit nëpërmjet këtyre paketave			
	Shtimi i zyrave të informacionit për turistët	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Kulturës	Zyra informacioni			

peizazhistike					të shpërndara në pika të ndryshme të bashkisë		
O2P4: Mbështetja me infrastrukturat dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësinë Roshnik.	Pajisja me sinjalistikën dhe masat e sigurisë për gjatë itinerareve peizazhistike dhe kulturore Krijimi i pikave të shitjes së produkteve artizanale Evidentimi i itinerareve peizazhistike në Roshnik Krijimi i paketave turistike për promovimin e ekoturizmit Pajisja me sinjalistikën e nevojshme dhe masat mbrojtëse për turistët Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane	Për t'u llogaritur Për t'u llogaritur Për t'u llogaritur Për t'u llogaritur Për t'u llogaritur Për t'u llogaritur	Bashkia Berat Bashkia Berat Bashkia Berat Bashkia Berat, Ministria e Kulturës Bashkia Berat Bashkia Berat	Ministria e Kulturës Donatorë të ndryshëm Donatorë të ndryshëm Donatorë të ndryshëm Donatorë të ndryshëm Donatorë të ndryshëm	Përmirësimi i infrastrukturës Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregtar Krijimi i itinerareve të reja Promovimi i ekoturizmit Rritja e sigurisë së turistëve Gjendje e përmirësuar e shtatit të lumit Osum dhe zonave ripariane		
O2P5: Mbrojtja e sistemit urban nga përbytyet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor.	Menaxhimi i integruar i ujërave të Lumit Osum	Për tu përlogaritur	Bashkia Berat/bashkitë fqinje	Donatorë të ndryshëm (USAID, Banka Botërore)	Përmirësimi i cilësisë së ujërave të lumit Osum dhe brigjeve të tij		
O2P6: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ si dhe ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.	Përmirësimin dhe shkrimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Berat Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të	Për t'u llogaritur Për tu përlogaritur pas hartimit të	FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimeve FZHR, Bashkia dhe ndërmarrja	FSHZH, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, donatorë të ndryshëm FSHZH, donatorë të ndryshëm	Popullsi e mbuluar me shërbim 24/24 orë Popullsi e mbuluar me		





urbane dhe ndërtimi i një landfilli rajonal për menaxhimin e mbejeve.	Ndërtimi i një stacioni riciklimi	Për tu llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Reduktim i mbeturinave	I	II	III	IV
	Fushata ndërgjegjësimi për ndajen e mbeturinave në burim	Për tu llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Reduktim i mbeturinave				
	Ndërtim te një stacioni transferimi për mbejet urbane	Për tu llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Mjedisit, Donatorë të ndryshëm	Reduktim i mbeturinave				
<b>Objektivi Strategjik 3: Fuqizimi i aksesit brenda territorit të bashkisë dhe ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin.</b>									
O3P1: Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat në funksion të trafikut ndërgjyqetës. O3P2: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njëjste administrative nga/në bërthamën urbane (qyteti i Beratit) si dhe mes tyre e me bashkitë kufitare.	Ndërtimi i Unazës (Bypass) të qytetit të Beratit	Për tu llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Bypass i qytetit i përfunduar				
	Rikonstrukcion i segmentit rrugor Shish-Ura e Re-Shkolla Industriale.	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i bulevardit "Republika".	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i rrugës "Santa Lucie Filippine"	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i segmentit rrugor që nis nga stadiumi i vjetër-stadiumi "Tomor" dhe sheshit përpara stadiumit	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i rrugës "Muzak Topia"	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i rrugës "Gaqi Gjika"	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				
	Rikonstrukcion i rrugës në zonën e quajtur "Kodra e	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akseve rrugore				



	rrugor qendër e qytetit-Uzrovë		Berat	të ndryshëm	mirë fizike e akteve rrugore				
	Krijimi i itinerareve të biçikletave për lidhjen e qendrave urbane dhe rurale	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia Berat	FSHZH dhe donator të ndryshëm	Gjendje e mirë fizike e akteve rrugore				
O3P3: Menaxhimi i trafikut lokal përmes sistemit të informacionit dhe ndërhyrjeve pikësorë në infrastrukturë.	Krijimi i sinjalistikës rrugore pajisja me semaforë e kryqëzimeve	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat, FZHR, FSHZH	Donatorë të ndryshëm	Ujta e numrit të aksidenteve				
	Projekti për përmirësimin e kryqëzimeve rrugore në Bashkinë Berat	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat, FZHR, FSHZH	Donatorë të ndryshëm	Ujta e numrit të aksidenteve				
O3P4: Hartimi dhe zbatimi i një plani sektorial të transportit publik të integruar për bashkinë Berat.	Shtimi i zonave të parkimeve publike në qytetin e Beratit	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat FZHR	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Moszhënia e hapësirave të lira publike				
	Hartimi i planit sektorial të integruar të transportit	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat FZHR	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Zbatimi i planit sektorial të integruar të transportit				
<b>Objektivi Strategjik 4: Zhvillimi i sektorit të bujqësisë e blegtorisë në funksion të zhvillimit rural dhe ujtes së papunësisë.</b>									
O4P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe ujtes në territorin e Bashkisë Berat si dhe bashkërendim i punës me institucionet qendrore për sistemin e ujërave të larta të stuhive.	Rehabilitimi i stacionit të elektropompave	Për tu llogaritur pas hartimit të projektit teknik	Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ujtja e zonave problematike				IV
	Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujtes, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta.	Për tu llogaritur pas hartimit të projektit teknik	Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ujtja e zonave problematike				
	Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Osun	Për tu llogaritur pas hartimit të projektit teknik	Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Shmangia e përmblyetjeve				
	Inventarizimi i infrastrukturës ekzistuese	Për tu llogaritur	Bashkia Berat, Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit					
	Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese	Për tu llogaritur	Bashkia Berat, Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Përmirësimi i infrastrukturës				



				Bujqësisë	Zhvillimit	Shmangia e përmblyjeve			
	Mbrojja nga përmblytjet në zone Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse	Për tu llogaritur pas hartimit të projektit teknik	Ministria e Bujqësisë	Banka Botërore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Shmangia e përmblyjeve				
O4P2: Zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në mbrojtje të tokës bujqësore zhvillimet urbane.	Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja	Për t'u llogaritur	USAID	Ministria e Zhvillimit Urban	Toka bujqësore e konsoliduar				
O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, konsolidime kulturore, kooperativa bujqësore, etj.) përmes PPP-ve dhe rritjes së kapaciteteve fermerëve.	Përhapja e modelit të hartuar në projektin pilot në njësi të ngjashme strukturore	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Ministria e Zhvillimit Urban	Përcaktimi i zonave të tjera për menaxhimin e tokës				
	Mbyllja e procesit të inventarizimit dhe hartimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Krijimi i një baze të dhënash GIS për pronat publike				
	Përfundimi i procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike, subjekt transferimi në Bashki	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Regjistrimi i pronave publike pranë ZRPP				
	Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore	Për t'u llogaritur	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	FSHZH	Projektet për rehabilitimin e aseteve publike gati për t'u zbatuar				
	Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat e përshatshme	Për t'u llogaritur	FZHR, Bashkia	FSHZH, Donatorë të ndryshëm	Ndërtimi i tregjeve dhe pikave të grumbullimit në zonat e përcaktuara tek pollet e zhvillimit				
O4P4: Mbarëshkrimi i territoreve bujqësore dhe kullotave në	Hartimi i politikave për kultivimin e tokave bujqësore dhe kullotave nëpërmjet	Për t'u llogaritur	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	FSHZH	Projektet				

funksion të fuqizimit të zinxhirit të prodhimit në blegtori e bujqësi.	subvencione	Administrimit të Ujërave	I	II	III	IV
Objekti Strategjik 5: Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit arsimit dhe shëndetësor, si dhe zbatim i politikave gjatëpërditëse të zbatues së pabarazive sociale dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore						
O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.	Përmirësimi i infrastrukturës së spitalit rajonal dhe plotësimi i nevojave i nevojave sanitare	Ministria e Shëndetësisë	FSZH, Donatorë të ndryshëm	Për t'u llogaritur	Spitali rajonal ka kapacitetet e nevojshme dhe infrastrukturën e duhur për ofrimin e shërbimit	
O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ambulancave në njësitë administrative të Bashkisë Berat.	Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në njësitë administrative Otllak, Sinjë, Roshnik dhe Velabisht	Bashkia Berat	Ministria e Shëndetësisë	Për t'u llogaritur	Infrastrukturat e qendrave shëndetësore në kushte optimale	
O5P3: Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë, axitje për arsimin profesional dhe universitar.	Ndërtimi i një shkolle profesionale në qytetin e Beratit	Bashkia Berat	Ministria e Arsimit, Donatorë të ndryshëm	Për t'u llogaritur	Shkolla profesionale qytetin e Beratit	
O5P4: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopësive, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në njësitë administrative të Bashkisë Berat.	Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare në fshatin Veternik, Velabisht.	Bashkia Berat	Ministria e Arsimit, Donatorë të ndryshëm	Për t'u llogaritur	Shkolla brenda standardeve të projektimit	
	Rikonstrukcion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Velabisht.	Bashkia Berat	Ministria e Arsimit, Donatorë të ndryshëm	Për t'u llogaritur	Shkolla brenda standardeve të projektimit	
	Rikonstrukcion i shkollës së mesme dhe ndërtimi i ambienteve sportive në fshatin Sinjë, Sinjë.	Bashkia Berat	Ministria e Arsimit, Donatorë të ndryshëm	Për t'u llogaritur pas hartimit të Fish-Projektit	Shkolla brenda standardeve të projektimit	
O5P5: Zbatim	Hartimi i programit vendor	Bashkia Berat	Donatorë të	Për tu llogaritur	Banesa	

programit lokal për strehimin social	për strehimin social në Bashkinë Berat	Zbatimi i programit për strehimin social	Për tu llogaritur	Bashkia Berat	ndryshëm	social	I	II	III	IV
<p><b>Objekti i Strategjik 6:</b> Mbështetja e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxirja e sipërmarrësve të rinj, me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkurse në rajon.</p> <p><b>O6P1:</b> Mbështetje, marketing, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.</p>	Organizimi i Panairëve vjetore të produkteve vendase në Bashkinë Berat	Për t'u llogaritur	Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Buxheti i Bashkisë	2 Panairë vjetore të realizuara					
	Ndërtimi i tregjeve ushqimore në funksion të zhvillimit të sektorit të bujqësisë (në Otlak dhe Velabisht)	Për t'u llogaritur	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, FZhr, FShZh, Donatorë	Ndërtimi dhe funksionimi i dy tregjeve					
	Ndërtimi i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Berat dhe zonave pranë.	Për t'u llogaritur	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, FZhr, FShZh, Donatorë	Ndërtimi dhe funksionimi i tregut					
<p><b>O6P2:</b> Nxirje e sipërmarrësve të rinj për jetësimin e projekteve me ide inovatore për tregun aktual.</p>	Hartimi i Strategjisë së Marketimit të Produkteve vendase	Për t'u llogaritur	Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Buxheti i Bashkisë	Dokumenti i Strategjisë i Hartuar					
	Hartimi i politikave për thithjen e biznesit të ri novator në bashkinë e Beratit me anë të lehtësimit të taksave dhe subvencioneve	Për t'u llogaritur	Bashkia Berat, Ministria e Ekonomisë, Turizmit,	Donatorë ndryshëm	Dokumenti i hartuar					

Tregisë dhe  
Sipërmarrjes



## 4.2 Sistemet e territorit

Një nga ndikimet kryesore që strategjia e territorit, plani dhe projektet strategjike sjellin në territor, është ndryshimi i mundshëm i sistemeve të territorit. Nëse në nivel planesh territoriale përgjithësisht sigurohemi që të krijojmë përdorime toke të përputhshme me njëra-tjetrën, në nivel strategjik duhet të kuptohet edhe mundësia e ndryshimit të sistemeve territoriale (bujqësore, natyrore, ujërat, urbane dhe infrastrukturore), për dy arsye: 1) për të kuptuar efektet afatgjata të strategjisë dhe planit në çdo aspekt (territorial, mjedisor, social dhe ekonomik); 2) për të kuptuar, parashikuar dhe rregulluar efektet e sektorëve të ndryshëm mbi njëri-tjetrin dhe si rezultat për të marrë masa ligjore e procedurale për zbutjen e efekteve, ose për realizimin e tyre.

Si rezultat i zbatimit të vizionit të zhvillimit dhe projekteve strategjike në territor, pritet që të ndodhin edhe ndryshime të mundshme të sistemeve territoriale, pra konvertime të tokës nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime/transformime mund të ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave si dhe përmes disa procedurave ligjore të vendosura në legjisllacionin sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat, etj.). Një ide paraprake të transformimeve të mundshme mund ta marrim që me hartëzimin e vizionit territorial të zhvillimit, duke e krahasuar atë me shtrirjen e sistemeve aktuale të territorit. Sigurisht, kjo është një ide paraprake dhe orientuese, por ende asnjë vendim transformimi nuk është marrë, sepse për këtë nevojitet të përgatitet më parë plani i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave.

Ndryshimet që kanë pësuar sistemet e territorit në Bashkisë Berat kanë ardhur si pasojë e objektivave strategjike të propozuara. Sipas VKM nr. 671/ 2015, sistemet mbeten të njëjta: sistemi natyror (N), sistemi urban (UB), sistemi bujqësor (B), sistemi infrastrukturor (IN) dhe sistemi ujor (U), por disa territore pësojnë ndryshime bazuar në tendencat e zhvillimit që propozohen në këtë dokument politikash të zhvillimit të territorit. Ashtu si u theksua më lart ndryshimet e propozuara në këtë fazë janë orientuese. Ndryshimet e mundshme që do të pësojnë sistemet e territorit në Bashkinë Berat do të rishikohen në mënyrë të detajuar në fazën e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Sipërfaqja totale e Bashkisë Berat është 380 km<sup>2</sup>, nga e cila 170 km<sup>2</sup> është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 180 km<sup>2</sup> është tokë natyrore (pyje, kullota). Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër i pasur me ujëra nëntokësor e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore është 9 km<sup>2</sup>.


Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km<sup>2</sup>. Sipërfaqja që zënë shërbimet është 0.07 km<sup>2</sup>. Institucionet, shëndetësia dhe arsimi zënë një sipërfaqe prej 0.21 km<sup>2</sup>.

Banimi shtrihet në një sipërfaqe të vogël, krahasuar me tokën bujqësore dhe natyrore, 4.63 km<sup>2</sup>. Qyteti i Beratit karakterizohet nga zona urbane të konsoliduara. Në njësitë e tjera zonat e banuara janë të vendosura përgjatë akseve rrugore. Në total bashkia Berat ka 812 km rrugë lineare.

Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum do të sjellë pyllëzimin e zonë përreth duke kaluar në sistem natyror nëpërmjet krijimit të brezave mbrojtës përgjatë brigjeve. Shtrati i lumit ka pësuar ndryshime pothuajse përgjatë gjithë shtratit të tij. Një pjesë e shtratit është kthyer në tokë bujqësore. Shumë banesa janë ndërtuar pranë shtratit dhe janë të rrezikuara ndaj përmbytjeve. Rehabilitimi i shtratit do të sjellë transformim të sistemit aktual duke e kthyer në sistem natyror, dhe në respektim të standardeve të planifikimit.

Densifikimi i zonës urbane pranë “Uznovës” do të sjellë ndryshimin e sistemit natyror në atë urban.

Figura 65. Propozimet në sistemet e territorit



Burimi: Bashkia Berat dhe Co-PLAN, 2015

## V. Projektet prioritare të zhvillimit

### 1. Rikonstrukcion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit


Titulli i projektit	1. Rikonstrukcion i segmenteve rrugore në qytetin e Beratit
Konteksti i projektit	<p>Disa nga akset kryesore të cilat mundësojnë lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme të qytetit të Beratit, kanë shfaqur shenja amortizimi nga përdorimi ndër vite. Duke vështirësuar kalimin e qytetarëve me automjete. Si dhe kalimin e këmbësorëve nga dëmtimi ose mungesa e trotuarëve në disa segmente përgjatë këtyre akseve. Në total janë 8.7 km rrugë të amortizuara të cilat kanë nevojë për ndërhyrje.</p> <p>Po ashtu, cilësia e ajrit është një problem për qytetarët që banojnë ose ushtrojnë aktivitetin ekonomik pranë këtyre akseve rrugore.</p>
Përshkrimi i projektit	<p>Rikonstrukcion i akseve rrugore të amortizuara në qytetin e Beratit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rikonstrukcion i bulevardit "Republika".</li> <li>2. Rikonstrukcion i segmentit rrugor që nis nga stadiumi i vjetër-stadiumi "Tomor" dhe sheshit përpara stadiumit.</li> <li>3. Rikonstrukcion i segmentit rrugor qëndër e qytetit-Uznovë.</li> <li>4. Rikonstrukcion i rrugës "Santa Lucie Filipine".</li> <li>5. Rikonstrukcion i sheshit "Akhensia" (Sheshi i harmonisë Fetare).</li> <li>6. Rikonstrukcion i rrugës "Muzak Topia".</li> <li>7. Rikonstrukcion i rrugës "Gaqi Gjika".</li> <li>8. Rikonstrukcion i rrugës në zonën e quajtur "Kodra e Sulmit".</li> <li>9. Rikonstrukcion i rrugës "Mihal Komneno".</li> <li>10. Rikonstrukcion i segmentit rrugor Shish-Ura e Re-Shkolla Industriale.</li> <li>11. Rreth rrotullimi në segmentin rrugor "Kinoklubi-Ura e Goricës".</li> </ol>
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat, FZHR.
Rezultati i pritshëm	<p>Lehtësimi i trafikut automobilistik.</p> <p>Rritja e aksesit.</p> <p>Përmirësimi i cilësisë së ajrit.</p> <p>Rritja e mirëqënies social-ekonomike.</p>
Objektivi	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në qytetin e Beratit.
Veprimet strategjike	<p>Studimi dhe hartimi i projekteve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në qytet.</p> <p>Përfshirja dhe bashkëpunimi i komunitetit dhe grupit të biznesit që preken drejtëpërdrejt nga këto projekte.</p> <p>Kryerja e proceseve prokuruese dhe/ose aplikimi për fonde, sipas rastit.</p> <p>Lobimi për fonde.</p> <p>Zbatimi i projekteve.</p>

Rreziqet	Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Berat dhe grupeve të interesuara.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-Afatgjatë
Kosto financiare	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm





1. Bulevardi Republika	919 m
2. Stadiumi i Vjeter- Stadiumi Tomorri	558 m
3. Qender Berat- Uznovë (nga ura e kembësorëve)	3145 m
4. Rruga "Santa Luzie Filipine"	1039 m
5. Sheshi "Akhensia" (Sheshi i Harmonise Fetare)	
6. Rruga "Muzak Topia"	598 m
7. Rruga "Gaqi Gjika"	735 m
8. Rruga në zonën "Kodra e Sulmit"	
9. Rruga "Mihal Komneno"	941 m
10. Segmenti Shishe- Ura e Re- Shkolla Industriale	
11. Segmenti "Kinoklubi- Ura e Gorices"	1329 m
<b>Totale: 8706 m</b>	



## 2. Rikonstrukcion i segmenteve rrugore në njësitë e Bashkisë Berat


<b>Titulli i projektit</b>	<b>Rikonstrukcion i segmenteve rrugore në njësitë e bashkisë Berat</b>
<b>Konteksti i projektit</b>	Në disa fshatra të njësisë Sinjë e Velabisht është evidentuar nevoja për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore. Disa nga segmentet rrugore të cilat lidhin fshatrat ndërmjet tyre janë amortizuar për shkak të përdorimit ndër vite. Duke vështirësuar aksesin ndaj shërbimeve sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Gjatësia në total e segmenteve rrugore që propozohet ndërhyrja është 28.2 km.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Rikonstrukcioni i rrugëve lidhëse ndërmjet fshatrave në njësitë Velabisht e Sinjë: 1. Rikonstrukcion i rrugës Berat-Drobonik (Njësia Velabisht) 2. Rikonstrukcion i segmentit rrugor Bilçe- Malinat (Njësia Velabisht) 3. Rikonstrukcion i rrugës Sinjë-Mbjeshovë (Njësia Sinjë) 4. Rikonstrukcion i rrugës në fshatin Mbolan (Njësia Sinjë) 5. Rikonstrukcion i rrugës në fshatin Kamçisht (Njësia Sinjë) 6. Ndërtim i mureve mbajtëse të rrugës Berat-Bilçe
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet njësive jo urbane me qytetin e Beratit</li> <li>- Rritja e aksesit ndaj shërbimeve që ofrohen në qytetin e Beratit</li> <li>- Rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike për banorët në zonat jo urbane</li> </ul>
<b>Objektivi</b>	Të përmirësohet lidhja infrastrukturore ndërmjet njësive urbane dhe rurale.
<b>Veprimet strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe rakordimi me planet kombëtare të transportit dhe projektet e qeverisë qendrore:</li> <li>- Hartimi i projektit</li> <li>- Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde</li> <li>- Përfshirja dhe bashkëpunimi me grupet e interesit ( Biznesi, komuniteti etj)</li> <li>- Hartimi i projekteve teknike dhe kryerja e procesit të prokurimit, ose aplikimi për fonde sipas rastit</li> <li>- Zbatimi i projekteve.</li> </ul>
<b>Rreziqet</b>	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese, çon në mos përmbushjen e objektivave.

Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-afatgjatë
Kosto financiare	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm



1. Rruga Berat- Drobënik (Njësia Velabisht) 5705 m
2. Rruga Bilçe- Malinat (Njësia Velabisht) 13600 m
3. Rruga Sinjë- Mbjeshovë (Njësia Sinjë) 3526 m
4. Rrugë në fshatit Mbolan (Njësia Sinjë) 1809 m
5. Rrugë në fshatit Kamçisht (Njësia Sinjë) 438 m
6. Ndërrimi i mureve mbajtëse të rrugës Berat- Bilçe 3144 m

Total: 28.2 km (28222m)



1

2

3

4

5

6





### 3.Unaza (*By-Pass-i*) i Qytetit të Beratit

Titulli i projektit	Ndërtimi i Unazës ( <i>ByPass-it</i> ) të qytetit të Beratit
Konteksti i projektit	Plani i Përgjithshëm Vendor i hartuar në vitin 2010 parashikon një unazë në kodrat veriore të qytetit të Beratit me një gjatësi afërsisht prej 8 km. Në vitin 2012, Këshilli Bashkiak i Beratit aprovoi një projekt-ide të <i>Bypass-it</i> të propozuar nga Infra Trans Projekt Ltd, Ark-Tek sh.p.k. dhe shoqërisë spanjolle GPO. Projekti i ri parashikon një tunel 1.2 km nën kodrën e Goricës dhe një urë lidhëse me lagjen e Uznovës, me një gjatësi totale prej 4.4 km.
Përshkrimi i projektit	Ndërtimi i unazës të qytetit të Beratit të bazuar nga plani i miratuar i këshillit bashkiak. Përfshirja e projektit ekzistues në planin e ri të përgjithshëm vendor si dhe bashkërendimin me projektin fitues të ishullit të Beratit.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Transportit, Sektori Privat
Rezultati i pritshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i nivelit të ndotjes</li> <li>- Rritje e vizitorëve nga lehtësimi në qarkullim</li> </ul>
Objektivi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ulja e qarkullimit automobilistik në zonat qendrore urbane dhe shmangia e bllokimit të trafikut</li> <li>- Parandalimi i dëmtimit të infrastrukturës që shkakton rënie dherash nga kodra e kalasë</li> </ul>
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i miratimit nga UNESCO për pjesën e projektit që kalon në zonën buferike të lagjes historike të Goricës</li> <li>- Rivlerësimi dhe përfshirja e projektit në planin e përgjithshëm vendor</li> <li>- Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde;</li> </ul>
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikimi i projektit dhe rritje e kostos (zgjatim i urës) në kuadër të ndryshimeve të planit për rehabilitimin e shtratit të Osumit (Projekti i ishullit të Beratit)</li> <li>- Rreziqe në zhvendosje të dherave të kodrës të mbrojtur të Goricës gjatë punimeve</li> </ul>
Faza e projektit	Projekt-ide i miratuar
Vlerësimi i prioriteteve	Afat-gjatë
Kosto financiare	Vlera e investimit është 27.8 milionë euro

Burimi i mundshëm kryesor i financimit	FSHZH, Bashkia Berat
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FZHR, donatorë të ndryshëm

- 1. Bypass i Beratit
- 2. Pjesa qe do te realizohet me tunel




#### 4.Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum

Titulli i projektit	Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum
Konteksti i projektit	Dëmtime të shtratit, brigjeve dhe zonës ripariane, të shkaktuara nga proceset gjeologjike e gërryese të vetë lumit, si dhe ato nga ndërhyrja e njeriut në territor nëpërmjet bujqësisë e urbanizimit. janë vënë re përgjatë gjithë rrjedhës së lumit. Ajo ka pësuar dëmtime të theksuara duke u ngushtuar, me mungesa të bimësisë së nevojshme mbrojtëse, ose e kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.
Përshkrimi i projektit	Studimi dhe zbatimi i punimeve të rigjenerimit të shtratit të lumit, brigjeve të tij dhe zonës ripariane për të parandaluar humbjen e tokës dhe ndotjen e ujërave të lumit dhe akuifereve. Projekti synon ndërhyrjen përgjatë gjithë shtratit të lumit Osum që kalon në territorin e Bashkisë Berat. Duke e ndarë në tre segmente të kryesore sipas karakterit të tokës. <b>Segmenti i parë</b> , nis në pjesën veriore të Bashkisë Berat dhe përfundon në kufirin e zonës industriale. Ky segment shtrihet përgjatë tokave bujqësore. <b>Segmenti i dytë</b> , nis nga zona industriale (ish kombianti) dhe përfundon në daljen e qytetit, Uznovë. Ky segment shtrihet përgjatë zonës urbane e industriale. <b>Segmenti i tretë</b> , nis nga Uznova e përfundon në kufirin e Bashkisë Berat, në juglindje. Ky segment shtrihet përgjatë zonës natyrore dhe bujqësore.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit, komuniteti
Rezultati i pritshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i peizazhit të lumit</li> <li>- Parandalimi i humbjes së tokës bujqësorë dhe natyrore</li> <li>- Minimizimi i shkëmbimit të ndotjes ujore nga tokat bujqësore dhe zonat urbane për tek trupi ujqor</li> <li>- Territoret urbane përgjatë lumit do të mbrohen nga përmbytja</li> <li>- Peizazhi i waterfront-it do të përmirësohet</li> </ul>
Objektivi	Ruajtja e tokës (bujqësore ose natyrore) nga prurjet ujore si dhe përmirësimi i vlerave mjedisore të lumit Osum
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i koncept-idesë dhe lobimi për fonde</li> <li>- Hartimi i projektit dhe aplikimi për fonde, sipas rastit</li> <li>- Kryerja e punimeve për rehabilitimin e zonës ripariane dhe sistemimin e e brigjeve</li> <li>- Rehabilitimi i pikave të ndërhyjeve dëmtuese të njeriut dhe eliminimi i burimeve ndotëse përgjatë segmentit ku zbatohet projekti</li> </ul>



Rreziqet	Cështja e konfliktit të pronësisë së brigjeve të lumit mund të rritë koston e projektit dhe të zgjatë kohën e zbatimit të tij.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër-afatmesëm
Kosto e projektit	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Banka Botërore, FSHZH
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Ministria e Bujqësisë, donatorë të ndryshëm



1



2



3



## 5. Rikonstrukcion dhe ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe ujësjellësit



<b>Titulli i projektit</b>	<b>Rikonstrukcion dhe ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe ujësjellësit</b>
<b>Konteksti i projektit</b>	Bashkia Berat ofron aktualisht shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve në qytetin e Beratit dhe pjesërisht në njësinë Otlak. Duke lënë jashtë shërbimit njësitë Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, në të cilat situata e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza paraqitet e vështirë.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Rikonstrukcioni i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në qytetin e Beratit dhe njësinë Otlak dhe ndërtimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në njësitë Velabisht e Sinjë. <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të larta, faza e III segmenti Burdulliaslumi Osum, Berat.</li> <li>2. Rikonstrukcioni i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin, Berat.</li> <li>3. Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Velabisht, (lagjja Pavarësia dhe lagjja Partizani), Velabisht.</li> <li>4. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Duhanas, Velabisht.</li> <li>5. Ndërtim i ujësjellësit në lagjen Prokopi, fshati Paftal, Sinjë.</li> <li>6. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Mbreshtan, Sinjë.</li> <li>7. Studim dhe hapje pusi për ujë të pijshëm në fshatin Mbreshtan, Sinjë.</li> <li>8. Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Lapardha, Otlak.</li> </ol>
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, Komuniteti, sektori privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	- Përdorimi i burimeve ujore si potencial për zhvillimin turistik - Rritja e mirëqënies sociale
<b>Objektivi</b>	Sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemin e largimit të ujërave të zeza për gjithë territorin e bashkisë Berat.
<b>Veprimet strategjike</b>	- Hartimi i studimit dhe projekteve për ofrimin e këtij shërbimi në zonat më problematike
<b>Rreziqet</b>	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese.
<b>Faza e projektit</b>	Koncept-projekt
<b>Vlerësimi i prioriteteve</b>	Afatmesëm-Afatgjatë
<b>Kosto e projektit</b>	Pas studimit të parafizibilitetit
<b>Burimi i mundshëm</b>	FZHR, bashkia dhe ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimeve

kryesor i financimit	
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH. donatorë të ndryshëm





1. Kanalizime ujëra të larra, faza III segmenti Burdullas- lumi Osurn, Berat
2. Kanalizime ujëra të zeza, nga kalaja në pikën e lidhjes me qytetin Berat
3. Kanalizime ujëra të zeza, fshat Velabisht, luge Pavarësis dhe Parëzani
4. Kanalizime ujëra të zeza, fshat Duhanas (Njësia Velabisht)
5. Ndërtim Ujesjellësi, fshat Pafjal, luga Prokopi (Njësia Sinjë)
6. Kanalizime ujëra të zeza, fshat Mbreshtan (Njësia Sinjë)
7. Studim dhe hapje pusi, fshat Mbreshtan (Njësia Sinjë)
8. Kanalizime ujëra të zeza, fshat Lapardha (Njësia Ollak)



## 6. Rikonstrukcion i Stadiumit të Vjetër, Berat

<b>Titulli i projektit</b>	Rikonstrukcion i Stadiumit të Vjetër, Berat
<b>Konteksti i projektit</b>	Një prej stadioneve më të rëndësishëm të qytetit të Beratit është ndërtuar para viteve 90'. Gjatë 25 viteve të fundit, ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve fizike kanë qenë të pakta. Stadiumi i vjetër tashmë e ka të nevojshëm rikonstrukcionin, për shkak të shkallës së lartë të amortizimit.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Përgatitja e projektit arkitektonik e konstruktiv dhe kryerja e punimeve për rikonstrukcionin e stadiumit të vjetër në qytetin e Beratit.
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi i të rinjve në aktivitete sportive</li> <li>- Realizimi i ndeshjeve të kampionateve në nivel kombëtar</li> </ul>
<b>Objektivi</b>	Riaktivizimi i një prej hapësirave më të rëndësishme sportive.
<b>Veprimet strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimi dhe hartimi i projektit</li> <li>- Aplikimi për fonde tek FZHR ose institucione të tjera</li> <li>- Zbatimi i projektit të rikonstrukcionit</li> </ul>
<b>Rreziqet</b>	Shtyrja për një afat të papërcaktuar nga autoritetet institucionale zbatuese nëse kostot do të jenë tepër të larta.
<b>Faza e projektit</b>	Koncept-projekt
<b>Vlerësimi i prioriteteve</b>	Afatmesëm-afatgjatë
<b>Kostot financiare</b>	Pas hartimit të koncept-idesë.
<b>Burimi i mundshëm kryesor i financimit</b>	FZHR, Bashkia
<b>Burimi i mundshëm dytësor i financimit</b>	Bashkia, donatorë të ndryshëm



## 7. Rikonstrukcion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit.

Titulli i projektit	Rikonstrukcion i fasadave të godinave të vendosura në hyrje të qytetit.
Konteksti i projektit	Ndërtimi i godinave në hyrje të qytetit të Beratit është realizuar para viteve 90'. Në këto godina janë evidentuar shenja amortizimi si pasojë e mosndërhyrjeve në përmirësimin e kushteve teknike.
Përshkrimi i projektit	Rehabilitimin e godinave ekzistuese në hyrje të qytetit dhe integrimi me qytetin historik, sipas një projekti të dizajnit urban. Bashkia do të bashkëpunojnë me banorët për t'i angazhuar në hartimin e bashkëfinancimit të projektit që jo vetëm i shton vlerë qytetit, por është edhe proces i zakonshëm i mirëmbajtjes së banesave nga banorët. Përmes bashkëfinancimit mund të synohet që projekti të hyjë edhe në rritjen e eficiencës energjitike të ndërtesave të banimit.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
Rezultati i pritshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i imazhit dhe hapësirës publike të qytetit.</li> <li>- Rritja e mirëqënies së banorëve që preken drejtëpërdrejt nga ky projekt.</li> </ul>
Objektivi	Valorizimi arkitektonik i hapësirës publike përmes rikonstrukcionit teknik të fasadave të godinave të banimit.
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimi i zonës së qytetit duke marrë në konsideratë moshën e objekteve dhe praninë e elementeve arkitektonikë dhe të eficiencës energjitike.</li> <li>- Hartimi i projektit arkitektonik dhe konstruktiv</li> <li>- Aplikimi për fonde dhe krijimi i bordit të banorëve dhe ngritja e fondit të bashkëfinancimit</li> <li>- Zbatimi i projektit</li> </ul>
Rreziqet	Mungesa e bashkëpunimit të banorëve të prekur drejtëpërsëdrejti nga ky projekt me Bashkinë Berat dhe mungesa e gatishmërisë për të bashkëfinancuar.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-afatgjatë
Kostot e projektit	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia dhe banorët
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FZHR, donatorë të ndryshëm





## 8. Rikonstrukcion i hapësirave urbane në lagjen “Murat Çelebiu”

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Rikonstrukcion i hapësirave urbane në lagjen “Murat Çelebiu”</b>
<b>Konteksti i projektit</b>	Lagjia Murat Çelebiu pozicionohet në pjesën veri perëndimore të qytetit të Beratit dhe karakterizohet nga banesa shumëkatëshe të ndërtuara para viteve 90'. Në këtë zonë mungojnë hapësirat urbane dhe rekreative.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Ndërtimi i hapësirave urbane ndërmjet zonave të banimit.
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, Komuniteti, Sektori Privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i imazhit të qytetit.</li> <li>- Rritja e mirëqenies së banorëve që preken drejtëpërsëdrejti nga ky projekt.</li> </ul>
<b>Objektivi</b>	Përmirësimi i nivelit të jetesës të banorëve në qytetin e Beratit.
<b>Veprimet strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimi dhe hartimi i projektit duke marrë në konsideratë objektet e ndërtuara në këtë zonë.</li> <li>- Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde;</li> </ul>
<b>Rreziqet</b>	Mungesa e bashkëpunimit të personave që preken drejtëpërsëdrejti nga ky projekt me Bashkinë Berat.
<b>Faza e projektit</b>	Koncept-projekt
<b>Vlerësimi i prioriteteve</b>	Afatmesëm-afatgjatë
<b>Kostot e projektit</b>	Për t'u llogaritur
<b>Burimi i mundshëm kryesor i financimit</b>	Bashkia Berat
<b>Burimi i mundshëm dytësor i financimit</b>	Donatorë të ndryshëm



### 9.Restaurim i seksioneve perëndimore dhe jugore (të mureve të kalasë)

Titulli i projektit	Rishikim i seksioneve perëndimore dhe pikës jugore (Tabja) të mureve të kalasë
Konteksti i projektit	Infrastruktura e kalasë së Beratit ka marrë vëmendje të veçantë që nga njohja si Trashëgimi Kulturor Botëror në vitin 2008. Restaurimi i fundit të infrastrukturës së mureve ka qenë midis kullave 7 dhe 8 në vitin 2015, i financuar nga Bashkia e Beratit. Zona të tjera të murit kanë nevojë për restaurim në mënyrë që të parandalohet degradimi dhe të shtohet vlera kulturore e kalasë.
Përshkrimi i projektit	1-Restaurimi i seksioneve të mureve perëndimore 2-Restaurimi i pikës jugore "Tabja" të kalasë.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës, UNESCO, Komiteti Veprues i Zhvillimit Turistik të Beratit, Sektori Privat
Rezultati i pritshëm	- Përmirësimi i eksperiencës turistike promovon shtim të numrit të turistëve
Objektivi	- Parandalimi i degradimit të mëtejshëm të mureve të kalasë nga ndikimet atmosferike - Rritja e vlerave turistike të objektit infrastrukturor - Aprovim nga raporti për statusin e konservimit të UNESCOs
Veprimet strategjike	- Përcaktimi i pjesëve të murit në nevojë për punime - Hartimi i projektit - Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde;
Rreziqet	Mos vënia në prioritet të projektit nga organet vendimmarrëse kundrejt ndonjë objekti në rrezik
Faza e projektit	Koncept-projekt 1-Restaurimi i seksioneve të mureve perëndimore Studim Fizibiliteti 2-Restaurimi i pikës jugore "Tabja" të kalasë.
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-Afatgjatë
Kosto financiare	20 milion
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Berat
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm





### 10. Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë.

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Sistemimi i parkut me pisha në faqen lindore të kalasë.</b>
<b>Konteksti i projektit</b>	Parku me pisha në anën lindore të kalasë. i shtrirë në një sipërfaqe prej 8.6 ha, është pjesë e zonës së mbrojtjes së kalasë. Në këtë pjesë të parkut është shumë i dukshëm erozioni si një nga format e degradimit të tokës.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Sistemimi me pisha i parkut në faqen lindore të Kalasë së Beratit. Mbjellja e pemëve dhe ndërtimi i infrastrukturave mbrojtëse nga rrëshqitja e tokës.
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, komuniteti, sektori privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i imazhit të zonës së mbrojtur.</li> <li>- Rritja e mirëqënies së banorëve të vendosur pranë kësaj zone.</li> </ul>
<b>Objektivi</b>	Ngadalësimi i procesit të erozionit dhe përmirësimi i imazhit të parkut.
<b>Veprimet strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimi teknik/peizazhistik i zonës së qytetit duke marrë në konsideratë monumentet e kulturës dhe zonën e mbrojtur</li> <li>- Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde:</li> <li>- Zbatimi i projektit.</li> </ul>
<b>Rreziqet</b>	
<b>Faza e projektit</b>	Koncept-projekt
<b>Vlerësimi i prioriteteve</b>	A fatshkurtër-A fatmesëm
<b>Kostot e projektit</b>	Për t'u llogaritur
<b>Burimi i mundshëm kryesor i financimit</b>	Bashkia
<b>Burimi i mundshëm dytësor i financimit</b>	Ministria e Mjedisit dhe donatorë të ndryshëm



**11.Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes “Mangalem” (16 banesa)**

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Restaurim dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të lagjes “Mangalem” (16 banesa)</b>
<b>Konteksti i projektit</b>	Lagjia Mangalem është pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore që prej vitit 2008. 16 shtëpi të vendosura në këtë lagje kanë për nevojë restaurim në mënyrë që të parandalohet degradimi dhe të shtohet vlera kulturore e lagjes.
<b>Përshkrimi i projektit</b>	Hartimi i projektit dhe më pas restaurimi i fasadave të 16 shtëpive të vendosura në këtë lagje.
<b>Partnerët</b>	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës, UNESCO, Komiteti Veprues i Zhvillimit Turistik të Beratit, Sektori Privat
<b>Rezultati i pritshëm</b>	- Përmirësimi i kushteve fizike të objekteve kulturore promovon shtim të numrit të turistëve
<b>Objektivi</b>	- Parandalimi i degradimit të mëtejshëm të shtëpive nga ndikimet atmosferike - Rritja e vlerave turistike të objekteve - Aprovim nga raporti për statusin e konservimit të UNESCOs
<b>Veprimet strategjike</b>	- Studimi dhe hartimi i projektit duke marrë në konsideratë objektet dhe monumentet e kulturës të mbrojtura - Hartimi/rishikimi i rregullores arkitektonike të zonës së mbrotjur - Aplikimi për fonde - Fushatë sensibilizimi për bashkëfinancim nga banorët e banesave përkatëse - Zbatimi i projektit dhe marketimi.
<b>Rreziqet</b>	Kosto e lartë e projektit dhe mungesa e vullnetit të banorëve për të bashkëpunuar.
<b>Faza e projektit</b>	Koncept-projekt
<b>Vlerësimi i prioriteteve</b>	Afatmesëm-A fatgjatë
<b>Kosto financiare</b>	Për t'u llogaritur
<b>Burimi i mundshëm kryesor i financimit</b>	Bashkia, FZHR
<b>Burimi i mundshëm dytësor i financimit</b>	Ministria e Kulturës dhe donatorë të ndryshëm.






## 12.Rikonstrukcion i shkollave në njësitë e Bashkisë Berat

Titulli i projektit	Rikonstrukcion i shkollave në njësitë e bashkisë Berat
Konteksti i projektit	Në njësinë Velabisht shërbejnë nëntë shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në njësisë Sinjë shërben një shkollë e mesme. Shkolla 9 vjeçare e fshatit Veternik dhe shkolla e mesme në fshatin Starovë janë në gjëndje të amortizuar dhe mungojnë hapësirat sportive. Gjithashtu dhe shkollat mesme në fshatin Sinjë është po në të njëjtën gjëndje. Dhe zhvillimi i aktivitetit mësimor është tepër i vështirë në këto kushte.
Përshkrimi i projektit	Rikonstrukcioni i institucioneve arsimore në njësitë Velabisht e Sinjë: 1-Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare në fshatin Veternik, Velabisht. 2- Rikonstrukcion i shkollës së mesme të bashkuar Starovë, Velabisht. 2-Rikonstrukcion i shkollës së mesme dhe ndërtimi i ambjenteve sportive në fshatin Sinjë, Sinjë.
Partnerët	Bashkia Berat, Komuniteti
Rezultati i pritshëm	-Rritja e performancës në procesin e mësimdhënies -Rritja e mirëqënies sociale
Objektivi	Të përmirësohen kushtet fizike të institucioneve arsimore dhe procesi i mësimdhënies.
Veprimet strategjike	- Të ndërtohen shkolla brenda standardeve të projektimit. - Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde.
Rreziqet	Klasifikimi si projekt jo prioritar nga autoritetet institucionale zbatuese.
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm-A fatgjatë
Kosto financiare	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Berat
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	Ministria e Arsimit, donatorë të ndryshëm



- 1 Shkolla 9 Vjeçare në fshatin Veternik, rrethi Velabisht
- 2 Shkolla e Meirne e Bashkuar Starovë, rrethi Velabisht
- 3 Shkolla e Meirne dhe ambiente sportive në fshatin Sinjë, rrethi Sinjë



1



2



3

### 13.Evidentimi dhe ndërtimi i itinerareve natyrore dhe kulturore

Titulli i projektit	Evidentimi dhe ndërtimi i itinerareve natyrore dhe kulturore
Konteksti i projektit	Berati pozicionohet në skaj të një aksi kombëtar dhe aktualisht jashtë korridorit jugor që lidh dy vende kryesore turistike të Gjirokastrës dhe Butrintit me aeroportin dhe qendrën e vendit. Megjithatë Berati gjendet në rrëzë të një zone të thellë malore dhe me vlera të mëdha mjedisore e kulturore. Qyteti i Beratit duhet të shërbejë si porta hyrëse dhe akomoduese e potencialit turistik për këtë zonë dhe në të njëjtën kohë si pikënisja e itinerareve të ecjes në natyrë për të gjithë zonën.
Përshkrimi i projektit	Krijimi i një itinerari peizazhi/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint që ta integrojë Beratin në paketat turistike për rajonin jugor. I cili i mundëson turistëve që me automjetet e tyre të vizitojnë tre qendra historike dhe njëkohësisht të mund të shijojnë peizazhin e bukur të rajonit jugor. Rruga e planifikuar Berat-Memaliaj e përforcon këtë qasje.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Komuniteti, Sektori Privat
Justifikimi i projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e të ardhurave gjeneruar nga shtimi i numrit të vizitorëve</li> <li>- Rritja e punësimit në sektorin e turizmit (punime artizanale/ shërbime)</li> <li>- Forcimi i sektorit të hotelerisë nëpërmjet përfshirjes në paketa turistike</li> </ul>
Objektivi	Rritja e vizitorëve turistikë në Bashkinë e Beratit si dhe aktivizimi i potencialeve turistike në të gjithë territorin e bashkisë.
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimi dhe evidentimi i rrjetit të itinerareve me potencialin më të madh turistik.</li> <li>- Promovimi i idesë dhe lobimi për fonde.</li> <li>- Përgatitja e projektit teknik dhe aplikimi për fonde dhe/ose prokurimi sipas rastit.</li> <li>- Realizimi i zhvillimit të rrjetit të itinerareve.</li> <li>- Konsultime me grupet e interesuara private për hartimin e paketave turistike, thithjen e turistëve dhe krijimin e aktiviteteve mbështetëse përgjatë itinerarit.</li> <li>- Përfshirja dhe bashkëpunimi me bashkitë fqinje.</li> </ul>
Rezultati i pritshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Integrimi i Beratit në rajonin jugor turistik</li> <li>- Shtimi i itinerareve për të krijuar ndërlidhje më të madhe me destinacione turistike të ndryshme</li> <li>- Evidentimi i Beratit si epiqendër rajonale e turizmit</li> </ul>



Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mos bashkëpunimi i bashkive fqinje nga perceptimi i projektit si konkurrencë</li> <li>- Mungesa e bashkëpunimit të komunitetit për krijimin e itinerareve natyrore</li> </ul>
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	A fatmesëm-afatgjatë
Kosto financiare	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Berat, FZHR
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm



Krijimi i një itinerari peisazhistik/ turistik kombëtar nëpërmjet Beratit për në Gjirokastrë e Butrint, që ta integrojë Beratun në paketën turistike për rajonin jugor.

- 1. Berat
- 2. Gjirokastrë
- 3. Butrint



1



2



3

**14. Rikonstrukcion i godinave të amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen ndaj zjarrit.**

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Rikonstrukcion i godinave të amortizuara dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen ndaj zjarrit.</b>
Konteksti i projektit	Qendra historike e Beratit i nënshtrohet kërkesave specifike të mirëmbajtjes dhe mbrojtjes nga zjarri si detyrim i statusit të dhënë nga UNESCO. Mirëmbajtja e këtyre objekteve me vlerë siguron tërheqjen e sa më shumë vizitorëve dhe zhvillimin e sektorit të turizmit.
Përshkrimi i projektit	Studimi dhe zbatimi i punimeve të nevojshme për të siguruar integritetin strukturor dhe arkitektonik të pasurive historike, ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtjen ndaj zjarrit. Në zonat historike si lagja "Mangalem", "Goricë" dhe "Kala" me një sipërfaqe përkatësisht 5.8 ha, 2.9 ha dhe 9.4 ha.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, UNESCO
Justifikimi i projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtja e qendrës historike, e cila përbën një aspekt thelbësor të identitetit të qytetit si dhe të sektorit të tij turistik</li> <li>- Rreziku i cenimit të statusit ndërkombëtar nga mospërbushja e detyrimeve</li> </ul>
Objektivi	Miratimi dhe aprovimi i punimeve nga raporti i vitit 2017 i UNESCO-s
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i projektit</li> <li>- Përcaktimi dhe restaurimi i ndërtesave të degraduara/amortizuara</li> <li>- Promovimi i projektit dhe lobimi për fonde</li> </ul>
Rezultati i pritshëm	- Rritja dhe konservimi i vlerave historike të qytetit
Rreziqet	- Neglizhenca e autoriteteve për t'i dhënë prioritet restaurimeve apo sistemeve kundra zjarrit
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Aftatshkurtër
Kosto financiare	Për t'u llogaritur
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Berat, Ministria e Kulturës
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH, donatorë të ndryshëm



Zonat Historike:  
1. Kalaja e Beratit  
2. Lagjia Mngalem  
3. Gorica



1



2




3





**15. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli.**

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli</b>
Konteksti i projektit	Depozitimi i mbetjeve të ngurta aktualisht ndodh në një sipërfaqe prej 9.3 ha pranë Lumit Osum. Ky vendgrumbullim jo sanitar ndot lumin dhe shkarkon mbetje gjatë ngritjes të nivelit të lumit. Plani për menaxhimin e mbetjeve urbane i hartuar në 2012 evidenton këto problematika.
Përshkrimi i projektit	Vënien në zbatim të politikave të menaxhimit të mbetjeve të ngurta të hartuara në planin e 2012, si dhe ndërtimin e një landfilli pranë vend-depozitimit aktual.
Partnerët	Bashkia Berat, Ministria e Mjedisit, Komuniteti
Justifikimi i projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ulja e depozitimeve të mbetjeve të ngurta nëpërmjet përpunimit/ndarjes së tyre përpara depozitimit</li> <li>- Mbrojtja e mjedisit dhe veçanërisht e lumit nga ndotja</li> </ul>
Objektivi	Reduktimi i mbetjeve të ngurta si dhe depozitimi dhe përpunimi i tyre në një zonë sanitare
Veprimet strategjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i një landfilli pranë Orizaj me impiantë përpunues/ndarës të mbetjeve.</li> <li>- Mbyllja dhe pastrimi i vend-depozitimit ekzistues</li> <li>- Fushata ndërgjegjësimi për ndarjen e mbeturinave dhe riciklimit.</li> </ul>
Rezultati i pritshëm	Përmirësimi i peizazhit të lumit dhe ulja e nivel të ndotjes në natyrë. Ulja e emetimeve të gazrave të rrezikshëm në ajër nga fusha aktuale e depozitimit të mbetjeve.
Rreziqet	
Faza e projektit	Koncept-projekt
Vlerësimi i prioriteteve	Afat-shkurtër-afatmesëm
Kosto financiare	Pas studimit të parafizibilitetit
Burimi i mundshëm kryesor i financimit	Bashkia Berat, Ministria e Mjedisit
Burimi i mundshëm dytësor i financimit	FSHZH., donatorë të ndryshëm



I. Pikë grumbulimi mbetjesh

## SHTOJCA



BASHKIA BERAT

### Proces-verbal

### DËGJESA PUBLIKE E PARË PËR HARTIMIN E

### PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË BERAT

Në datën 16.10.2015 ora 11.00 pranë Bashkisë Berat u zhvillua dëgjesa publike e parë për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Berat.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “ Për ndarjen administrative - territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Plani i Përgjithëm Vendor do të hartohet nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Nisma për hartimin e Planit të Përgjithëm Vendor është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Berat me vendim Nr.31, datë 30.09.2015.

Pjesëmarrës në këtë degjesë ishin: Nënkryetari i Bashkisë Berat Z. Bledar Blana, përfaqësues të PLGP/Co-PLAN, përfaqësues nga drejtoria e PTIKP, anëtarë të Forumit Keshillmor Vendor si dhe banorë të Bashkisë Berat.

Takimi ishte në nivel informativ për t’u njohur me nismën e marrë nga Bashkia Berat si dhe rrugët që do të ndiqen deri në hartimin e dokumentit final.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të N/kryetarit të bashkisë dhe përfaqësuesit të PLGP/Co-PLAN, u vijua me një prezantim të shkurtër nga përfaqësuesi i drejtorisë së PTIKP-së.

Në takim u zhvilluan diskutime dhe pyetje në lidhje me sqarimin për publikun të procedurave që do të ndiqen, korniza ligjore, përfshirja e grupeve të interesit dhe transparenca në vendim-marrje. Në fund të takimit u caktua dita që do të zhvillohet degjesa publike e dytë.

Mbajtësi i protokollit  
Ing. Valentina Zotkaj



BASHKIA BERAT

**Proces-verbal**

**DËGJESA PUBLIKE E DYTË PËR HARTIMIN E**

**PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË BERAT**

Në datën 02.12.2015 ora 11.00 pranë Pallatit të Kulturës Berat u zhvillua dëgjesa publike e dytë për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Berat.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “ Për ndarjen administrative - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Plani i Përgjithëm Vendor do të hartohet nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Nisma për hartimin e Planit të Përgjithëm Vendor është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Berat me vendim Nr.31, datë 30.09.2015. Dëgjesa publike e parë është zhvilluar në datën 16.10.2015 pranë Bashkisë Berat.

Dëgjesa publike e dytë u zhvillua në lidhje me hartimin e relacionit të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Berat.

Pjesëmarrës në këtë degjesë ishin: Nënkryetari i Bashkisë Berat Z. Bledar Blana, përfaqësues të PLGP/Co-PLAN, përfaqësues nga AKPT si dhe banorë të Bashkisë Berat.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të N/kryetarit të bashkisë i cili kryeu një përmbledhje të gjithë hapave të ndjekur në lidhje me PPV. U vijua me prezantimin e materialit të përgatitur nga përfaqësuesit e PLGP/Co-PLAN. Ku u trajtuan tema të ndryshme si: pozicionimi i Bashkisë Berat, policentrizmi, përdorimi i tokës, infrastruktura, demografia, mirëqënia sociale, punësimi, arsimit dhe shëndetësia. Zhvillimi ekonomik rural u trajtua specifikisht, duke evidentuar produktivitetin, llojin e bizneseve dhe fermave për njësitë Velabisht, Sinjë, Roshnik dhe Otlak.

U krye një analizë e gjithë territorit të Bashkisë jo vetëm në nivel informativë por duke shkuar deri te pritshmeritë.



## Komente

Tashmë territori i bashkisë popullohet në mbi 60% me zonë urbane dhe pjesa tjetër në zonën rurale megjithëse sipërfaqja urbane është shumë më e vogël se ajo urbane.

Kjo analizë më e detajuar u shpreh edhe në formën e analizës SWOT ku gjithkush mund të behet totalisht dhe aktivisht pjesëmarrës në lidhje me pikat e dobëta, të forta mundësitë dhe kërcënimet. Vëmëndje dhe diskutim hapi çështja e rrjeteve rrugore.

Domosdoshmëria për unazën e qytetit është e pashmangshme. Në skemën e rrjetit rrugor jepen jo vetëm rrugët e aksesueshme sot por edhe mundësitë që ofrohen me rrugët lokale dhe kombëtare.

### Problemet kryesore që ngriten pjesëmarrësit ishin:

1. Materiali duhet të plotësohet me të dhëna rreth ish- komunës Roshnik e cila mbart resurse të pamohueshme jo vetëm natyrore pasi:
  - Qafe Dardha është një pikë afër qytetit dhe rrëzë malit të Tomorit.
  - Ujvara e Sotirës, vend shumë piktoresk dhe i vizitueshëm për të gjithë.

Grupi i punës: Disa nga këto aspekte dhe asete, si p.sh. Ujëvara e Sotirës, dalin jashtë kufijve administrativë të Beratit. Të dhënat e përdorura në strategji janë ato që ka Bashkia dhe institucionet në varësi të saj, që kanë dhe vënë në dispozicion Ministrinë e Linjës dhe institucionet në varësi të tyre dhe INSTAT.

- Fond i konsiderueshem agrikulture, fiku i Roshnik i licensuar përtej kufijve të vendit.

Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjike dhe Programet. Një ndër objektivat është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në njësinë Roshnik.

### 2. Unaza e qytetit

- Në planin rregullues të 1983 kemi një gjurmë të kësaj unaze nga kodrat lindore të qytetit. Në PPV të vitit 2012 kemi dy gjurmë të unazës së qytetit jo vetëm nga kodrat apo ullishtja lindore por edhe nga Kodra Partizani (Goricë) nëpërmjet një tuneli. Të dy variantet janë ende të diskutueshme për qytetin.

Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjike dhe Programet. Objektivi trajon fuqizimin e aksesit brenda territorit të bashkisë dhe ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin dhe propozon ndërtimin e *Bypass-it* të qytetit. Sa i përket detajeve të gjurmës dhe rregullave mbi vijën e ndërtimit të Unazës, këto janë subjekt i planit të infrastrukturave, për t'u përgatitur në vijim të hartimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të Beratit.

Në fund të takimit të gjithë pjesëmarrësit konfirmuan pjesëmarrjen dhe vendosën kontaktet e tyre për çdo takim tjetër.

Mbajtësi i protokollit

Ing. Valentina Zotkaj



## BASHKIA BERAT

### Proces-verbal

### DËGJESA PUBLIKE E TRETË PËR HARTIMIN E

### PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË BERAT

Në datën 15.01.2016 ora 11.00 pranë Pallatit të Kulturës Berat u zhvillua dëgjesa publike e tretë për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Berat.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “ Për ndarjen administrative - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Plani i Përgjithshëm Vendor do të hartohet nga Bashkia Berat me mbështetjen teknike të Projektit PLGP të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Nisma për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Berat me vendim Nr.31, datë 30.09.2015.

Takimi i sotëm kishte një pjesëmarrje më të gjerë, jo vetëm banorë të qytetit të Beratit por edhe të njësive administrative.

Në këtë takim merrnin pjesë Kryetari i Bashkisë Z. Petrit Sinaj, përfaqësues të PLGP/Co-PLAN, përfaqësues të grupit të hartimit të PPV, përfaqësues të AKPT si dhe përfaqësues të institucioneve lokale. Kryetari i Bashkisë në fjalën e tij u përqëndrua fillimisht mbi gjendjen e territorit të ri të bashkisë së Beratit, situatën problematike si dhe koston e rehabilitimit për të gjitha ndërhyrjet e pakontrolluara por tashmë të legalizuara apo të hipotekuara.

Plani i Përgjithshëm Vendor është plani i të gjithëve duke na shërbyer secilit prej nesh, por e rëndësishme është që të kemi një plan sa më të qëndrueshëm duke shërbyer sot dhe në vitet në vijim.

Nëpërmjet këtij plani do të arrijme të kemi një urbanizim të kontrolluar për të përdorur në mënyrë të drejtë hapsirën urbane dhe atë mjedisore. Në fund të fjalës së tij, Kryetari i Bashkisë edhe njëherë ftoi të gjithë banorët e Bashkisë Berat për të qënë pjesëmarrës sa më aktiv në të gjitha takimet apo dëgjesat e organizuara për PPV apo dokument tjetër.

Më pas Z. Zenel Bajrami në emër të grupit të punës paraqiti draft strategjinë territoriale duke u përqëndruar kryesisht:

- Analiza
- Pozicioni Strategjik
- Policentrizmi
- Koridoret kryesore ( Koridori VIII, Koridori Blu , Koridori Veri / jug dhe Koridori natyror)
- Perdorimi i tokes
- Mjedisi
- Tendencat e zhvillimit
- Vizioni
- Objektivat dhe programet strategjike te zhvillimit.

Për sa i takon tendencave dhe zhvillimit u bë një paraqitje vetëm për pjesën e qytetit Berat. Ku zhvillimi u tij u pa i ndarë në disa pole zhvillimi. Më pas takimi vazhdoi me pyetje dhe diskutime rreth materialit.

**Problemet kryesore qe ngriten pjesëmarrësit ishin:**

Z.Stavri Bode shfaqti interes në faktin se kur banorët e Bashkise Berat do t'i kenë të realizuara projektet e paraqitura.

Pjesë e materialit "Strategjia e Zhvillimit te Territorit" do të jenë edhe burimet e financimit të cilat do të jenë nga donatore apo nga Bashkia e Beratit.

**Grupi i punës:** Në kapitullin V, Plani i Veprimit për çdo program është përcaktuar dhe një afat kohor. Sigurisht, zbatimi varet nga mjetet financiare të bashkisë pas miratimit të Strategjisë.

Vazhdon të ngelet problem për qytetin *bypass-i* i cili edhe në këtë takim pati një paraqitje për të dy variantet duke theksuar anët pozitive dhe mangësite që mund të ketë secili. Çështje e trajtuar nga Z. V.Cela përfaqësues i shoqërisë civile.

**Grupi i punës:** Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjike dhe Programet. Objektivi trajon fuqizimin e aksesit brenda territorit të bashkisë dhe të ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin dhe propozon ndërtimin e *Bypass-it* të qytetit.

U kërkua në këtë takim që t'i kushtojë vëmendje edhe njësive administrative, integritit të tyre dhe krijimit të hapsirave të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme edhe në zonat më të thella të Bashkisë Berat.

**Grupi i punës:** Komenti është marrë në konsideratë dhe trajtimi integral i të gjithë territorit të bashkisë është pjesë e analizave dhe e vizionit të strategjisë. Po ashtu ky koment, është përfshirë në veçanti në material në kapitullin III, Objektivat Strategjike dhe Programet, përmes objektivit që trajton intensifikimin e aktiviteteve urbanizuese brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative.

Z. Feim Ruka, banor i lagjes Uznove, trajtoi problemin e kufijve administrative, pikërisht çeshtja e Ujvarës së Sotirës. Kjo ujëvarë apo vendi ku ajo ndodhet është pjesë e fshatit Qafë Dardhë e njësisë administrative Roshnik dhe jo e Sotirës, zonës së Gramshit.

**Grupi i punës: Përcaktimi i kufijve të njësive administrative, përfshirja e burimeve natyrore brenda kufijve të njësive nuk është në kompetencat e Planit të Përgjithshëm Vendor. Aktualisht qeveria po zbaton një program për institucionalizimin e kufijve administrativë dhe ndoshta banorët dhe grupet e interesit mund të shprehen (drejtpërdrejt apo përmes bashkisë) për ujëvarën e Sotirës në këtë proces të kufijve.**

Procesi i miratimit të planit do të përmbajë këto hapa:

- Kërkesën e autoritetit përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e Strategjisë Territoriale Vendore të njësisë vendore nga Këshilli Bashkiak.
- Vendim-marrjen e Këshillit Bashkiak.
- Kërkesën e autoritetit përgjegjës për miratimin e Strategjisë territoriale në KKT.
- Vendim-marrjen e KKT-së.
- Kërkesën e autoritetit përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Zhvillimit të njësisë dhe Rregullores në zbatim të tij, në Keshill Bashkiak.
- Vendim-marrjen e Keshillit Bashkiak.
- Kerkesen e autoritetit pergjegjies per shqyrtim dhe miratim te Planit dhe Rregullores ne KKT
- Vendimarrjen e KKT-se Pasi bashkia te marre produktin perfundimtar te Strategjise se Zhvillimit te territorit do te kerkoj mbeshtetje dhe miratim ne KB per te vazhduar procedurat e metejshme deri ne miratimin e dokumentit te PPV.

Ne fund te takimit te gjithë pjesmarresit konfirmuan pjesmarjen dhe lane kontaktet e tyre per cdo takim tjeter.

Mbajtësi i protokollit  
Ing. Valentina Zotkaj





## BASHKIA BERAT

### Proces-verbal

Në zbatim të VKM, Nr.671 date 29.07.2015 ``Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit``, neni 5 dhe pas marrjes se urdhrat për ngritjen e FBPV.

Ditën e premte, datë 11.02.2016 pranë Bashkisë Berat është mbajtur takimi i parë për Bashkinë Berat me përfaqësuese Znj. Adelina Greca, drejtuese e forumit dhe drejtore e AKPT. Z.Ardenis Hoxha, sekretar i forumit-drejtues i organit përgjegjës të planifikimit Bashkia Berat. Përfaqësues nga drejtoria rajonale e monumenteve te kulturës Z. Eugen Kallfani, përfaqësues nga PLGP /Co-PLAN, Z. Zenel Bajrami dhe përfaqësues nga bashkitë kufitare .

Pas fjalës së Znj. Adelina Grecaj, e cila diskutoi për rëndësinë e forumit, detyrat dhe dobitë që vijnë nga ky forum. Risinë e miratimit të PPV nëpërmjet dy etapave, miratimi i strategjisë dhe miratimi i PPV. U vijua me prezantimin e strategjisë së zhvillimit të territorit të Bashkisë Berat.

Gjatë prezantimit të startegjisë u diskutuan avantazhet dhe disavantazhet e ndërtimit të *Bypass-it* në dy variantet e mundshme, rehabilitimi i Lumit Osum. I cili kalon në Bashkitë Çorovodë, Poliçan, Berat dhe Ura-Vajgurore. Derdhja e ujërave të ndotura në lumin Osum dhe nevoja për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjik dhe Programet. Objektivi trajton fuqizimin e aksesit brenda territorit të bashkisë dhe ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin dhe propozon ndërtimin e *Bypass-it* të qytetit. Diskutimi për *bypass-in* e qytetit do të vazhdojë në fazat e mëtejshme të hartimit të planit.

Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjik dhe Programet. Objektivi trajton mbrojtjen e sistemit urban nga përmytjet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë korridorin lumor. Dhe dy projektet e propozuara janë: Rehabilitimi i shtratit të lumit Osum dhe risistemimi i zonave ripariane dhe Menaxhimi i integruar i ujërave të Lumit Osum në bashkëpunim me bashkitë fqinje.

Më pas u fol dhe për domosdoshmërinë e ndërtimit dhe menaxhimit të një impianti apo *landfilli* për trajtim të mbetjeve urbane, gjë kjo që do të zgjidhte përfundimisht ngrcin e krijuar në rajon për sa i përket mbetjeve urbane.

Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin V, Projektet Prioritare të Zhvillimit, ku një nga projektet e propozuara është: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një *Landfilli*.

Diskutim tjetër i rëndësishem ishte dhe ai i rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve në qytet, dhe mundësia e furnizimit me ujë të të gjithë njësive administrative.

**Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin V, Projektet Prioritare të Zhvillimit. Ku një nga projektet e propozuara është: Rikonstruksion dhe ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe ujësjellësit në Bashkinë Berat.**

Më pas diskutimi u ndal me gjatë rreth zhvillimit të qytetit nëpërmjet agroturizmit dhe turizmit arkeologjik, dy shtylla këto shumë të rëndësishme për sa i përket strategjisë së zhvillimit .

**Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjik dhe Programet. Objektivi trajton zhvillimin e turizmit shumëdimensional historiko-kulturor dhe [eko/agro]turizmit, në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm e me vlera natyrore, si sektori bazë për zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e mirëqenies sociale të komunitetit. Turizmi në tërësi, është elementi kryesor i profilit të ardhshëm të zhvillimit të Beratit.**

Gjatë diskutimit dhe ndërhyrjeve nga ana e bashkive ndërkufitare u fol për lëvizshmërinë dhe mundësitë e hapjeve apo mirëmbajtjeve të rrugëve dhe arterieve të rrugëve që bëjnë të mundur lëvizshmërinë ndërmjet bashkive ndërkufitare. Pasi në zonat ekstreme të kufijve administrativ, mirëmbajtja e rrjetit rrugor do të ndihmonte në menyrë të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të familjeve në këto zona.

**Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjik dhe Programet. Objektivi trajton fuqizimin e aksesit brenda territorit të bashkisë dhe ndërlidhjes mes vendbanimeve e me kufitarët dhe rajonin.**

Si strategji zhvillimi për njësitë administrative për Bashkinë Berat u fol dhe ndërtimi apo rivitalizimit i qendrave sportive gjë kjo që do sjell një tjetër vizion për sa i përket zhvillimit social, ekonomik dhe urbanistik.

**Grupi i punës: Komenti është marrë në konsideratë dhe u përfshi në material në kapitullin III, Objektivat Strategjik dhe Programet. Objektivi trajton rigjenerimin dhe zhvillimin e hapësirave publike në qytetin e Beratit dhe qendrat urbane të njësive administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve.**

**Drejtor i DPIKT Berat  
Ardenis Hoxha**

<sup>1</sup> Sipërfaqe e matur nga GIS, Co-Plan, PLGP 2015

<sup>2</sup> <http://www.reformaterritoriale.al/udherrefyes/dokumente>, aksesuar dhjetor 2015

<sup>3</sup> Sipas studimit të INSTAT për Tipologjinë e Komunave dhe të Bashkive (2014), mbi bazën e të dhënave të Census 2011.

<sup>4</sup> Për të realizuar llogaritjet, është përdorur popullsia sipas INSTAT (Censusi 2011), pasi vetëm në këtë mënyrë mund të përfshihen në formulë disa tregues dhe të bëhen krahasimet mbi hartën e ZFU-ve dhe të aglomerateve urbane.

<sup>5</sup> Bashkimi Evropian

<sup>6</sup> European Spatial Development Perspective – Perspektiva Evropiane për Zhvillimin Hapësinor

<sup>8</sup> Work catchment area (Basen ujore)

<sup>9</sup> Gjatë vitit 2015 Co-PLAN ndërmori një analizë të zhvillimit policentrik në nivel Shqipërie, duke ndjekur me përpikmëri metodologjinë e ESPON 1.1.1 (Projekt i European Spatial Planning Observatory Network). Kjo analizë trajton 7 tregues të policentrizmit morfologjik (fizik) të cilët të kombinuar formojnë tre indekse (madhësia, pozicionimi dhe lidhshmëria) dhe në përfundim një indeks të policentrizmit për Shqipërinë, të krahasueshëm me ato të vendeve evropiane që kanë qenë subjekt i ESPON 1.1.1. Po ashtu, kjo analizë kryhet edhe për 7 tregues të policentrizmit funksional. Për shkak të mungesës së të dhënave, policentrizmi funksional është përshkruar, por nuk është analizuar i plotë (jo të gjithë treguesit mund të maten).

<sup>10</sup> Prodhimi i brendshëm bruto

<sup>11</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorrezimet në qarqet e Shqipërisë*, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

<sup>12</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorrezimet në qarqet e Shqipërisë*, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

<sup>13</sup> Bashkia Berat 2012, *Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm të Planifikimit të Territorit*, Bashkia Berat

<sup>14</sup> Bashkia Berat 2012, *Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm të Planifikimit të Territorit*, Bashkia Berat

<sup>15</sup> **Shënim:** përzgjedhja e kësaj zone si rajon është bërë vetë për arsye studimi. Në këtë territor kalojnë/gjenden burime të shumta ujore, janë përqendruar një pjesë e madhe e HEC-eve dhe terreni është i larmishëm, duke përfshirë zona fushore e bregdetare deri tek ajo malore. Pra nga ana e analizës së metabolizmit përmban të gjithë elementët e nevojshëm për analizim.

<sup>16</sup> Burimi i info Harta e rrezatimit mesatar vjetor, AKBN, përpunuar tek harta e energjisë në rajon (Co-Plan)

---

<sup>17</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të energjisë janë marr nga SHGJSH (biomasa), AKBN dhe TAP (hidrokarburet, energjia e erës, energjia e diellit dhe energjia gjeotermale), [www.riverwatch.eu](http://www.riverwatch.eu) (HEC-et), Atlasi Gjeotremal (burimet gjeotermale) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

<sup>18</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të ujit janë marr nga SHGJSH (akuifere, burimet dhe shpimet), [www.riverwatch.eu](http://www.riverwatch.eu) (HEC-et) dhe [www.bestcountryreports.com](http://www.bestcountryreports.com) (precipitimet) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

<sup>19</sup> Sipërfaqe e matur nga harta GIS (61 bashki)

<sup>20</sup> Analiza Demografike

<sup>21</sup> AKBN, (në përgjigje të shkresës zyrtare Nr. 1777 Prot. datë 16.10.2015)

<sup>22</sup> Energji të rinovueshme, energjia diellore

<sup>23</sup> Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013

<sup>24</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të energjisë në Bashkinë Berat janë marr nga Ministria e Mjedisit (zonat e mbrojtura), [www.riverwatch.eu](http://www.riverwatch.eu) (HEC-et) dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës

<sup>25</sup> Njësi Ekonomike Familjare

<sup>26</sup> INSTAT, Censusi (2011)

<sup>27</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të ujit në Bashkinë Berat janë marr Bashkia Berat dhe Valu ADD (sistemi i ujësjellësit dhe zona e mbulimit me shërbim), [www.riverwatch.eu](http://www.riverwatch.eu) (HEC-et) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

<sup>28</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të ushqimit janë marr nga Corine (llojet e tokave), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Urban dhe Administrimit të ujërave (pikat e grumbillimit dhe magazinimit) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

<sup>29</sup> Co-PLAN 2015, Përdorimi i Tokës Berat (të matura nga hartat e GIS)

<sup>30</sup> Burimi i info për hartën e fluksit të mbetjeve në Bashkinë Berat janë marr nga Ministria e Zhvillimit Urban (vendepozitimet), Ministria e Mjedisit (kompanitë ricikluese), dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës)

<sup>31</sup> Ky monitorim i cilësisë së ujërave sipërfaqësore u krye për lumenjtë: Osum, Devoll, Seman, Shkumbin, Gjanicë dhe Vjosë. Monitorimi u krye në periudhën Qershor-Korrik, nga Co-PLAN, në kuadër të zbatimit të projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore. Në pellgun e Lumit Seman, marrja e mostrave të ujit për analizë u bë në 11 pika, 6 nga të cilat në Osum. Në të gjitha pikat u analizuan në laborator 13 parametra fiziko dhe bio-kimikë (pH, Light Transparency, Electric Conductivity, Total Suspended Solids (TSS), Total Dissolved Solids (TDS), Dissolved Oxygen (DO), Temperature, Biochemical Oxygen Demand (BOD), N-NH<sub>4</sub>, N-NO<sub>3</sub>, N-NO<sub>2</sub>, sulfidet dhe Total Coliform). Ndërkohë në 7 nga mostrat e mbledhura, disa prej tyre u analizuan edhe për praninë e metaleve të rënda (Pb, Cd, Mn, Ni, Zn, Cu, Co, Cr, Hg, As, Ba, Br)

---

<sup>32</sup> Parametrat e përbashkët të monitoruar nga Co-PLAN/PLGP dhe AKM janë pH, Oksigjeni i tretur, BOD<sub>5</sub>, N-NH<sub>4</sub>, N-NO<sub>2</sub> dhe N-NH<sub>4</sub>.

<sup>33</sup> Pikat e monitorimit për lumenjtë kryesorë të Basenit të Semanit (Gjanicë, Seman, Osum dhe Devoll) janë të njëjta me përjashtim të pikës së Mujallisë në Seman e cila është monitoruar vetëm nga AKM. Pikat e monitorimit të AKM-së në Osum janë Uznovë dhe Urë Vajguore. Monitorimi Co-PLAN/PLGP në Seman është kryer në 12 pika kundrejt 6 pikave të monitoruara nga AKM, ndërsa në Osum në 6 pika kundrejt 2 pikave të monitoruara nga AKM.

<sup>34</sup> Kjo pikë është monitoruar vetëm nga AKM

<sup>35</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014*

<sup>36</sup> *Biological Oxygen Demand – Nevoja Biologjike për Oksigjen*

<sup>37</sup> Normat janë marrë nga Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 (Council Directive CEE/CEEA/CE 78/659) për cilësinë e ujrave të ëmbla për rritjen e peshqve

<sup>38</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014*

<sup>39</sup> *Total Suspended Solids*

<sup>40</sup> *Total Dissolved Solids*

<sup>41</sup> Normat janë marrë nga *International Commission for the Protection of the Danube River*

<sup>42</sup> AKM përdor normat 0.12 mg/l, ndërsa normat mjedisore të përdorura në analizën Co-PLAN/PLGP janë 0.03 mg/l sipas Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 (Council Directive CEE/CEEA/CE 78/659) për cilësinë e ujrave të ëmbla për rritjen e peshqve

<sup>43</sup> AKM Berat, 2014

<sup>44</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, *Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014*

<sup>45</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat, Ministria e Energjisë dhe Industrisë*

<sup>46</sup> Mospërputhja e kufirit administrativ ndodh për arsye të përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit, kufiri i Bashkisë Elbasan është kufirin i përditësuar deri më tani (19 janar 2016)

<sup>47</sup> *Particular Matter – grimcat e respirueshme*

<sup>48</sup> Metan

<sup>49</sup> Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) Berat, *Raporti Për Gjendjen e Mjedisit, 2014*

<sup>50</sup> *International Unit for Conservation of Nature – Unioni ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës*

<sup>51</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, *Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Beratit, Tiranë 2014*



---

<sup>52</sup>UNEP 2000, *Post- Conflict Environmental Assessment Albania*, United Nations Environmental Programme

<sup>53</sup> Metan

<sup>54</sup> Shqipëri: Tipologjia e Komunave dhe Bashkive, Maj 2014

<sup>55</sup> Çdo njësi në këtë tabelë përfaqëson një bashki apo komunë përpara reformës territoriale-administrative: Këto të dhëna janë mbledhur e përpunuar gjatë 2011-2012, nga INSTAT mbi përmes e *Censusi-it*.

<sup>56</sup> United States Department of Agriculture, Natural Resources Conservation Services, *A Basic System of Soil Classification for Making and Interpreting Soil Surveys*, 1999, [http://www.nrcs.usda.gov/Internet/FSE\\_DOCUMENTS/nrcs142p2\\_051232.pdf](http://www.nrcs.usda.gov/Internet/FSE_DOCUMENTS/nrcs142p2_051232.pdf) shikuar më 6 nëntor 2015

<sup>57</sup> Bashkia Berat, 16 Nentor, 2015, <http://bashkiaberat.gov.al/?p=301>

<sup>58</sup> Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2014

<sup>59</sup> Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic Losses from Soil Degradation in Agricultural Areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293

<sup>60</sup> EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5\* / December 2013

<sup>61</sup> Vjetari statistikor rajonal 2014

<sup>62</sup> Plani i përgjithshëm i Bashkisë Berat, 2013, faqe 17-18

<sup>63</sup> [http://www.albaniandf.org/Resources/Lista\\_e\\_Rrugeve\\_te\\_finacuara\\_nga\\_FSHZH\\_2005-2013.pdf](http://www.albaniandf.org/Resources/Lista_e_Rrugeve_te_finacuara_nga_FSHZH_2005-2013.pdf), page 3.

<sup>64</sup> UNESCO 2015, Historic Centres of Berat and Gjirokastra, <http://whc.unesco.org/en/list/569/documents/> aksesuar 22.11.2015

<sup>65</sup> Instituti i Monumentëve të Kulturës 2015, Lista e Monumenteve Qarku Berat, <http://www.imk.gov.al/wp-content/uploads/monumente/lista%20e%20monumenteve/BERAT.pdf> aksesuar 19.11.2015

<sup>66</sup> AKPT 2015, Harta: Zonat me rëndësi kombëtare, [http://planifikimi.gov.al/sites/default/files/Bregdeti\\_0.pdf](http://planifikimi.gov.al/sites/default/files/Bregdeti_0.pdf) aksesuar 19.11.2015

<sup>67</sup> “Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020” miratuar me Vendim i KM, Nr. 691, Dt. Aktit: 29.07.2015

<sup>68</sup> Co-PLAN 2015, Harta e Përdorimit të Tokës Berat – Draft

<sup>69</sup> TAP AG 2015, Udhëzues për Blerjen dhe Qiranë e Tokës në Shqipëri , [http://www.tapag.al/assets/03.land\\_access/albanian/GLAC\\_FINAL\\_PRINT.pdf](http://www.tapag.al/assets/03.land_access/albanian/GLAC_FINAL_PRINT.pdf) aksesuar 19.11.2015

<sup>70</sup> Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfshijnë të ardhurat nga: taksat e ndara, transfertën e kushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar.

<sup>71</sup> Të ardhurat vendore përfshijnë të ardhura nga: taksa dhe tatime, tarifa, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose asete të KSHP-ve, donacione dhe hua.

<sup>72</sup> Të dhënat për transfertën e kushtëzuar përfshijnë dhe të ardhurat nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për grantet e dhëna në programet e arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë, ujësjellës kanalizime, strehimit.

<sup>73</sup> Shpenzimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore klasifikohen sipas natyrës ekonomike dhe sipas qëllimit të përdorimit të tyre (funksionit apo programe) në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), të publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

<sup>74</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore, 2015, faqe 12.

<sup>75</sup> Projekt-ligji për ligjin e ri Organik për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisë Vendore, aprovuar nga Këshilli i Ministrave, aktualisht në pritje për të kaluar për votim në kuvend.

<sup>76</sup> Në përputhje me Ligjin nr. 115/2014 , datë 31.07.2014 “Mbi Ndarjen territoriale administrative të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”

<sup>77</sup> Njësi të qeverisjes vendore (bashkitë dhe qarqet sipas legjislacionit në fuqi për ndarjen territoriale dhe administrative)

<sup>78</sup> Organizata të Shoqërisë Civile

<sup>79</sup> Sipas ndarjes së territorit në rajone zhvillimi me propozim të Këshillit të Ministrave.

<sup>80</sup> Sipas leximit të Cabanes, P. *et al*, (2008), *Harta Arkeologjike e Shqipërisë*, Botimet Pegi.

<sup>81</sup> Sipas Albanian Academy of Science, *History of Albanian People*, ISBN 99927-1-623-1

<sup>82</sup> Viezzoli, S.J., L. (1923), *Shqypnija, Njoftime gjeografike shtetistike-administratore*, ribotim 2014, Botimet Fishta, Tiranë.

<sup>83</sup> Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura  
[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=4&Itemid=370&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=4&Itemid=370&lang=en), aksesuar në nëntor 2015.

<sup>84</sup> Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura  
[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=7&Itemid=372&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=7&Itemid=372&lang=en), aksesuar në nëntor 2015.

<sup>85</sup> Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura  
[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=8&Itemid=373&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=8&Itemid=373&lang=en), aksesuar në nëntor 2015.

<sup>86</sup> Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura  
[http://akzm.gov.al/index.php?option=com\\_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=9&Itemid=374&lang=en](http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=9&Itemid=374&lang=en), aksesuar në nëntor 2015.

---

<sup>87</sup> Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfshijnë të ardhurat nga: taksat e ndara, transfertën e kushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar.

<sup>88</sup> Të ardhurat vendore përfshijnë të ardhura nga: taksa dhe tatime, tarifa, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose asete të KSHP-ve, donacione dhe hua.

<sup>89</sup> Në këtë kontekst termi të ardhura të veta i referohet të ardhurave që njësia administrative gjeneron nga taksat dhe tatimet, tarifat, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose mjete të KSHP-ve, donacione dhe hua. Të dhënat i referohen periudhës 2010-2014 dhe kanë si burim Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Financiar të Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave.

